

**BISMIL'LAHI'R-RAHMANI'R-RAHIM**

**PARIMET THEMELORE TË BESIMIT**

**Dilaver Selvi**

**Prishtinë 2013**

**SHTËPIA BOTUESE “PIRAMIDA”  
PRISHTINË**

**Botues**

Mustafë Voca

**Titulli i origjinalit**

Temel Inanç Esaslari

**Përgatiti dhe përktheu**

Is-hak Shala dhe Petrit Çarkaxhiu

**Lektor**

Haxhi Iskender Rashiti

**Redaktor artistik dhe teknik**

Abdullah B. Ferizi

**Shtypi**

Prizren Graf +377 44 113 168

**ISBN**

978-9951-18-110-5

## RRETH LIBRIT

Falënderimi i pa fund qoftë për Allahun Teala që na nderoi me iman.

Salat dhe selam i qoftë të Dërguarit mëshirë për të gjitha botët, robit më të dashur të Allahut, prijësit të pejgamberëve Muhammedit s.a.v.s..

Ky libër trajton themelet e fesë sonë. Feja fillon me iman dhe me dëshmi. Ai që nuk ka iman dhe besim të drejtë nuk do të ketë përfundim të mirë. Për këtë arsye në fenë tonë parimet esenciale të besimit janë në rend të parë për kah rëndësia. Ne jemi munduar që këtë temë me rëndësi ta shpjegojmë në një mënyrë të re dhe me një gjuhë sa më të kuptueshme.

Renditja e temave të imanit është bërë në një mënyrë të njohur. Mund të themi se është dhënë dituri e mjaftueshme, mirëpo pa u futur në detaje dhe në debate sa i përket pikëpamjeve të ndryshme ndaj këtyre temave. Të gjitha esencat e imanit janë prezantuar nën peshojën e Kur'anit dhe sunnetit si dhe në përputhje të plotë me pikëpamjet e dijetarëve të Islamit. Shkurtimisht është treguar mënyra e besimit të grupit që do të shpëton prej vuajtjeve, e që sipas shenjave të hadithit është Ehli Sunnet vel Xhemati.

Në fund të çdo teme janë shtruar disa pyetje në lidhje me temën, në mënyrë që të matet dhe të freskohet dituria. Duke ju përgjegjur këtyre pyetjeve çdokush mund ta matë veten se sa ka kuptuar.

Në mes të temave janë bashkangjitur edhe disa shembuj plotësues në formë të tregimit, të cilat janë në lidhje të ngushtë me temën dhe të cilat në mënyrë të relaksuar e nxisin lexuesin të mendojë. Në fund të librit është dhënë një përmbledhje e besimit të Ehli Sunnetit.

Libri është përgatitur në mënyrë që të mund të shfrytëzohet nga çdo moshë.

Uroj që kjo vepër të jetë e dobishme për të gjithë vëllezërit besimtarë.

Të gjitha sukseset janë prej Rabb'it tonë. Atij i qoftë hamd pa fund.

Dilaver Selvi

## PËRMBAJTJA

IMANI-BESIMI	7
GRUPET E NJERËZVE NGA PIKËPAMJA E IMANIT	13
KUR U BËMË MYSLIMAN?	17
FITRATI JONË DHE FEJA	21
VIRTYTET E IMANIT	24
EHLI SUNNETI – MEDH’HEBET E BESIMIT	28
KUSHTET PËR TA BËRË IMANIN E VËRTETË	32
<b>BESIMI NË ALLAHUN</b>	<b>37</b>
SIFATET E ALLAHUT TEALA [CILËSITË]	42
EMRAT E BUKUR TË ALLAHUT TEALA	
ESMA-I HUSNA	48
RREGULLAT E SJELLJES NË LIDHJE	
ME ESMA-I HUSNA	51
A MUNDËT ANIJA PA KAPITEN?	54
<b>BESIMI NË MELAIKE</b>	<b>55</b>
NDIHMAT QË VJEN PREJ QIELLIT	65
<b>BESIMI NË LIBRAT</b>	<b>67</b>
VLERA E LARTË E LEXIMIT TË KUR’ANI KERIMIT	71
<b>BESIMI NË PEJGAMBERË</b>	<b>75</b>
GJITHÇKA PËR NDER TË TIJ S.A.V.S	80

<b>BESIMI NË DITËN E AHIRETIT</b>	<b>81</b>
<b>ÇKA NËSE KA!</b>	<b>85</b>
<b>SHENJAT E KIJAMETIT</b>	<b>86</b>
<b>ÇKA PËRGATITE PËR KIJAMET?</b>	<b>91</b>
<b>EXHELI – VDEKJA</b>	<b>92</b>
<b>O MELEKU I VDEKJES, SILLU BUTË!</b>	<b>97</b>
<b>JETA NË VARR - ALEMI BERZAH</b>	<b>99</b>
<b>KRISMA - NDODHIA E KIJAMETIT</b>	
<b>FRYERJA E SURIT</b>	<b>102</b>
<b>HASHIR – MAHSHER</b>	<b>105</b>
<b>DHËNIA E LIBRIT TË VEPRAVE</b>	<b>109</b>
<b>MIZAN [PESHORJA]-HESAP [LLOGARIA]</b>	<b>111</b>
<b>GJITHÇKA ME RAHMETIN E ALLAHUT</b>	<b>115</b>
<b>SHEFATI</b>	<b>118</b>
<b>SIRATI</b>	<b>122</b>
<b>BURIMI KEVTHER</b>	<b>124</b>
<b>XHENETI DHE XHEHENEMI</b>	<b>126</b>
<b>SI DO TË NGJALLEN ESHTRAT E KALBURA</b>	<b>132</b>
<b>BESIMI NË KADER DHE NË KADA</b>	<b>133</b>
<b>GJITHÇKA ËSHTËNJË KADER</b>	<b>137</b>
<b>VENDIMI IPET SIPAS FUNDIT</b>	<b>139</b>
<b>VESVESET DHE MENDIMET QË VIJNË NË ZEMËR</b>	<b>142</b>
<b>RRUGA E SHPËTIMIT PREJ VESVESEVE</b>	<b>144</b>
<b>LLOJET E SHIRKUT</b>	<b>148</b>
<b>PËRMBLEDHJA E BESIMIT TË EHL-I SUNNET-IT</b>	<b>153</b>

## IMANI - BESIMI

Feja fillon me iman. Esencat themelore në fenë islame janë përmbledhur në kelime-i shehadet:

**“Eshhedu en la ilahe illallah ve eshedu enne Muhammeden abdu-hu ve resuluh.”** Këto janë dy të vërteta të cilat duhet të besohen dhe të dëshmohen.

1.Dëshmoj se nuk ka ilah tjetër përveç Allahut. Allahu Teala është një. Vetëm Allahu Teala është ilah. Vetëm Allahu Teala adhurohet dhe vetëm Atij i bëhet ibadet. Ai është pronari i të gjitha botërave dhe krijesave.

2.Dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i dërguar i Allahut.

### ÇKA ËSHTË IMANI?

Fjala “iman” ka këtë kuptim: ekzistenca e një gjëje që besohet dhe vërtetohet me zemër dhe pa dyshim.

Sipas fesë sonë iman do të thotë: të besosh në ekzistencën dhe njëshmërinë e Allahut Teala, në krijesat që Ai i ka krijuar, të besosh në melaiket, në Librat, në Pejgamberët, të besosh në ringjalljen pas vdekjes, në ditën e ahiretit, të besosh në kader e që është krijimi dhe caktimi i Allahut Teala, që do të thotë se hajri dhe sherri ndodhin me caktimin e Allahut Teala.

Imani në esencë bëhet me zemër, ndërsa me gjuhë bëhet deklarimi. Qendra e imanit është zemra.

Mund të thuhet se për imanin më tepër përshtatet ky kuptim: të besohen gjërat të cilat ekzistojnë mirëpo të cilat nuk shihen me sy. Kjo quhet gajb. Besimi në gajb është obligim [farz]. Gajbi nuk është diçka që është e zhdukur, diçka që nuk ka ekzistencë. Gajbi nuk është diçka imaginative. Gajbi egziston, mirëpo në kushtet e kësaj bote materiale nuk mund të perceptohet me pesë shqisat, nuk mund të shihet me sy. Për neve Allahu Teala, melaiket, xhinët, Arshi, Kursi, Levh-i Mahfudhi, kaderi, ahireti, Xheneti e Xhehenemi janë gajb, mirëpo të gjitha këto ekzistojnë tash, në këtë moment. Cilësia themelore e besimtarit është besimi në gajb. Allahu Teala kështu i ka përshkruar cilësitë e besimtarëve të devotshëm të cilët janë të udhëzuar:

**“Të cilët e besojnë të fshehtën (gajbin)”[2- Bekare: 3]**

Vërtetimi i një gjëje bëhet në tri mënyra. Me zemër, me gjuhë dhe me vepër.

Vërtetimi me zemër është vërtetimi prej thellësisë së zemrës dhe pa kurrfarë dyshimi, në lidhje me ndonjë gjykim, mendim apo fjalë të drejtë.

Vërtetimi me gjuhë është të shprehurit me gjuhë të një gjykimi apo mendimi, e që një person tjetër mund ta dëgjojë. Me anë të këtij vërtetimi, nëse zemra dhe gjuha e thonë të njejtën gjë, atëherë personi vërtet e ka pranuar atë gjë. Të thuhet me gjuhë mirëpo mos të pranohet me zemër, ai person tek Allahu Teala është



rrenacak, mirëpo prapëseprapë deklarimin e tij ne e respektojmë.

Vërtetimi me vepër është kur veprohet sipas besimit që është pranuar dhe kur zbatohen vendimet e saj ashtu si duhet. Kur hyn koha e namazit dhe e shohim se një person është ngritur për ta falur namazin, ne bëhemi dëshmitar se ai e beson Allahun Teala dhe Muhammedin s.a.v.s.. Zembrën e di Allahu Teala, ne nuk e dijmë dhe nuk e kemi për detyrë ta dijmë.

Pejgamberi ynë s.a.v.s. kështu na e ka përshkruar imanin:

**“Ta besosh Allahun, Melaiket e Tij, Librat e Tij, të Dërguarit e Tij, Ditën e Ahiretit dhe të besosh në kader - të caktuarit e Tij i të mirës dhe i të keqes.”<sup>1</sup>**

Esenca e imanit në gjashtë pika:

- 1.Besimi në Allahun,
- 2.Besimi në Melaiket e Allahut,
- 3.Besimi në Librat e Allahut,
- 4.Besimi në Pejgamberët e Allahut,
- 5.Besimi në ditën e ahiretit dhe në ringjalljen pas vdekjes,
- 6.Besimi në kader dhe në kadha, që çdo gjë ndodh me pëlqimin dhe me krijimin e Allahut Teala.

---

<sup>1</sup> Buhari, Iman, 38 , Muslim, Iman,7; Ebu Davud, Sunnet, 17; Tirmidhi, Iman, 4.

Besimit në grumbull i të gjitha pikave të imanit quhet *"ixhmali iman"*. Një person i cili thotë: *"Unë besojë në ekzistencën e Allahut Teala, në njëshmërinë e Tij, në fenë që vjen prej Tij, në Pejgamberin e Tij, në urdhërat hyjnore dhe vërtetojë se të gjitha janë hak"*, atëherë për këtë person themi se imani i tij është i vlefshëm.

Kur esencat e imanit pranohen në një mënyrë të hapur, të gjerë dhe më të detajuar atëherë këtij imani i thuhet *"tafsil"*. Imani tafsil është kur Allahu Teala, Muhammedi s.a.v.s., ahireti dhe gjërat të cilat feja kërkon që të besohen, besohen me njohuri më të gjerë dhe më të detajuar.

Besimit që bëhet pa u thelluar në analiza dhe pa hulumtuar në dëshmi, vetëm në ato që është dëgjuar, i thuhet *"taklidi iman"* e që do të thotë besim i bazuar në imitim.

Për të hyrë në rrethin e imanit është e mjaftueshme t'i besohet një dijetari Islam dhe njohurive të tij rreth besimit, të besohet në Allahun Teala, në Pejgamberët e Tij, në ahiret dhe në gjërat tjera që janë të lidhura me gajbin. Por për të arritur të vërtetën e imanit, kënaqësinë e tij dhe për t'u mbrojtur prej personave që mohojnë dhe prej mendimeve anormale që nxisin

lëkundje dhe dyshim në besim dhe në fe, është e nevojshme të fuqizohemi me argumente fetare dhe mendore. Një mysliman i cili bie në dyshim për çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me esencat e besimit, është i obliguar të mësojë prej burimeve të sigurta dhe të besueshme, prej dijetarëve me besim të drejtë, të vazhdojë të kërkojë, të hulumtojë dhe të analizojë. Besimtarit me një besim të këtillë, i cili vepron si duhet, i shtohet bindja, shpëton prej gafletit dhe i afrohet Allahut Teala. Besimi i gritet prej imitimit në *“tahkik”*.

**Tahkiki iman:** Quhet imani i cili është fuqizuar me dëshmi fetare dhe mendore. Duke zgjuar zemrën, duke pastruar shpirtin prej ndyrësive të brendëshme, prej besimeve dhe mendimeve të kota, njeriu shpëton vetveten prej perdeve që janë pengesa për të arritur në të vërtetën dhe përfiton një gjendje *“thuase është duke e shikuar Allahun Teala”*. Kësaj gjendjeje i thuhet *“ihsan”*. Besimtarët e përkryer që e kanë arritur nivelin e *“ihsanit”*, posedojnë *“tahkiki iman”*. *“Tahkiki iman”* përfitohet duke studiuar, analizuar, duke lexuar, duke menduar si dhe duke pyetur ata që posedojnë *“tahkiki iman”*. Niveli i *ihsanit* përfitohet më së shumti me anë të edukimit shpirtëror. E pikërisht niveli i *“ihsanit”* është gjendja e soditjes hyjnore [mushahede]. Kësaj i thuhet edhe *“jakin iman”* [iman i bindur]. Ky iman fitohet kur kalohet në

nivelin *“nefsi mutmaine”*. Ky është niveli ku besimtari me tërë qenien e vet iu është dorëzuar Allahut Teala, ku Allahu Teala është i kënaqur me te dhe ai është i kënaqur me Allahun Teala. Dituria që fitohet në këtë nivel quhet *“irfan”* ndërsa poseduesi i saj *“arif”*. Dëshmitarët e Allahut Teala në sipërfaqen e tokës janë arifët. Dituria e irfanit, njohuritë dhe imani në të vërtetë mësohen prej mësimëve të tyre.

### **Të përkujtohen temat**

1-Çka është Kelime-i Shehadet?

2-Çka është kuptimi Kelime-i Shehadetit?

3-Çka është imani?

4-Sa lloj vërtetimesh ka?

5-Çka është *“ixhmal iman”*-i?

6-Çka është *“tafsil iman”*-i?

## GRUPET E NJERËZVE NË PIKËPAMJEN E IMANIT

Sipas pikëpamjes së imanit njerëzit ndahen në tre grupe:

**Muminët:** Ata që me sinqeritet besojnë në ekzistencën e Allahut Teala, në njëshmërinë dhe në urdhërat hyjnore që vijnë prej Tij.

**Qafirët:** Në këtë grup hyjnë ata që nuk i besojnë Allahut Teala dhe fesë Islame, ata që adhurojnë idhuj, ata të cilët i adhurojnë krijesat si dhe kanë besim të gabuar dhe të ndaluar [haram].

**Munafikët:** Në këtë grup hyjnë ata të cilët thonë se janë mumin mirëpo me zemër nuk besojnë dhe në këtë mënyrë mendojnë t'i bëjnë dëm fesë dhe muminëve. Këta janë më të dëmshëm se qafirat. Nëse vdesin në këtë gjendje edhe dënimi do të jetë më i fuqishëm.

Muminët të cilët futen në rrethin e imanit posedojnë shkallë të ndryshme. Në Kur'an muminët në përgjithësi janë prezantuar në dy grupe. Grupi i parë është grupi i quajtur "**As'hab-i Jemin**". Në ahiret këta do të marrin librin e veprave [amelit] në anën e djathtë dhe

si përfundim do të hyjnë në Xhenet. Grupi i dytë është grupi i quajtur **“Sabikun”** - ata që prijnë në besim dhe në vepra. Ky është grupi që prezantohet me cilësinë **“Mukarrabun”**. Në gjuhën e popullit këto dy klasa njihen si *“avam”* dhe *“havas”* [*“të rëndomtë”* dhe *“të veçantë”*].

Në mesin e muminëve janë edhe ata që e dijnë dhe besojnë se disa vepra janë haram mirëpo prapëseprapë bëjnë xhynahe të mëdha, e këtyre ju thuhet *“fasëk/gjynahqar”*.

Allahu Teala besimin e robëve të Tij e ka prezantuar në shkallë të ndryshme varësisht prej diturisë dhe veprave. Ajetet që e trajtojnë këtë temë thonë kështu:

**“Allahu lartëson ata që besuan prej jush, i lartëson në shkallë të lartë ata të cilëve u është dhënë dituri. Allahu është i njohur mirë me atë që punoni.”**

[58-Muxhadele: 11]

**“E, secilit sipas veprave që bën i takon shkalla, e shpërblimi për veprat e tyre do t’u plotësohet, e nuk u bëhet padrejtë.”** [46- Ahkaf: 19]

Imani shtohet dhe pakësohet. Shtimi dhe pakësimi nuk hyn në esencat e imanit. Njohuria e çdo zemre është e ndryshme në njohjen e Allahut Teala, në dashuri, në bindje, në shfaqjet hyjnore, në përkujtim dhe në falënderim ndaj Allahut Teala. Këto janë gjëra të cilat në zemër mund të ndryshojnë, të shtohen apo të pakësohen.

Përsosmëria e besimit [imani kemal] ka lidhje me nurin, njohurinë, zgjuarsinë dhe me shijimin. Në këto ajete tregohet se imani shtohet:

**“E , besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, të cilëve kur përmendet Allahu u rrënqethen zemrat e tyre, të cilëve kur u lexohen ajetet e Tij u shtohet imani dhe që janë të mbështetur vetëm te Rabbi i tyre” [8- Enfalë:2]**

**“Ai është që në zemrat e besimtarëve dhuroi qetësinë për të shtuar iman në imanin e vet që kishin.”**

[48- Fet-h: 4]

Ndërsa në hadithin e nderuar është urdhëruar kështu:

**”Kush jep për Allahun, pengon për Allahun, don për Allahun, hidhërohet për Allahun dhe martohet për Allahun, atij personi imani i arrin në përsosmëri [kemal].”<sup>2</sup>**

Në hadithin e njohur është lajmëruar se ai i cili ka iman edhe sa grimca do të nxirret nga Xhehenemi, pra edhe dikush që posedon vetëm kaq dashuri dhe dituri ndaj Allahut Teala i u është dhënë emri mumin. Sigurisht se imani i këtij personi nuk është i njejtë me imanin e atij mumini i cili do të hyj në Xhenet pa dhënë llogari.

---

<sup>2</sup>*Tirmidhi*, Sifatu'l Kijame, 60 Ahmed, Musned,III, 438; Ebu Ja'la, Musned, no; 1485, 1500.

Virtytet e sahabëve nuk kanë ardhur si pasojë e veprave të shumta, mirëpo për shkak se në zemrën e tyre ka pasur më tepër dituri, dashuri, bindje dhe sinqeritet. Lajmi për të cilin dëgjohet nuk është i njejtë me lajmin që shihet. Besimi i muminit i cili beson vetëm prej asaj që ka dëgjuar, nuk është i njejtë me besimin e muminit kamil [muminit të përsosur] i cili beson dhe bën ibadet sikur ta shihte Allahun Teala.

### **T'i përkujtojmë temat**

- 1-Në pikëpamjen e imanit sa grupe të njerëzve janë?
- 2-Kush është munafik?
- 3-Çka do të thotë "As'hab-i Jemin"? Nga kush përbëhet ky grup?
- 4-A është e mundur të shtohet apo pakësohet imani?



## KUR U BËMË MYSLIMAN?

Atij që na pyet: *“prej kur je mysliman?”*, ne i përgjigjemi: *“unë jam mysliman prej kalu-belasë!”*.

Nëse pyetja është: *“çka është kalu-bela?”* atëherë përgjegja është kjo:

Kalu-bela është marrëveshja e shpirtërave me Allahun Teala. Domethënia e saj është: *“Po dëshmuam, ti je Rabbi ynë”*. Para se t'i krijonte trupat, Allahu Teala krijoi shpirtërat, i mbledhi ato, i morri në prani të Tij dhe i bëri dëshmues së vetes së tyre duke u thënë: ***“A nuk jam Rabbi/krijuesi/zotëruesi juaj”***. Ata thanë: ***“Po, dëshmuam!”***

***“Kur Rabbi yt nxori nga kurrizi i bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i bëri të dëshmojnë kundër vetes së tyre, u tha: “A nuk jam Unë Rabbi juaj?” Ata u përgjigjën: “Po, dëshmojmë se Ti je!” Kështu bëri Ai, në mënyrë që ju [o njerëz] të mos thoni në Ditën e Kiametit: “Ne nga ky [dëshmim] ishim të panjohur.”***

***“Ose të mos thoni: “Prindërit tanë më parë ishin idhujtarë, e ne ishim pasardhës të tyre. A do të na shkatërrosh ne për atë që bënë ata asgjësues të së vërtetës?” [7-A'rafë: 172-173.]***

Allahu Teala në këtë marrëveshje i mbajti për dëshmitarë edhe melaiKET. Kjo është marrëveshja e parë ndërmjet Allahut Teala dhe robëve të Tij. Neve edhe pse nuk na kujtohet, për këtë marrëveshje na tregon dhe na përkujton Allahu Teala në Kur'an.<sup>3</sup>

Kësaj mbledhjeje [mexhlisi] në të cilën është bërë kjo marrëveshje i thuhet *"Elest Bezmi"*.

Sot ata që janë mumin dhe mysliman, në atë mexhlis me sinqeritet thanë: *"Po, ti je Rabbi ynë"*. Prej aty fillon imani në Allahun Teala. Prandaj edhe thuhet: *"Mysliman jam prej Kalu Belasë"*.

Ata të cilët janë kafirë dhe munafikë dhe të cilët vdesin në këtë gjendje, në atë mexhlis kanë thënë po, mirëpo në këtë botë atë marrëveshje e kanë thyer, Allahun Teala e kanë mohuar, krijesat i kanë adhuruar ose kanë mbetur peng të nefsi emares [egos urdhëruese]. Ata i harruan obligimet ndaj Krijuesit të Madh, ibadetin e robërimin, e për këtë gjë e merituan edhe xhehenemin me të drejtë.

Ata të cilët kanë mend dhe kanë arritur moshën e pubertetit, nëse nuk i dalin zot marrëveshjes që kanë bërë me Rabbin e tyre, e harrojnë Rabbin e adhurojnë gjësendet, nuk do të kenë lumturi as në këtë botë e as në

---

<sup>3</sup> Razi, Tefsir-i Kebir.

ahiret. Kjo për shkak se duke qenë pa iman dhe duke bërë shirk njeriu shkatërrohet, ajo është e keqja më e madhe për zemrën e njeriut, shpirtin e tij, ndërgjegjen e tij dhe për jetën e tij. Në qoftë se nuk pendohet, dënimi i tij do të bëhet edhe më i madh.

Fëmija që akoma nuk ka arritur moshën për të zgjedhur në mes të mirës dhe të keqes, lirohet prej përgjegjësisë ndaj kësaj marrëveshjeje dhe ndaj urdhërave të fesë. Atyre nuk ju shkruhen gjynahet. Mirëpo për punët e mira dhe ibadetet që kryejnë, atyre të cilët i kanë mësuar, prej prindërve apo hoxhallarëve ju shkruhet sevap.

Ata të cilët janë të privuar prej nimetit të mendjes, janë të çmendur, nuk kanë përgjegjësi ndaj urdhërave dhe ndalesave të Allahut.

Ai që ka mend dhe ka arritur në moshën e pubertetit, nëse në mënyrë të drejtë dhe definitive nuk ka dëgjuar për parimet themelore të fesë Islame, gjithashtu nuk është përgjegjës për urdhërat dhe ndalesat e Allahut. Ndërsa atij të cilit i ofrohet mundësia dhe nuk hulumton, duke e dëgjuar të drejtën dhe duke e parë ate, dhe prapëseprapë bie në besim të gabuar duke ju larguar Islamit dhe duke mohuar, ai mbahet përgjegjës.

Ata të cilët nuk kanë dëgjuar për Islam [për urdhërat e fesë] nuk kanë përgjegjësi ndaj tyre. Mirëpo nëse kanë ndonjë mendim se janë gjëra hyjnore dhe adhurojnë dikë, si p.sh. njeriun, kafshët, diellin, hënën apo krijesat e tjera, atëherë mbahen në përgjegjësi. Mendja e njeriut normal ka kapacitet për të ditur se këto nuk mund të jenë Krijuesi.

### **T'i përkujtojmë temat**

- 1-Çka është Kalu Bela?
- 2-Çka është Elest Bezmi?
- 3-Kush nuk është përgjegjës ndaj urdhërave të fesë?

## FITRATI JONË DHE FEJA

Feja është edukimi dhe urdhërat e Allahut Teala. Fe do të thotë gjithashtu rruga që e çon robin tek Allahu Teala. Feja përmban urdhëra hyjnore dhe edukim moral të cilat i sigurojnë njeriut lumturinë në këtë botë dhe në ahiret.

Fitrat do të thotë: krijim, natyrshmëri, ves dhe karakter. Allahu Teala e ka krijuar njeriun në fitratin më të mirë dhe me aftësitë dhe veçoritë më të mira. Njeriut i dha një shpirt të veçantë, e këtij shpirti i dha cilësi shumë specifike dhe njeriun e zgjodhi përfaqësues [halife] në mesin e krijesave të veta. Allahu Teala ia ngarkoi atij amanetin.

Si gjithësia ashtu edhe njeriu, që të dy janë pronë e Allahut Teala. Allahu Teala ka vendosur ligje në gjithësi dhe ato njihen si *“rendi hyjnor”* apo *“rregulli hyjnor”*, dhe për njeriun ka vendosur një edukim të cilit i thuhet *“feja hyjnore”*. Si robi ashtu edhe feja, që të dy i takojnë Krijuesit të Lartë.

Allahu Teala e ka krijuar njeriun sipas kësaj feje dhe e ka urdhëruar ta jetojë këtë fe në një mënyrë të lehtë.

Të thuash *“unë nuk mund t’i bëjë ibadet Allahut Teala”* nuk vie si rezultat i vështirësisë së fesë mirëpo prej kundërshtimit të egos së njeriut dhe vesveseve të shejtanit.

Atë që ka urdhëruar Allahu Teala është në përshtatshmëri me natyrën e njeriut dhe zbatimi i këtyre urdhërave është gjithashtu i përshtatshëm për trupin e njeriut. Feja jonë është e lehtë. Feja Islame urdhëron urdhëra të lehta sipas gjendjes së çdokujt, qoftë ai qytetar apo fshatar, dijetar apo injorant, i shëndoshë apo i sëmurë, mashkull apo femër, i ri apo plak. Allahu Teala na përkujton në këtë mënyrë veçorinë e fesë sonë si një mirësi:

**“Luftoni me një luftë të denjë për hir të Allahut, se Ai ju zgjodhi ju dhe nuk ju obligoi në fe me ndonjë vështirësi.”** [22- Haxhxh:78.]

Neve kështu na drejtohet Resulallahu s.a.v.s.:

**“Çdo fëmijë lind në fitratin e Islamit [me mundësinë për ta kuptuar dhe për ta jetuar fenë Islame si dhe i aftë për ta jetuar moralin hyjnor], ndërsa prindërit e tij e bëjnë jahudi apo të krishterë apo ia imponojnë zjarrputizmin [në këtë mënyrë del prej gjendjes së vërtetë dhe rrugës së hakut]”.**

**“Ngjashëm ndodh edhe tek kafshët. Një kafshë lind në gjendje normale me të gjitha organet, mirëpo njeriu ja pret hundën apo ja shpon veshin apo e lë shterpë. Në këtë mënyrë kafsha merr një formë tjetër. Njëjtë, edhe fëmijën rrethi i keq e ndërron, e prish”.<sup>4</sup>**

Në një hadith kudsî Allahu Teala përshkruan se si priset njeriu:

**“ Unë i krijova të gjithë robërit e Mi me një cilësi, që vetëm Mua të më robërohen, mirëpo atyre ju erdhën shejtanët dhe i larguan prej fesë së tyre. Ato që Unë i bëra hallall, shejtanët atyre ju bënë haram, dhe ata i urdhëruan të më bëjnë shirk dhe të ndryshojnë ate që Unë e krijova”.<sup>5</sup>**

### **T’i përkujtojmë temat**

1-Çka është feja?

2-Çka është fitrat?

3-Kush e prish dhe si priset fitrati i njeriut?

---

<sup>4</sup> Buhari, Xhenaiz, 80; Kader, 3; Muslimi, Kader, 22-24; Ebu Davud, Sunnen, 17, Tirmidhi, Kader, 5; Muvatta, Xhenaiz, 52; Ahmed, Musned, II, 233, 253, 275.

<sup>5</sup> Muslimi. Xhenet, 63; Sunen-i Kubra, Fedailul-Kur’an,49.

## VIRTYTET E IMANIT

Imani është një nur të cilin Allahu Teala e vendos në zemrën e robit të vet. Kur vendoset ky nur brenda në zemër, ai e pastron atë nga të gjitha ndyrësitë e shirkut dhe të kufrit.

Imani është një amanet hyjnor dhe pasuria më e madhe e njeriut. Ai është një vetëdije hyjnore e tillë që po të gjendet vetëm sa grimca në zemrën e njeriut, ai njeri prej kësaj bote shkon me iman dhe përfundimisht hyn në Xhenet. Ky iman është një dhunti prej Allahut Teala, është vepra e zemrës, si dhe dashuri e fshehtë e shpirtit ndaj Rabb-it të tij të Lartë e që fillon prej *“Kalu Bela”*-së. Vetëm pak prej imanit është shumë, ndërsa vlerën e tij në botë nuk ka asgjë që mundet ta vlerësojë.

Zotëriu ynë Resulallahu s.a.v.s. vlerën e imanit kështu e ka shpjeguar:



**“Allahu Teala e pyet qafirin i cili e ka dënimin më të lehtë në ahiret:**

**“Po të ishin bota dhe të gjitha gjërat në botë tuajat, a do t’i ipje për të shpëtuar prej këtij dënimi?” ai thotë:**

**“Po, do t’i ipja.” Atëherë Allahu Teala i thotë:**

**“Duke qenë akoma në kurrizin e Ademit, të kërkova gjërat më të lehta prej teje. Të thash mos më bëjë ortak mua që mos të të fus në zjarr, mirëpo ti u largove dhe hyre në shirk.”<sup>6</sup>**

Po, vetëm një grimcë e imanit është më e vlefshme dhe më e dobishme se të gjitha pasuritë e botës. Këtë e sqaron ajeti Kuranor se nëse nuk gjindet iman në zemër, në botën e ardhshme edhe gjithë botën po ta japësh, ajo nuk do të pranohet dhe nuk mund të shpëtosh prej dënimit.

**“Edhe pse do të vihen të shohin njëri-tjetrin. Për të liruar veten nga dënimi i asaj dite, fajtori do të sakrifikonte me gjithë qejf fëmijët e vet, edhe gruan, edhe vëllanë e vet, edhe farefisën, që i gjendej pranë [në jetën e Tokës], si dhe të gjithë ata që gjenden në faqe të Tokës, nëse kjo do të mund ta shpëtonte.**

**“ Por jo, [fajtori do të hidhet në zjarr]! Ai është zjarr flakërues.” [ 70 - Mearixh 11-15],**

---

<sup>6</sup> Buhari,Rikak,51; Muslim,Sifatu’l-Kijame.51.

E për atë që ka iman në zemër sa grimca, Allahu Teala do t'i urdhërojë melaiket: **"Nxjerreni prej Xhehnnemit atë"**. [janë hadithet rreth kësaj].<sup>7</sup>

Sa pasuri e madhe është kjo. Sa lumturi e bukur është dashuria ndaj Allahut. Dëgjojeni lajmin e mirë, çfarë myzhde na jep Pejgamberi i Rahmetit, Resulallahu s.a.v.s.:

**"Kush dëshmon me sinqeritet prej zemre dhe thotë se nuk ka ilah tjetër përveç Allahut dhe vdes mbi këtë dëshmi, ai do të hyj në Xhenet."**<sup>8</sup>

**"Kush dëshmon se nuk ka ilah tjetër përveç Allahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i Allahut, Allahu atij Xhehenemin ja bënë haram."**<sup>9</sup>

**"Allahu Teala në ditën e kiametit ju jep urdhër melaikeve kështu:**

**"Në qoftë se dikush më ka përkujtuar mua qoftë edhe vetëm një ditë apo është frikësuar prej meje në një vend (ku nuk gjinden njerëzit) dhe del para meje (duke mos më mohuar) atëherë nxjerreni ate prej zjarrit".**<sup>10</sup>

---

<sup>7</sup> Buhari, Iman, 34; Muslim, Iman, 325; Tirmidhi, Sifatu Xhehenem 9. – Kuptimi është sipas rivajetit të Tirmidhiut.

<sup>8</sup> Ahmed, Musned V, 236, Ibnu Hibban, Sahih ,no 200; Tabarani, el-Kebir, XX ,41 [No62]; Hajsemi, Mevaridu'z-Zaman,I, No; 4-7.

<sup>9</sup> Muslim, Iman, 29; Tirmidhi, Iman, 17.

<sup>10</sup> Tirmidhi, Sifatu Xhehenem, 9.

Imani halis e shpëton njeriun prej dënimit të përjetshëm.

Halis do të thotë: i pastër, i papërzier, i pa prishur.

Imani halis është imani në të cilin nuk gjindet shirku brenda.

Imani halis është imani vetëm për Allahun, me dashuri ndaj Allahut dhe me frikë prej Allahut.

Imani halis është të pranosh atë që e ka urdhëruar Allahu Teala ashtu si është pa e prishur fare. Kjo do të thotë se atë që feja e ka pranuar si hallall, është hallall dhe atë që e ka bërë haram, është haram.

### **T'i përkujtojmë temat**

- 1-Pse është imani kaq i vlefshëm?
- 2-Çka është cilësia i imanit që e shpëton njeriun prej Xhehenemit?

## EHL-I SUNNETI MEDH'HEBET E BESIMIT

Ehl-i Sunneti nënkupton grupin që beson dhe jeton sipas Kuranit dhe Sunnetit. Muhammedi, Resuli i Allahut s.a.v.s. thotë:

**“Ummeti im do të ndahet në shtatëdhjetë e tre grupe, të gjithë do të jenë në xhehenem përveç njërit.”**

Ata që ishin prezent thanë: *“O Resulallah, cili është grupi i cili do të shpëtojë?”* Resulallahu s.a.v.s. tha:

**“Ata që janë në rrugën time dhe të as’habëve të mi.”**<sup>11</sup>

Ky grup i shpëtuar quhet **“Frka-i Naxhije”**. Emërtim tjetër i këtij grupi është edhe **“Ehl-i Sunnet ve’l Xhemaat”**. Të gjitha medh’hebet e vërteta dhe rrugët e edukimit hyjnë në këtë grup. Për shkak se të gjithë bazohen në themelet e Kur’anit dhe Sunnetit dhe në përfundim janë të njëjtë. Ata janë sikur degët e pemës, shembull i tyre është sikur gishtat e një dore, të gjithë lidhen në të njëjtin burim, e përkrahin dhe e plotësojnë njëri-tjetrin. Rethi i Ehl-i Sunnetit është i gjërë. Është gabim të prezentohet Ehl-i Sunneti si rruga e një medh’hebi të vetëm, një zakoni apo e vetëm një mendimi.

---

<sup>11</sup> Tirmidhi, Iman, 18.

10 Ebu Davud, Sunnet,1; Ibn Maxhe,Fiten.17 Ahmed, Musned, III, 145.

Pika ku takohen të gjitha medh'hebet e vërteta në besim dhe në vepra, është pika që ka përcaktuar Kur'ani dhe Sunneti. Qëllimi i këtyre medh'hebeve nuk është përfitimi personal apo politik. I gjithë mudi i imamëve të medh'hebeve ka qenë që të kuptohet, të tregohet dhe të jetohet qëllimi i dëshirueshëm i Allahut Teala dhe e Resultit të Tij.

Medh'hebi i parë i vërtetë i cili përmendet është medh'hebi **"Selefijje"**.

Selef do të thotë: ata të cilët kanë prirur, gjeneratat e mëparshme, të mëdhenjtë e së kaluarës. Në përgjithësi emri selef i ipet gjeneratës së parë dhe gjeneratës pas tyre, të cilët në mënyrën më të bukur janë përputhur me Resulallahun s.a.v.s. dhe kanë ndjekur rrugën e tij. Gjithashtu selef i thuhet edhe salihëve të cilët kanë qenë para nesh dhe të cilët kanë shkuar rrugës së hakut.

Para se të paraqiten medh'hebet e itikadit [besimit], akideja e myslimanëve ka qenë akideja\* e selefëve, që do të thotë se është akideja e sahabëve dhe e gjeneratës së tabiinëve.

Esenca e kuptimit të këtij medh'hebi është pranimi i ajeteve dhe haditheve pa komentim, duke i pranuar ato ashtu siç janë.

\* Akaid [sh.e akide]: gjërat që besohen në Islam; hakikatet që besohen; vendimet dhe urdhërat që hyjnë në besim; esencat; akidet

Sa i përket itikadit, hanbelitë në përgjithësi kanë përvetësuar pikëpamjen e selefëve. Më vonë në fushën e itikadit në mesin e myslimanëve kanë lindur edhe dy medh'hebe të vërteta: medh'hebi Maturidije dhe medh'hebi Esha'rije.

**Maturidije:** Themeluesi i këtij medh'hebi është Imam Maturidi [rah]. Emri i tij i plotë është Muhammed b. Muhammed. Ai mban emrin Ebu Mansur mirëpo më shumë përmendet si Ebu Mansur Maturidi. Ka lindur në vitin 238 hixhri - [852] në Semerkand në fshatin Maturidi, me emrin e të cilit edhe njihet më tepër. Ka vdekur në vitin 333 Hixhri [944] në Semerkand. Metoda e përgjithshme është kjo: bashkë me shpalljen të përdoret edhe mendja, si dhe nëse ka nevojë edhe ajetet dhe hadithet të interpretohen. Në itikad shumica e medh'hebit Hanefi ka përvetësuar parimet e Maturidiut.

**Esh'arije:** Imami i medh'hebit Esh'arije është Ebu'l-Hasen el-Esh'ari. Emri i tij i vërtetë është Ali b. Ismail. Ka lindur në vitin 260 hixhri -[873] në Basra. Soji i tij vjen prej sahabiut të nderuar Ebu Musa el- Esh'ariut prandaj edhe përmendet si Esh'ari. Ka vdekur në vitin 324 hixhri - [936] në Bagdad. Në itikat shumica e medh'hebit Shafi ka përvetësuar parimet e esh'ariut dhe është e përhapur më tepër tek ta. Gjithashtu edhe malikitë në itikat kanë përvetësuar këtë medh'heb. Maturiditë dhe Esh'aritë ndryshojnë në shumë pak tema.

Medh'hebet Selefije, Maturidije dhe Esh'arije përfaqësojnë besimin e Ehl-i Sunnet-it.

Përpos këtyre medh'hebeve që u përmendën janë paraqitur edhe disa medh'hebe dhe mendime të tjera mbi besimin. Në krye të këtyre grupeve janë: Harixhije, Shia, Mutezile, Myrxhije, Xhebrije dhe Myshebbihe. Gjithashtu edhe shumë degë të këtyre grupeve janë prezente. Këto grupe nuk përfaqësojnë Ehl-i Sunnetin. Në shumë pikëpamje kanë gabime dhe kanë mendime që janë jashta vijës së Hakkut. Për këtë arsye ata thirren "ehli bidat" mirëpo nuk konsiderohen qafirë.

Në ditët e sodit ekzistojnë edhe shumë mendime të tjera të ndryshme si filozofi, rryma dhe grupacione të cilët nën emra modernë ju premtojnë njerëzve lumturi. Këto janë rrugë të gabuara të cilat shejtani i prezenton të bukura dhe për nefsin janë të këndshme. Një rrugë në krye të së cilës nuk gjindet Pejgamberi i Rahmetit Muhammed Resulallahi s.a.v.s., është rrugë që nuk të afron tek Allahu Teala, nuk të dërgon në xhenet dhe nuk jep lumturi të përjetshme.

**T'i përkujtojmë temat:**

- 1-Çka do të thotë Ehl-i Sunnet?
- 2-Cila është Frka-i Naxhije?
- 3-Çka është esenca e besimit të Selefëve?
- 4-Çka është medh'hebi Maturidije?
- 5-Çka është medh'hebi Esh'ari?

## KUSHTET PËR TA BËRË IMANIN E VËRTETË

Për të qenë Imani i vërtetë dhe i vlefshëm tek Allahu Teala duhet të plotësohen këto kushte:

1. Vazhdimësi dhe qëndrueshmëri: ai që hyn në rrethin e imanit duhet të jetë i vazhdueshëm në te deri sa të vdes dhe të ketë nijet të sinqertë të del me iman në prani të Allahut Teala. Ai që nuk e ka nijet të vazhdojë në iman dhe mendon që pas një kohe të kthehet në kufër, imani i tij nuk është i vërtetë dhe nuk është me vlerë.

2. Mos të gjendet farë dyshimi në iman. Ato gjëra që besohen mos të pranohen me dyshim, ndërsa parimet e besimit të cilat janë farz të pranohen në mënyrë të përpikët.

Tjetër gjë është të pranohet ekzistenca e gjërave në të cilat besohet dhe tjetër është të kuptohet vërtetësia [hakikati] e tyre. Nëse një person thotë se Rabbi im është Allahu dhe se Ai është Një, Pejgamberi im është Muhammedi s.a.v.s., feja Islame të cilën ai e solli, urdhërat dhe ligjet e saja janë të vërteta, se melaiket ekzistojnë dhe se ka ahiret dhe llogaridhënie, atëherë edhe nëse nuk i kupton plotësisht se si janë ato, për atë person imani i tillë është i vlefshëm.



3. Imani duhet të jetë në përputhje me besimin e Ehl-i Sunnet ve'l Xhemat-it. Kjo është mënyra e imanit e cila kërkohet prej nesh. Besimet, ibadetet dhe veprat e mira të cilat nuk janë në përputhje me Kuran dhe Sunnet nuk kanë vlerë tek Allahu Teala.

Nuk është i vërtetë dhe i vlefshëm imani i atij i cili thotë se është mysliman, mirëpo sharron në besime të gabuara, komenton Kuranin dhe Sunnetin sipas dëshirës së vet dhe që zhytet në rrugë të cilat janë jashta rrugës që dëshiron Allahu dhe Resuli i Tij.

4. Imani duhet të jetë ndërmjet frikës dhe shpresës [havf dhe rexha]. Mumini, shpreson në rahmetin e Allahut, faljen e Tij dhe hyrjen në xhenet mirëpo gjithashtu duhet të jetë edhe në gjendje frike prej hidhërimit dhe dënimit.

Nuk është e drejtë të thuhet: *“Unë sigurisht do të hyj në xhenet në saje të këtyre veprave të mira”!* Gjithashtu nuk është e drejtë t'i prehet shpresa në rahmetin e Allahut asnjë qafiri apo gjynahqari dhe nuk është e drejtë të thuhet se Allahu mua nuk do t'më fal.

Qafiri mund të vijë në iman para se të vdes, mirëpo Allahu na ruajt edhe mumini mund ta humb imanin.

Gjykimi është sipas përfundimit e përfundimin e din vetëm Allahu Teala.

Për këtë arsye mumini duhet ta kërkojë rahmetin e Allahut, ta kërkojë xhenetin dhe ta merr malli për bukurinë e Tij, e gjithashtu duhet të ketë frikë prej dënimit dhe xhehenemit si dhe të kërkojë mbrojtje prej këtyre dyjave. Shpresa duhet të jetë më e madhe se frika dhe duhet të kemi mendim të mirë për Allahun Teala.

5. Besimi duhet të jetë me dëshirë dhe me dashuri, dhe nuk lejohet të kërkohet në kohën kur është prerë shpresa për jetë. Kur vie shpirti në fyt dera e teubes për robin mbyllet dhe imani në atë moment nuk ka ndonjë dobi. Këto momente, gjendjen e besimit dhe të teubes, ajetet e Kuranit i përshkruajnë në këtë mënyrë:

**“Ditën kur vijnë disa shenja të Rabb’it tënd, asnjë njeriu nuk i vlen besimi i Tij nëse nuk ka besuar më parë ose nuk ka bërë në besimin e tij kurfarë të mire.”**

[6-En’amë: 158.]

**“Teubeja e pranueshme te Allahu është vetëm e atyre që e bëjnë të keqen me mosdije e pastaj shpejt pendohen; të tillëve Allahu ju pranon pendimin. Allahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë .”** [4-Nisa: 17.]

**“Nuk është pendim i pranueshëm i atyre që vazhdimisht bëjnë punë të këqija dhe vetëm atëherë kur t’i vjen vdekja ndonjërit prej tyre, të thotë: “Unë tash u pendova” e as i atyre që vdesin duke qenë jobsimtarë. Ndaj tyre kemi përgatitur dënim të ashpër.”**

[4-Nisaë: 18.]

6. Imani duhet të ruhet prej fjalëve dhe lëvizjeve të cilat mund ta dëmtojnë.

Imani nuk pranon shaka. Edhe në shaka po të thuhet se dola prej fesë është rrezik. Me parimet e imanit hajgare nuk bëhet. Po të jetë edhe në shaka, nuk bën të mohohet Allahu Teala dhe Resulallahu s.a.v.s., si dhe parimet e fesë nuk bën të përulen.

Imani është në rrezik po që se thuhet se në këtë kohë feja nuk jetohej, imitohet ai që është armik i fesë, mënyrën e jetës së atij që është në kufër e sheh si të bukur, zullumet e tij i pëlqen, lavdërohen dhe çmohen njerëzit të cilët janë në kufër dhe në kryengritje, urdhërat e Allahut nuk zbatohen.

7. Duhet të ruhem prej gjynaheve të cilat e asgjësojnë imanin, që e dobësojnë dhe e mbysin zemrën. Po që se konsiderohet hallalli haram, e harami hallall, ajo e nxjerr njeriun prej fesë.

Nëse dikush haramin nuk mundet ta braktis atëherë mos ta mohoj atë si haram. Nëse punon gjynahe atëherë duhet të bëhet nijet që ato të braktisen dhe të dihet se është farz të bëhet pendimi [teubeja]. Në të njëjtën mënyrë nëse dikush ka braktisur ibadetet që janë farze, nuk duhet t'i mohojë ato si farze. Nëse p.sh. namazin e pranon se është farz dhe pa ndonjë arsye e braktis atë, atëherë ai person bëhet gjynahqar. Mirëpo nëse dikush e braktis namazin dhe e mohon se ai është farz, atëherë ai person del prej fesë. Ai duhet të pendohet, ta pranoj gabimin dhe ta përtërijë imanin.

### **T'i përkujtojmë temat**

- 1-Cilat kushte duhet plotësuar që të pranohet Imani Salih?
- 2-A është e drejtë ta shohësh veten sigurt në Xhenet?
- 3-Deri kur vlen pendimi?
- 4-Çka është gjykimi në imitimimin e besimit dhe veprave të qafirëve dhe gjynahqarëve?
- 5-Çfarë është gjendja e atij që farzin e pranon farz mirëpo nuk e vepron?

## BESIMI NË ALLAHUN

**“Allah”** është emri i veçantë i qenies [dhat] së Lartësuar, Krijuesit, Sundimtarit dhe Pronarit të gjithësisë dhe tërë krijesave. Në emrin **“Allah”** gjenden të gjitha cilësitë hyjnore [sifatet hyjnore]. Duke thënë **“Allah”**, përnjëherë janë bërë dhikër [përmendur] të gjithë Emrat e Bukur [Esmā-ul Husnā]. Asnjë krijese apo qenieje nuk mund t’i ipet emri **“Allah”**.

Allahu Teala është pronari/zotëruesi i tërë gjithësisë. Ai është ilahi tek, i Vetmi të cilit duhet t’i bëjmë ibadet. Ai është që i krijojti të gjithë njerëzit dhe gjithësinë prej mos ekzistencës, Ai është që atyre u jep jetë dhe i mban gjallë, është shpërndarësi i rrizkut, udhëzuesi dhe drejtuesi i krijesave dhe Ai është që merr jetë dhe jep jetë. Ai është pronari dhe sundimtari i çdo gjëje.

Ne besojmë në ekzistencën dhe njëshmërinë e Allahut Teala ashtu si na ka mësuar Ai. Mendja dhe dituria jonë nuk janë të mjaftueshme për të njohur Qenien e Tij. Allahu Teala, njihet vetëm duke vendosur nur në zemrën tonë, dashuri, dituri dhe zgjuarësi. Kësaj i thuhet hidajet. Hidajet është, kur Allahu Teala e hap zemrën e robit dhe vendos nur brenda. Ky nur është që e hap syrin e zemrës dhe e drejton ate kah Allahu Teala.

## A MUNDET TË PËRFYTYROHET ALLAHU TEALA?

**“Asgjë nuk i shëmbëllen Atij.” [42-Shu’ra: 11].**

Allahu Teala dëshmon se asnjë krijesë nuk i përngjan në qenie [dhat], në cilësi [sifate] dhe në veprime. Si mund të paramendohet një ekzistencë me të cilën nuk ka ngjashmëri?

Me çka mund ta krahasojmë atë?

Meqenëse kjo temë është e ndjeshme dhe me rrezik atëherë duhet të kemi shumë kujdes. Zotëriu ynë Resulallahu s.a.v.s., na ka ndaluar të paramendojmë qenien e Allahut Teala. Se çka mund të mendojmë na ka përcaktuar në këtë mënyrë:

**“Qenien e Allahut Teala mos e mendoni, mirëpo mendoni nimetet e Tij dhe krijesat që Ai i ka krijuar, për shkak se ju nuk keni fuqi ta mendoni qenien e Allahut Teala, shkatërroheni.”<sup>12</sup>**

Qenia e Allahut Teala nuk përfytyrohet.

Një grup që është zhytur në mendime rreth qenies së Allahut Teala ra në shirk duke e përngjarë atë me ndonjë krijesë. E këtij grupi i thuhet “grupi Myshebbihe dhe Muxhessime”.

---

<sup>12</sup> Ebu Nuajm VI,67; Tebarani,el-Vasit .No;631; Hejsemi,Mexhmua’z-Zevad I, 81; Ebu;sh- Shejh, Kitabu’l-Azamet; No; 4-5.

Disa të tjerë duke thënë se te Allahu Teala nuk gjinden sifetet që gjinden te njeriu si dëgjimi, shikimi, dashuria, durimi e të ngjajshme, duke i mohuar të gjitha sifetet e Tij, ranë në qyfër. Këtij grupi i thuhet “muattila”.

Ne si Ehl-i Sunnet jemi larg prej këtyre dy kuptimeve. Ne nuk ia përngajmë asnjë send Lartësisë së Rabbit tonë dhe nuk e mohojmë asnjë sifet/cilësi që i takon Atij. Ne për qenien e Allahut Teala besojmë dhe dorëzohemi ashtu si na ka njoftuar Kurani i Madhëruar dhe si jemi njoftuar prej gjuhës së Resulullahut s.a.v.s.

Në lidhje me këtë temë është shumë e bukur fjala e Imam Shafiut rah:

*“Dikush duke dëshiruar ta njihë Krijuesin e Lartësuar, nisat me mendjen e vet të imagjinojë një krijesë dhe e supozon se është Krijuesi i tij. Ai është mushebbih, e ka përngjarë krijesën me Allahun Teala.*

*Po ky person, nëse me mendimin e tij nuk arrin të një ekzistencë dhe gjykon me mosekzistencë, ai e ka mohuar Allahun Teala.*

*Në qoftë se, me mend e kupton se ekziston një Krijues, mirëpo thotë se është i pafuqishëm ta kuptojë hakikatin e tij, ai person është muvahhid, ka besuar në njëshmërinë e Allahut Teala.”*

Allahun Teala ne nuk e përngjajmë me ndonjë krijesë dhe qenien e Tij nuk mund ta imagjinojmë. Ne nuk mund ta dijmë se si është Ai duke e imagjinuar. Ai nuk i përngjan asnjë krijese që mund të imagjinohet.

Ai nuk ka ndonjë partner, ndonjë krahasim apo dikë të ngjashëm që ne ta shohim, dhe të themi se po i përngjan atij.

Dijetarët tonë për këtë gjendje kanë deklaruar shkurtimisht kështu:

***Çdo gjë që vjen në mend, mendohet, imagjinohet, i jepet formë apo i përngjan një gjëje, ai s'është Allah.<sup>13</sup>***

Arifët\* në këtë botë, e njohin Allahun me zemër. Afrimi ndaj Tij bëhet me zemër. Të arrihet tek Ai është punë e shpirtit dhe e zemrës. Rruga e këtij edukimi qëndron mbi sunnete dhe devotshmëri.

Afërsia e Allahut Teala ndaj atyre të cilët Ai i don nuk është në afërsi fizike, mirëpo në mëshirë [rahmet], dritë [nur], dituri [ilm], dashuri, dhe përkrahje.

---

<sup>13</sup> Sharani, el-Jevakit ve'l- Xhevahir, I, 58

\* Arif [rrjedhë prej fjalës Irfan]: ai që di; ai që njeh; i ditur; ai që në dituri është përpara; ai që njeh Hakkun; ai që me Hakk e njeh Hakk-un.



Të bëhesh fena\* në Allah, nuk do të thotë të humbësh me trup në qenien e Tij. Kjo do të thotë të humbesh me shpirt, zemër dhe me të gjitha esencat shpirtërore në dashurinë e Allahut, vullneti apo dëshira e vetes të nënshtrohet në vullnetin apo dëshirën e Atij, ta duash atë që Ai e don, për Allahun të hidhërohesh, për Allahun të marrësh, për Allahun të japësh, thënë shkurt do të thotë të jetosh për Allahun. Kësaj i thuhet grada e kënaqësisë [makami riza]. Në këtë gradë robi bëhet i kënaqur me Allahun Teala, si dhe Allahu Teala bëhet i kënaqur me të. Ja pra kjo është gjendja dhe cilësia e “njerëzve të përkryer” [insani kamil].

Përveç besimit të cilën e përmendëm më lartë , të tjerat si: integrim me Allahun, humbje në qenien e Tij, hyrje e Allahut në ty apo të thuash se e ke parë Allahun në një vend me sytë e ballit, kjo është kufër.

#### **T’i përkujtojmë temat:**

- 1-Çfarë emri është emri i Lavdishëm “Allah”?
- 2-Pse nuk mund të mendohet qenia e Allahut Teala?
- 3-Si bëhet afrimi ndaj Allahut?

\*Fena: [në tasavvuf-fena fillah]: humbje; zhytje; shkrirje.

## SIFATET E ALLAHUT TEALA [CILËSITË]

Ne e njohim Qenien e Allahut Teala me cilësitë të cilat i takojnë Atij. Cilësitë e Allahut Teala ndahen në dy pjesë:

### SIFATET E DHATIT [CILËSITË E QENIES]

Këto cilësi janë të veçanta vetëm për qenien e Allahut Teala, për shkak se këto cilësi pos Tij nuk i posedon asnjë ekzistencë tjetër dhe është e pamundur t'i ketë. Përmbledhja e këtyre cilësive është paraqitur në këtë ajet:

**“Asgjë nuk i shëmbëllen Atij. Ai i dëgjon të gjitha dhe i sheh të gjitha.” [ 42-Shura 11.]**

Këtyre cilësive ju thuhet “selbi sifate” si dhe “tenzihi sifate”. Tenzih dhe selb e kanë të njëjtin kuptim, e që do të thotë se gjërat që nuk i takojnë Allahut Teala janë larg prej emrit të Tij.

Për shembull, kur themi se Allahu ekziston atëherë ne kemi refuzuar asgjësimin. Kur themi se Ai është Ezel, ekzistimi i Tij nuk ka fillim, ne e refuzojmë krijimin e Tij të mëvonshëm apo të mëpastajshëm. Duke thënë se Ai është tek dhe se Atij nuk i përngjan asnjë send, ne refuzojmë të përshkruarit ortak ndaj Tij. Kjo gjendje vlen edhe për sifatet tjera. Cilësitë e qenies janë gjashtë e këto janë:

**1. VUXHUD:** Domethënë ekziston. Ekzistenca e Allahut Teala është prej vetit. Askush nuk e ka krijuar Allahun Teala; ekzistenca e Tij nuk është prej një ekzistence tjetër. Çdo gjë që ekziston në gjithësi është prej Allahut Teala. E tëra është nën dëshirën dhe në dorën e Allahut Teala. Çdo gjë fillon prej Allahut Teala dhe mbaron me vendimin e Allahut Teala. Përpos Allahut Teala nuk ka tjetër ekzistencë që ekziston vetvetiu.

**2. KIDEM:** Ekzistimi i Allahut Teala nuk ka fillim [evvel]; Ai është ezel [që ekziston gjithmonë]. Ekzistenca e Tij nuk është e lidhur me kohë.

**3. BEKA:** Ekzistenca e Tij nuk ka fund; është i pa fund, i përjetshëm.

**4. MUHALEFETYN LI'L-HAVADIS:** Allahut Teala nuk i përngjan asnjë krijesë të cilën Ai e krijoi, dhe Ai nuk mund të mendohet me mend dhe me imagjinatë. Ai është përtej të gjitha formave dhe mendimeve që mund të vijnë në mendjen e njeriut. Atij nuk i përngjan asnjë gjë.

**5. KIJAM BI-DHATIHI:** Ekzistenca e Tij është prej vetit. Nuk ka nevojë për dikë tjetër. Përkundrazi çdo gjë ka nevojë për Allahun Teala. Ai është që çdo gjëje i jep jetë, trup/ qenie/ ekzistencë, formë, rrizk dhe jetëgjatësi.

**6. VAHDANIJET:** Allahu Teala, si në emra, si në cilësi, si në qenie është tek, është një i vetëm. Në qenie, në cilësi e në punë nuk ka ortak apo partner, të ngjajshëm apo dikë me të cilin mund të krahasohet.

### **SIFATET THUBUTI [CILËSITË THUBUTI]**

Nëpërmjet këtyre cilësive Allahu Teala na paraqitet se çfarë Rabbi është Ai. Këto cilësi u janë dhënë edhe njerëzve në mënyra të ndryshme, mirëpo në mes të cilësive të Allahut Teala dhe cilësive të njerëzve ka ngjashmëri vetëm sa i përket emërtimit. Allahu Teala me të gjitha cilësitë, qoftë me “sifatet dhati” qoftë me “sifatet thubuti” është tek dhe nuk ka partner apo ngjashmëri.

Janë gjithsej tetë “sifate thubuti” e ato janë:

**1. HAJAT:** [Jeta] Allahu Teala është i gjallë, posedon jetë. Veçanërisht është burimi i jetës. Prej Allahut vjen e tërë jetesa dhe gjallëria. Jeta e krijesave fillon me dëshirën e Tij, si dhe vazhdon me mëshirën dhe fuqinë e Tij.

**2. ILM:** [Dituria] Allahu Teala di për çdo gjë që ndodh dhe që do të ndodhë. Dituria e Tij përfshinë çdo gjë prej nën tokës e deri mbi qiell. Në rruzullin e tokës e në qiell nuk mbetet asnjë gjë as sa grimca jashta diturisë së Tij.

**3. IRADE:** [Dëshira] Me dëshirën dhe vullnetin e Allahut Teala bëhet çdo gjë. Ai çkado që dëshiron e krijon. Çdo gjë ekziston me dëshirën e Tij. Ashtu si don Ai ashtu edhe bëhet. Asgjë në këtë botë nuk bëhet nëse Ai nuk don. Në gjithësi çdo gjë që ndodh si lindja apo vdekja, ekzistenca apo mos ekzistenca, e mira apo e keqja, dëgjueshmëria apo kryengritja, realizohet brenda diturisë dhe dëshirës së Allahut Teala.

**4. KUDRET:** [Fuqia] Allahu Teala ka fuqi të bëjë çdo gjë që dëshiron. Për Te nuk ka ndonjë vështirësi për diçka. Për Allahun Teala është njëjtë si të krijojë një qelizë si të krijojë qiejt. Njëra prej tjetrës nuk është më e vështirë apo më e lehtë.

**5. SEMI:** [Dëgjimi] Do të thotë dëgjimi i Allahut Teala. Ai dëgjon çdo gjë, çdo zë, zhurmë dhe lëvizje. Dëgjimi i Tij nuk është me vesh.

**6. BASAR:** [Shikimi] Do të thotë se Allahu Teala sheh çdo gjë. Nuk mbetet asnjë send në tokë e në qiell jashta shikimit të Tij. Allahu Teala sheh çdo gjë ndërsa shikimi i Tij nuk është me sy. Allahu Teala sheh edhe milingonën e zezë e cila lëviz mbi një gur të zi në errësirën e natës, dëgjon zërin e këmbës duke lëvizur edhe atij i jep rrizkun.

**7. KELAM:** [Të folurit] Allahu Teala flet. Nuk ka nevojë për zë, shkronjë dhe gojë. Allahut Teala nuk i nevojitet drejtimi, zëri, mjeti, instrumenti apo koha në mënyrë që të flas. Me këtë cilësi ka folur me Pejgamberët dhe Melaiket, e nëpërmjet tyre i ka njoftuar njerëzit me urdhërat. Edhe në Ahiret, në Xhenet do të flet me miqët e Tij mumin.

**8. TEKVIN:** [Krijimi] Do të thotë se Allahu Teala krijon. Ai krijon çka të dëshiron dhe në formën që Ai e dëshiron. Ai krijon çdo send prej mosekzistencës, asgjëson diçka që ekziston dhe e bën të bukur çkado që Ai dëshiron. Të gjitha krijimet e kanë një urtësi [hikmet], janë të nevojshme për t'u krijuar dhe e kanë një shkak [sebeb]. Ai nuk bën ndonjë punë që është e panevojshme, e padobishme apo boshe. Edhe nëse mendja jonë nuk e kupton, çdo gjë që është krijuar e që ekziston në këtë gjithësi, e ka një shkas [sebeb], një dobi, nevojë dhe vend.

Në këtë botë sprovuese, janë të nevojshëm si melaiket ashtu edhe shejtanët. Si dita ashtu edhe nata. Si bleta ashtu edhe mushkonja e ka një detyrë. E mira – e keqja, shëndeti – sëmundja, e hidhura – e ëmbla, vdekja – lindja, miku – armiku, pasuria – varfëria, të gjitha këto kanë një dituri prapa, një urtësi dhe shërbejnë për edukim. Nëse dikush në këtë botë shikon me qasje të

mirë, në çdo gjë mund të sheh bukuri. Nëse dikush nuk e ka zemrën e bukur, ai edhe në Xhenet po të vendoset do të kërkojë të meta.

Të gjitha krijimet e Allahut Teala janë ose drejtësi ose rahmet.

Allahu Teala nuk i bën askujt padrejtësi apo zullum. Ai është larg prej këtyre mangësive. I pastër e i lartë është Ai.

Të gjitha melaiket, njerëzit, shtazët, toka, qiejt dhe të gjitha krijesat e tjera që janë brenda tyre janë pronë e Tij. Ai punon në pronën e Tij ashtu siç dëshiron dhe gjykon Ai. Ai nuk jep llogari për punët që bën. Askush nuk mund të kërkojë llogari prej Tij, ndërsa Ai kërkon llogari nga çdokush.

**T'i përkujtojmë temat:**

- 1-Cilat janë cilësitë e qenies së Allahut Teala?
- 2-Çka do të thotë "Kidem dhe Beka" ?
- 3-Çka do të thotë "Kijam bi Datihî"?
- 4-Cilat janë "sifatet thubuti"?
- 5-Çka do të thotë "tekvin"?

## EMRAT E BUKUR TË ALLAHUT TEALA ESMA-I HUSNA

Esma-i Husna do të thotë: emrat më të bukur. Emrat më të bukur janë emrat e Allahut Teala. Këta emra përdoren edhe si cilësi. Ekzistojnë shumë emra që i takojë Allahut Teala, mirëpo numrin e tyre e di vetëm Ai.

Një pjesë të emrave të bukur Allahu Teala e ka përmendur në Kur'an, një pjesë ia ka treguar Pejgamberit tonë Muhammedit s.a.v.s. dhe të dashurve të tij, ndërsa një pjesë e ka mbajtur në diturinë e Tij.

Në një hadith të njohur janë përmendur një nga një nëntëdhjetë e nëntë emra. Dijetarët kanë thënë se emrat tjerë të cilët janë jashta këtyre nëntëdhjetë e nëntë emrave, e kanë kuptimin brenda këtyre nëntëdhjetë e nëntë emrave. Prandaj, po të lexohen, të kuptohen dhe të përmenden këta nëntëdhjetë e nëntë emra, në fakt janë lexuar, janë kuptuar dhe janë përmendur të gjithë emrat.<sup>14</sup>

Ndërsa Resulallahu s.a.v.s. na thotë kështu:

**“Allahu Teala ka nëntëdhjetë e nëntë emra dhe kush i njih këta emra dhe i din përmendësh, ai hyn në Xhenet.”<sup>15</sup>**

---

<sup>14</sup> Shiko: Ahmed, Musned, I, 391; Ibnu Hibban, Sahih, no: 972; Elbani, es-Sahih, no: 198.

<sup>15</sup> Buhari, Deavat, 76; Muslim, Dhikir, 5-6; Tirmidhi, Davet, 8.



Në një rivajet të Imam Tirmidhiut, Resulallahu s.a.v.s. e ka radhitur në këtë mënyrë Esmā-i Husnën:

Allahu është ilah, tjetër ilah përveç Tij nuk ekziston, er-Rahman, er- Rahim, el- Melik, el- Kuddus, es-Selam, el- Mumin, el-Muhejmin, el-Aziz, el-Xhebbar, el-Mutekebbir, el-Halik, el-Bari, el-Musavvir, el-Gaffar, el-Kahhar, el-Vehhab, er-Razzak, el-Fettah, el-Alim, el-Kabid, el-Basid, el-Hafid, er-Rafi, el-Muizz, el-Muzill, es-Semi, el-Basir, el-Hakem, el-Adl, el-Latif, el-Habir, el-Halim, el-Azim, el-Gafur, esh-Shekur, el-Alijju, el-Kebir, el-Hafiz, el-Mukit, el-Hasib, el-Xhelil, el-Kerim, er-Rakib, el-Muxhib, el-Vasi, el-Hakim, el-Vedud, el-Mexhid, el-Bais, esh-Shehid, el-Hakk, el-Vekil, el-Kavijju, el-Metin, el-Velijj, el-Hamid, el-Muhsi, el-Mubdiu, el-Muid, el-Muhji, el-Mumit, el-Hajj, el-Kajjum, el-Vaxhid, el-Mexhid, el-Vahid, es-Samed, el-Kadir, el-Muktedir, el-Mukaddim, el-Muahhir, el-Evvel, el-Ahir, ez-Zahir, el-Batin, el-Vali, el-Muteali, el-Berru, et-Tevvab, el-Mustekim, el-Afuvvu, er-Rauf, Maliku'l-Mulk, Dhu'l-Xhelali ve'l-Ikram, el-Muksit, el-Xhami, el-Ganijj, el-Mugni, el-Mani, ed-Darr, en-Nafi, en-Nur, el-Hadi, el-Bedi, el-Baki, el-Varis, er-Rashid, es-Sabur [Xhele Xhelaluhu].<sup>16</sup>

---

<sup>16</sup> Tirmidhi, Deavat, 82; Hakim, Mystedrek, I, 16; Ibnu Hibban, Sahih, no: 808.

Në një rivajet të Imam Hakimit janë përmendur edhe këta emra: el-ilah, er-Rabb, el-Hannan, el-Mennan, el-Ehad, el-Kafi, ed-Daim, el-Mevla, el-Mubin, el-Xhemil es-Sadik, el-Karib, el-Vitru, el-Ekremu, Dhu't-Tavli, Dhu'l-Fadli, Dhu'l-Mearixh, el-Hallak, el-Kefil.

Nëpërmjet haditheve nuk është bërë me dije se emrat e Allahut Teala me kaç përfundojnë. Kjo do të thotë se Allahu Teala ka nëntëdhjetë e nëntë emra të cilat nëse mësohen përmendësh, ju besohet atyre, vazhdimisht përmenden si dhe përfitohet prej bereqetit të tyre, merr prej tyre aq sa meriton, përfundimisht edhe hyn në Xhenet.

Këta emra ndryshe quhen edhe *“Emrat Ihsa”*.

Ihsa ka tre kuptime: të numërosh, të mësosh përmendësh dhe të kuptosh [të arrihet të kuptohen me vetëdije].

#### **Të përkujtohen temat:**

1-Çka do të thotë Esmā-i Husnā?

2-A janë gjithsej nëntëdhjetë e nëntë emra të Allahut Teala?

## RREGULLAT E SJELLJES NË LIDHJE ME ESMA-I HUSNA

Fjala **“Allah”**, është emër i veçantë i Krijuesit tonë. Prej këndvështrimit të vërtetë ky emër i veçantë nuk rrjedh prej asnjë fjale tjetër dhe nuk ju është dhënë asnjë krijese tjetër dhe as që do t’i ipet ndonjëherë.

Emri i lavdishëm **“Allah”**, përmbledh brenda vetes të gjithë emrat e tjerë dhe përfshin kuptimet e të gjithë emrave.

Dikush që bënë dhikër [përmend] emrin e lavdishëm **“Allah”** është sikur t’i ketë bërë dhikër të gjithë emrat e Esmat Husnas.

Me përjashtim të emrit të lavdishëm **“Allah”**, emrat tjerë përdoren edhe për robët, vetëm se përpara emrit bashkangjitet fjala **“abdu”** që e ka kuptimin rob. Për shembull në vend të Kadir ipet emri Abdulkadir e që do të thotë robi i Kadrit.

Në të njejtën mënyrë në vend të Kerim bëhet Abdulkerim, në vend të Samed bëhet Abdussamed, në vend të Gaffar bëhet Abdulgaffar. Nëse përdoren emrat në këtë mënyrë atëherë merr kuptimin e vërtetë dhe eliminojmë shqetësimin në përdorim.

Disa emra prej Esmat Husnas përdoren në mënyrë të drejtpërdrejt edhe për robët mirëpo kuptimin ja atribuojmë robit e jo Allahut Teala. Për shembull, Allahu Teala në Kur'ani Hakim e ka quajtur veten "El-Mumin", mirëpo emri "Mumin" iu është dhënë edhe Pejgamberit të Tij dhe atyre të cilët janë nënshtruar. Fjalët janë të njejtë mirëpo kuptimet janë të ndryshme.

Kur përmendet një emër prej Esmat Husnasë, i shtohet emri **Xhel'le Xhelaluhu dhe Xhel'le Shanuhu** në shenjë nderimi dhe respekti, e që ka kuptimin "qoftë i lartësuar dhe i madhëruar".

Pas emrit të lavdishëm Allah mjaftueshëm është të thuhet "**Teala**". Mund të thuhet edhe shprehja "**Xhel'le Xhelaluhu**".

Ne nuk duhet të kënaqemi me varje në mure të Esmat Husnasë. Prej neve kërkohet të dihen përmendësh apo të lexohen dhe të përmenden emrat e Rabb-it tonë të

lavdishëm. Me rekomandimin e dijetarëve, po të përmenden Esmā-i Husnā mund të shërohen shumë sëmundje materiale dhe shpirtërore. Për këtë gjë është kusht sinqeriteti, edukimi dhe kafshata hallall.

Ata të cilët dëshirojnë ta lexojnë Esmā-i Husnā si vird ditor [përmendje e vazhdueshme] nuk duhet ta bëjnë sipas preferencës së vet mirëpo preferohet ta bëjnë me anë të këshillave dhe mësimëve të një dijetari. Një ilaç që nuk mirret në kohën e duhur dhe sipas mënyrës së duhur e shton sëmundjen edhe më tepër.

### **T'i përkujtojmë temat**

1-A mund t'i ipen robëve emrat  
e Allahut të Madhëruar?

2-Cili emër i takon vetëm  
Krijuesit tonë të Madhëruar?

## A MUNDET ANIJA PA KAPITEN?

*Një grup mohuesish erdhën tek Imam-i Azam Ebu Hanife rah. Ky grup mohonte ekzistimin e Allahut Teala dhe mohonin që Ai është Krijuesi i gjithësisë. Ata donin të debatonin rreth kësaj çështje dhe donin t'i futnin myslimanët në dyshim. Duke e ditur qëllimin e tyre, Imam-i Azam rah. e fillojë bisedën kështu: “Pa hyrë në këtë çështje unë dua t’ju pyes ju një send: në lumin Dixhle është një anije e cila nuk ka kapiten, dhe duke mos pasur as ndihmës anija lëvizën vet drejt një bregu, mbushet me ushqim dhe gjëra të tjera dhe pas kësaj e merr rrugën vet, aty ku duhet shkon, ngarkesën që ka brenda e shkarkon dhe kthehet prapa. Çfarë thoni ju në lidhje me këtë?” Të gjithë njerëzit njëzëri thanë:*

*“Kjo punë nuk bëhet, diçka e tillë assesi nuk ka mundësi të ndodhë. Si ka mundësi që një anije t’i bëjë këto punë vet”. Atëherë Imami dha përgjegjën e duhur:*

*Kur këto punë janë të pamundura për një anije, si ka mundësi e tërë kjo gjithësi vet të krijohet, të lëvizë e brenda saj të jetojnë krijesa të ndryshme. Atëherë njerëzit heshtën, dhe e kuptuan se kjo gjithësi dhe vet ata nuk kanë mundësi të jenë pa pronar.<sup>17</sup>*

*Ata të gjithë u bënë mysliman para Imamit.*

<sup>17</sup> Shiko: Alijju’l-Kari, Sherhu Fikhi’l-Ekber, 22.

## BESIMI NË MELAIKE

Prej esencave të imanit, e dyta me radhë është besimi në melaike. Allahu Teala kështu i urdhëron muminët që t'i besojnë melaikeve:

**“I dërguari i beson asaj që iu shpall prej Rabbit të Tij, e ashtu edhe besimtarët. Secili i beson Allahut, melaikeve të Tij, shpalljeve të Tij, të dërguarëve të Tij.”**

[2-Bekare: 285.]

Melaiket janë krijesa të cilat Allahu Teala i ka krijuar prej nurit. Resulallahi s.a.v.s. na informon kështu:

**“Melaiket janë krijuar nga nuri, e xhinët nga zjarri i flakëruar, kurse Ademi është krijuar nga ajo çka u është thënë në Kur’an.”<sup>18</sup>**

Melaiket janë krijesa të ndershme, të vlefshme, të lavdishme, të pastërta e të këndshme të cilat Allahu Teala i ka krijuar për ibadet, zbatimin e urdhërave të Allahut Teala, dhikër, falënderim ndaj Allahut Teala dhe për detyra specifike.

---

<sup>18</sup> Muslim, Zuhd, 10; Ahmed, Musned, VI, 168.

Melaiket janë krijuar para njeriut:

**“[Përkujto Muhammed] Kur Rabbi yt u tha melaikeve: “Unë po krijoj [po përcaktoj] në tokë një zëvendës”! Ata thanë: “A do të vëshë në te atë që bënë çrregullime dhe që derdh gjaqet, e ne të madhërojmë Ty me lavdërimin Tënd dhe plotësisht të adhurojmë”! Ai tha: “Unë di atë që ju nuk e dini”!**

**E ai[Allahu] ia mësoi Ademit të gjithë emrat pastaj ata ua prezantoi melaikeve dhe u tha: “Më tregoni për emrat e këtyre nëse jeni të drejtë [çka mendoni]”?**

**[Melaiket] Thanë: “Ti je i pa të meta, ne nuk kemi dije tjetër përveç atë që na e mësove Ti. Vërtetë, Ti je i Gjithëdijshmi, i Urti!”**

**[Allahu] Tha: “O Adem, njoftojë ata [melaiket] me emrat e atyre!” E kur u rrëfeu atyre për emrat e tyre, Allahu tha: A nuk u kam thënë juve se Unë, më së miri e di fshehtësinë e qiejve e të tokës dhe më së miri e di atë, që ju e publikoni dhe atë që e mbani fshehtë.”**

**E kur u thamë melaikeve: “Përluni [bini në sexhde] Ademit, ata menjëherë iu përlunë, me përjashtim të Iblisit [shejtanit]. Ai refuzoi dhe u mbajt në të madh dhe u bë pabesimtar.” [2- Bekare: 30-34.]**

Melaiket kanë detyra në çdo vend, si në tokë, në qiell e në Arsh. Nuk mund të shihen me sy dhe gjenden në botën e padukshme - gajb. Mund të marrin shumë forma.



Muhammedi s.a.v.s. i ka parë melaiket kohë pas kohe dhe ka biseduar me ta. Veçanërisht me melekun e shpalljes, Xhebrailin a.s. është takuar shpesh, ka biseduar dhe është përshendetur. Me leje hyjnore melaiket ndonjëherë janë takuar edhe me njerëz të tjerë dhe kanë biseduar me ta, bile edhe sot mund të shihen dhe të bisedohet me ta. Në vazhdim po e japim shembullin e Merjemes:

**“Përkujto kur melaiket i thanë: ”O Merjeme, Allahu të dalloj ty [me besim e karakter] të pastroi [nga shpifjet hebreje] dhe të lartësoi mbi gratë e botës.**

**Oj Merjeme, vazhdoje adhurimin ndaj Rabbit tënd, bën sexhde dhe falu për Rabbin bashkë me ata që falen!**

**Këto janë nga lajmet e fshehta [të hershme] që po t’i shpallim ty. Ti nuk ishe ndër ta kur i hidhnin shortet se kush prej tyre do të bëhej kujdestar i Merjemes, nuk ishe pranë tyre as kur ata ziheshin mes vete.**

**Përkujto kur melaiket i thanë: ”Oj Merjeme, Allahu të përgëzon me fjalën e vet [me lindjen e një fëmije si rezultat i fjalës së Rabbit] emri i të cilit është Mesih, Isa, bir i Merjemes, i famshëm në dynja e ahiret dhe nga të afërmit.” [3- Ali Imran: 42-45].**

**Ajo, vuri një perde ndaj tyre, e Ne ia dërguam asaj Xhibrilin, e ai iu paraqit asaj njeri në tërësi.**

**Ajo tha: "Unë i mbështetem të Gjithëmëshirshmit prej teje, nëse je që i frikësohesh Atij [pra më lë të lirë]!"**

**Ai [Xhibrili] tha: "Unë jam vetëm i dërguar [melek] i Rabbit tënd për të dhuruar ty një djalë të pastër [pejgamber]"**

**Ajo tha: Si do të kem unë djalë, kur mua nuk më është afruar njeri [nuk jam e martuar], e as nuk kam qenë e pamoralshme."**

**Ai [Xhibrili] tha:"Ja, kështu ka thënë Rabbi yt; ajo për mua është lehtë, e për ta bërë atë [djalin e krijuar pa babë] argument për njerëzit e edhe mëshirë nga ana e Jonë. Kjo është çështje e kryer!" [19-Merjeme: 17-21.]**

Edhe as'habët e ndershëm e kanë parë Xhebrailin në formë të njeriut në prani të Muhammedit s.a.v.s..

Melaiket nuk hajnë dhe nuk pijnë prej ushqimit të kësaj bote. Ushqimi i tyre është nuri i Allahut Teala, njohuria, dhikri dhe dashuria. Melaiket nuk kanë gjini. Nuk shumohen me lindje. Allahu Teala krijon melaiket sa të dëshiron dhe kur të dëshiron. Vetëm Allahu Teala e di numrin e tyre.

Melaiket nuk bëjnë punë të këqija dhe nuk ju afrohen fare punëve të këqija. Melaiket nuk kanë nefs, epsh, dëshira të këqija dhe nevojë, sikurse ka njeriu. Melaiket vazhdimisht lartësojnë Allahun Teala, bëjnë

hamd, lavdërojnë dhe iu rrijnë gati urdhërave. Katër melaïke janë kryesorët:

1-**Xhebraili**; është Meleku i shpalljeve [vahj]. Ai sjell urdhërin e Allahut Teala tek Pejgamberët. Prej melaïkeve është më i madhi dhe kryetari [reis].

2-**Mikail**; është i ngarkuar me detyrën e ndodhive natyrore dhe ndarjen e furnizimit [rrizkut].

3-**Israfili**; ka për detyrë t'i fryej një mjeti që quhet "sur" në kohën para se të bëhet kijameti dhe të shpall lajmin e tmerrshëm.

4-**Azraili**; ka për detyrë të merr shpirtërat me urdhërin e Allahut Teala.

Melaïket të cilat kanë për detyrë mbrojtjen e njeriut quhen melaïket "**Hafaza**" [mbrojtës].

Melaïket të cilat shkruajnë veprat e mira dhe veprat e këqija quhen "**Kiramen Katibin**" [që shkruajnë].

Melaïket të cilat marrin në pyetje njerëzit në varr janë melaïket "**Munkir**" dhe "**Nekir**".

Disa melaïke kanë për detyrë t'i ndihmojnë miqtë e Allahut Teala.

Melaïket vazhdimisht bëjnë dua për muminët, bëjnë istigfar për gjynahet e tyre dhe kërkojnë falje për ta ditë e natë.

Ka melaïke të cilat kanë për detyrë të vizitojnë mbledhitë [mexhliset] e dhikrit dhe të diturisë [ilmit] dhe të cilët bëjnë istigfar dhe dua për ta.

Ka melaïke që kanë për detyrë t'i bartin Pejgamberit tonë s.a.v.s., salavatet që bëhen për te dhe me njohjen e atyre që bëjnë salavat.

Ka melaïke që iu bashkangjiten muminëve në dua dhe bashkë me ta thojnë "Amin".

Ka melaïke të cilët janë ndihmës të Azrailit a.s. në momentet kur i merr shpirtërat. Njerëzve me ahlak të bukur në momentin e vdekjes, këto melaïke u japin selam, u sjellin lajm të mirë, u thonë të mos frikësohen dhe njerëzve që janë duke dhënë shpirt ju bëhen gëzim, si dhe ju bëhen ndihmës të kalimit në ahiret.

Përveç këtyre melaïkeve, ka melaïke të tjerë në tokë e në qiell, në dynja e në ahiret, që kryejnë detyrat me të cilat janë ngarkuar nga Allahu Teala e që numrin e tyre e di vetëm Ai.

Kështu pra, është e obliguar [farz] për çdo mysliman, t'i besojë melaïkeve dhe t'i dojë ata. Nëse melaïket mohohen, tregohet armiqësi ndaj tyre, përshkruhen si vajza apo djem të Allahut Teala, kjo gjë është kufër, është haram dhe njeriun e nxjerrin prej fesë.

Ashtu si i panë Pejgamberët melaïket me lejen dhe me mundësinë që e jep Allahu Teala, ashtu edhe mumi me zemër të pastër e me moral të mirë, duke qenë mik [veli] i Allahut Teala, ka mundësi t'i shohë dhe të bisedojë me ta.

Melaiket janë ushtarët e Allahut Teala. Nëpërmjet melaikëve Ai i dërgon ndihmë muminëve në botë dhe në ahiret e miqëve të Tij u jep mbështetje dhe fuqi. Shembuj të tillë ka shumë.

## **SHEJTANËT DHE XHINËT**

Përveç melaikëve është edhe një grup tjetër i krijesave i cili duhet të besohet, e ata janë xhinët. Xhinët nuk mund të shihen me sy të jashtëm. Për shkak të ngjashmërisë me melaiket në këtë aspekt, është e përshtatshme të bëhet fjalë për xhinët pas melaikëve.

**“Xhindët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.”** [51- Dharijatë : 56.] Ky ajet na njofton për ekzistencën e xhinëve dhe për detyrat e tyre.

Exhinët janë krijuar para njeriut.

**“E xhinët i krijuam më parë nga zjarri, nga flaka e fortë ”** [15-Hixhr: 27.]

**“Dhe Ai krijoj xhinët nga flaka [pa tym] e zjarrit.”**

[55-Rrahman : 15.].

Shejtani është prej grupit të xhinëve. Emri i vërtetë i shejtanit është Iblis. Një emër tjetër i tij është edhe Azazil. Shejtani është cilësia e tij. Shejtani është koka e të gjitha të këqijave, armiku më i egër i njeriut. Për shkak se u dëbua prej mëshirës së Allahut Teala ai njihet më shumë me emrin “shejtan”.

“Kur Rabbi yt u tha melaikeve: “Unë po krijoj një njeri nga balta,

dhe kur ta kem përsosur atë dhe t’i kem dhënë nga ana Ime shpirt, ju menjëherë përlunju atij [në sexhde]” Melaiket, të gjithë së bashku iu përlën, përveç Iblisit që ishte kryelartë dhe që u bë prej jobesimtarëve.

[Allahu] Tha: “O Iblis, çka të pengoi ty t’i përulesh atij që Unë vetë e krijova? A bëre kryeneçësi, apo ke qenë prej atyre që shesin fodullëk?”

Ai [Iblisi] tha: “Unë jam më i mirë se ai, mua më ke krijuar nga zjarri, e atë e krijove nga balta!”

[Allahu] Tha: “Dil pra prej tij [prej Xhenetit], ti je i mallkuar. Dhe largimi prej mëshirës Sime ka për të përcjellë deri në ditën e gjykimit!”

Ai tha: “Rabbi im, më jep afat deri ditën e ringjalljes!”

[Allahu] Tha: “ Po, je prej të afatizuarëve, deri në kohën e ditës së caktuar!”

Ai tha: “Pasha madhërinë Tënde, kam për t’i shmangur prej rrugës së drejtë që të gjithë, përveç atyre që janë të sinqertë nga robërit Tu!”

[Allahu] Tha: “Pasha të vërtetën, e Unë e flas vetëm të vërtetën:

Unë do ta mbushi Xhehenemin me ty dhe me të gjithë ata që vijnë pas teje.” [38-Sad: 71-85.].

Përveç njerëzve edhe xhinët janë të obliguar me Islamin të cilën e solli Muhammedi s.a.v.s.. Për shkak se Muhammedi s.a.v.s. është peygamberi i njerëzve dhe i xhinëve ai ndryshe quhet edhe *“Resulu’s-Sekalejn”*, e që do të thotë peygamberi i dy grupeve të mëdha.

Xhinët me iman dhe të cilët janë nënshtruar do të hyjnë në Xhenet, ndërsa qafirët dhe të devijuarit do të hyjnë në Xhehenem.

**“Sikur të kishim dëshiruar Ne, secilit njeri do t’i jepnim udhëzimin, por fjala [vendimi] Ime ka marrë fund [definitive] se do ta mbushë Xhehenemin së bashku me xhinë e njerëz.”** [32- Sexhde: 13.].

Kur’ani dhe sunneti na kanë dhënë shumë dituri rreth xhinëve. Në mënyrë që të ruhem prej dëmit të xhinëve na ka mësuar shumë dua dhe masa parandaluese. Xhinët e posaçërisht shejtani i jap njeriut shqetësime me anë të vesveseve, e fut në dyshim, mundohen ta pengojnë prej rrugës së drejtë dhe mirësisë, ia ëmbëlson bestytnitë, ia zbukuron haramin dhe të këqijat ia ekspozon si të bukura. Deri në vdekje ai mundohet ta egërsojë muminin dhe ta ndajë prej rrugës së drejtë. Mirëpo kurrfarë dëmi nuk mund t’iu bëjë atyre të cilëve me tërë zemrën i janë drejtuar Allahut Teala, të devotshmëve, të sinqertëve dhe atyre të cilët vazhdimisht e përmendin Allahun Teala. Allahu Teala i ka marrë ata në mbrojtje të veçantë.

**“Vërtet, ata që janë të ruajtur, kur i prek ndonjë iluzion nga shejtani, ata përkujtojnë [Allahun] dhe atëherë shohin [të vërtetën].” [7-A’rafë : 201.]**

**“Se ti ndaj robëve të Mi [të sinqertë] nuk ke kurrfarë force [as fizike as mendore], përveç atyre të humburve që vijnë pas teje.” [15-Hixhr: 42.]**

**“Vërtet, ai [shejtani] nuk ka kurrfarë fuqie kundër atyre që besuan dhe i janë mbështetur Rabbit të tyre.”**

[16- Nehl: 99.]

Në mënyrë që të ruhemi prej dëmit të shejtanit, duhet të kujdesemi shumë për pastërtinë e trupit, të rrobave, të shtratit, të vendit ku jetojmë dhe të vendit të punës. Papastërtinë e vizitojnë më shumë xhinët se sa melaiket. E rekomandueshme është që vazhdimisht të jemi me abdes, të falim pesë kohët e namazit, të lexohet Ajetu’l-Kursia, Ihlas-i, Felek-u dhe Nas-i mëngjes e mbrëmje, të japim sadaka dhe të bëjmë sa ma shumë salavat.

#### **Të përkujtohen temat:**

- 1-Prej çkafit janë të krijuar Melaiket?
- 2-Çka janë të veçantat e Melaikeve?
- 3-Cilët janë katër Melaiket e mëdhenj?
- 4-Çfarë detyre kanë Melaiket “Kiramen Katibin”?
- 5-Çka është detyra e Melaikeve “Munkir” dhe “Nekir”?



## NDIHMA QË VJEN PREJ QIELLIT

*Tregon Enesi r.a.:*

*Ishte prej As'habëve të Pejgamberit s.a.v.s. njëri me emrin Ebu Ma'lek. Ky person bënte tregti për vete dhe në emër të tjerëve dhe udhëtonte në rrugë të largëta. Ishte person që bënte shumë ibadet, i devotshëm dhe me moral të mirë. Një ditë u nis për në rrugë për të bërë tregti. Rrugën ia preu një hajn i armatosur dhe i tha:*

*- Nxjerri përpara të gjitha që i ke në dorë. Unë do të vras! Ebu Ma'lek ia ktheu:*

*- Ja ku e ke mallin, qoftë i yti, mirëpo lëshom mua. Hajni tha:*

*- Nuk e dëshiroj mallin tënd, unë dëshiroj të të vras.*

*Ebu Ma'lek i tha:*

*- Më jep leje t'i fali katër rekate namaz.*

*- Falu sa të duash – i tha hajni.*

*Ebu Ma'leku mori abdes, pastaj u fal dhe pas namazit i ngriti duart dhe tha:*

*“O Miku i Lartë, o Pronari Madhështor i Arshit, o Allahu im që bën çka dëshiron. Për nder të Madhërisë dhe Fuqisë Sate e që askush nuk mund t'a bëjë të kundërtën, për nder të Sundimit tënd e që askush nuk mund të përjetojë zullum dhe padrejtësi, për nder të nurit që e mbush Arshin, dëshiroj të më ruash prej të keqes së këtij vjedhësi. O Ti prej të cilit kërkohet ndihma, më ndihmo mua, o*

*Rabbi im". Këtë dua e përsëriti tre herë. Në atë moment u paraqit një njeri në kalë. Ai e kishte një mizrak të cilin e kishte vendosur ndërmjet veshëve të kalit dhe me shpejtësi u vërsul në drejtim të hajnit. Kur e pa hajni personin në kali u drejtua kah ai, ndërsa kalorësi që kishte një shtizë në dorë e goditi dhe hajni vdiq. Pastaj kalorësi iu kthye Ebu Ma'lek'it dhe i tha:*

*Ngritu. Ebu Ma'leku i tha: Nëna dhe babai t'u bëfshin ty kurban, kush je ti? Sot Allah'u Teala më ndihmojë me ty? Kalorësi i tha:*

*Unë jam një melek i cili gjindet në katin e katërt të qiellit. Duke e bërë ti duanë e parë, e dëgjova trokitjen në dyert e qiellit. Duke e bërë duanë herën e dytë, e dëgjova britmën e melaikëve që gjinden në qiell. Pastaj, kur e bëre duanë për herën e tretë, unë dëgjova këtë: "Kjo është duaja e robit Tim i cili është duke u frikësuar". Unë kërkova leje prej Allahut Teala për t'i ndihmuar atij që është duke bërë dua dhe kërkova ta vras hajnin. Mu dha leja dhe erdha të ndihmojë ty.*

*Enes r.a. ka thënë:*

*"Kush mer abdes, fal katër rekate dhe me anë të kësaj duaje kërkon diçka prej Allahut Teala pa marr parasysh se a është apo nuk është në vuajtje, ajo dua do t'i pranohet".*

19

---

<sup>19</sup> Ibnu Ebī'd -Dynja, K.Myxhabe'd-Da,ve,No:23;Ibnu-Haxher,el-Isabe,IV,182;Kandehlevi,Hajatu's-Sahabe,V,180.

## BESIMI NË LIBRAT

Allahu Teala i ka dërguar disa Pejgamberë me libra e disa me fletushka në mënyrë që robët e Tij nëpërmjet urdhërave në këta libra të njoftohen me rrugën e drejtë e të vërtetë dhe të mësojnë se si të jetojnë. Është farz t'iu besohet këtyre librave dhe të punohet sipas librit të Tij të fundit. Katër libra të mëdhenj u janë dërguar këtyre Pejgamberëve:

**1-ZEBURI:** Davutit Alejhisselam,

**2-TEVRATI:** Musait Alejhisselam,

**3- INXHILI:** Isait Alejhisselam,

**4-KUR'AN-I KERIM:** Muhammedit Alejhisselam.

Ndërsa fletushkat që janë zbritur janë këto:

10 fletushkat e Ademit a.s.; 50 fletushkat e Shit't a.s.; 30 fletushkat e Idrizit a.s.; 10 fletushkat e Ibrahimit alejhisselam.

Kur'an-i Fisnik ka zbritur i fundit dhe i ka anuluar vendimet mbi veprat sipas librave dhe fletushkave të mëparshme.

Kur'ani Fisnik është libër i dërguar për tërë njerëzimin deri në ditën e Kijametit dhe vendimet e këtij libri dhuratë për njerëzimin vlejnë deri në ditën e Kijametit. Askush nuk mundet ta ndryshojë këtë libër. Në vend të Kur'anit Fisnik nuk mund të vendoset një libër tjetër. Ky libër i vërteton librat e mëparshëm të vërtetë, si dhe i kontrollon dhe i drejton ato pjesë të cilat i kanë ndryshuar njerëzit. Ky libër ia siguron mbarë njerëzimit pranimin e vendimeve hyjnore të pa devijuara dhe pa ndonjë të metë.

Për çdo mysliman është farz të besojë në librat dhe fletushkat të cilat i ka dërguar Allahu Teala dhe të besojë në të gjitha urdhërat dhe ndalesat të cilat gjinden në to.

Është farz t'i besohet esencës së paprishur të Tevratit dhe të Inxhilit, mirëpo sot këta libra janë të shtrembëruar nga ana e Jehudive dhe të Krishterëve dhe më nuk konsiderohen si libra të vërtetë. Nuk është e lejuar të lihet anash Kur'ani Kerimi e të veprohet sipas këtyre librave të tjerë. Në qoftë se veprohet sipas tyre atëherë veprat nuk janë të drejta dhe tek Allahu Teala nuk pranohen. Tevrati dhe Inxhili edhe poqëse nuk do të ishin të shtrembëruar, prapë nuk do të ishte e lejuar të veprohet sipas tyre, sepse kështu ka dashur Allahu Teala.

Nuk është e lejuar të veprohet sipas Tevratit dhe Inxhilit të sodit, mirëpo gjithashtu nuk është e lejuar të fyhen të vërtetat që janë brenda këtyre librave si fragmentet, pjesët e pasazhet. Këto libra edhe nëse nuk respektohen sikur Kur'ani Kerim, nuk duhet t'i trajtojmë ato sikur ndonjë libër të keq.

Për çdo mysliman është farz të lexohen dhe të mësohen përmendësh pjesë nga Kurani, aq sa nevojitet për të kryer namazin.

Farz-i kifaje është të dihen të gjitha urdhërat hyjnore që gjinden në Kur'ani Kerim. Nëse një grup prej myslimanëve e zbaton këtë obligim, atëherë myslimanët e tjerë nuk kanë ndonjë përgjegjësi.



Të lexohet përkthimi i Kur'anit Famëlartë në gjuhë tjera është e dobishme mirëpo përkthimi nuk e tejkalon Kuranin.

Përkthimi dhe tefsiri shërbejnë për të kuptuar Kur'ani Kerimin.

Falja e namazit në përkthimin e ndonjë gjuhe tjetër nuk është e lejuar [xhaiz].

Nuk është farz të dihet kuptimi për atë që lexon në namaz, mirëpo nëse kuptimi i saj dihet atëherë është një gjë e dobishme.

Nuk preferohet përkthimi për fillestarin i cili është duke e mësuar fenë. Më e preferueshme është që ky fillestar fillimisht të lexojë një tefsir të shkurtër dhe të lehtë për të gjitha ajetet.

Nëse dituritë themelore lexohen vet ka mundësi të vihet në përfundime të gabueshme. Veçanërisht Kur'ani, sunnetet dhe burimet themelore të fesë, duhet të lexohen bashkë me një hoxhë i cili është i aftë.

Është e rrezikshme të veprohet vetëm sipas asaj që ke lexuar dhe ke kuptuar nga përkthimi.

### **T'i përkujtojmë temat**

- 1-Cilëve Pejgamberë u janë dhënë katër librat e mëdhenjë?
- 2-A bën sot të veprohet sipas librave të tjerë jashta Kur'an-it Famëlartë?
- 3-A është e lejueshme të bëhet falja me përkthim të Kur'anit në ndonjë gjuhë tjetër?

## VLERA E LARTË E LEXIMIT TË KUR'ANI KERIMIT

Zotëria ynë, Resulallahu s.a.v.s. është duke na thënë kështu:

**“Më i vlefshmi prej jush dhe me virtytet më të larta është ai që e mëson Kuranin dhe ia mëson të tjerëve”.<sup>20</sup>**

**“Dikujt që në zemrën e tij nuk i gjindet diçka prej Kuranit, ai është sikur një shtëpi e rrënuar”.<sup>21</sup>**

**“Kush i lexon dhjetë ajete në një natë, ai nuk do të shkruhet prej gafilëve [të pavëmendshëm]”.<sup>22</sup>**

Në një rast Resulallahu s.a.v.s. iu drejtua as'habëve fisnikë dhe ju tha:

---

<sup>20</sup> Buhari, Fedailu'l- Kur'an, 21 [No: 5027]; Ebu Davud, Salat, 349; Vitri, 14 [No: 1452]; Tirmidhi, Fedailu'l-Kur'an, 15; Ibnu Maxhe, Mukaddime, 16 Ahmed, Musned, I, 57, 58.

<sup>21</sup> Tirmidhi, Fedailu'l-Kur'an, 18; Darimi, Fedailu'l-Kur'an, 1.

<sup>22</sup> Hakim, Mustedrek, I, 500.

**“Kush prej jush është aq i dobët sa të mos mundet ta lexojë brenda në një nate, një të tretën e Kuranit?”**

Ata thanë: *“Kush është kaq i fuqishëm për këtë gjë ja Resulallah?”* Në këtë Resulallahu s.a.v.s. tha:

**“Sureja- Kulhuvellahu ahad- është e barabartë me një të tretën e Kur’anit.”<sup>23</sup>**

**“Kush i lexon dy ajetet e fundit të Bekares [AmerRasulu] mjaftojnë për të”<sup>24</sup>**

**“Këto dy ajete mi ka dhuruar mua Allahu prej thesarit nën Arsh. Mësojini ato dhe mësojani përmendësh grave dhe fëmijëve tuaj, sepse këto janë në të njëjtën kohë edhe salat, edhe dua, edhe Kur’an.”<sup>25</sup>**

**“Në një shtëpi në të cilën lexohet Ajetu-l-Kursi nuk hyn shejtani. Në qoftë se ka hyrë, kur të lexohet, ai del e ik.”<sup>26</sup>**

---

<sup>23</sup> Buhari, Fedailu’l-Kur’an, 13; Tirmidhi, Fedailu’l-Kur’an, 11; Nesai, Ame’l-Jevmi, 118, 680; Ahmed, Musned, V, 418.

<sup>24</sup> Buhari, Fedailu’l-Kur’an, 10; Muslim, Musafirin, 255; Tirmidhi; Fedailu’l-Kur’an, 4.

<sup>25</sup> Darimi, Fedailu’l-Kur’an, 14; Ahmed, Musned, IV, 147.

<sup>26</sup> Hakim, Mustedek, II, 259; Ibnu Hibban, Sahih, 777.



**“Çdo gjë ka zemrën e vet, e zemra e Kur’anit është Ja Sin.”<sup>27</sup>**

**“Kush e lexon për kënaqësinë e Allahut surën Ja Sin, padyshim do t’i falen xhynahet.”<sup>28</sup>**

**“Sa shumë kam dëshirë që në zemrën e çdo muminit të gjindet sureja Tebarekelledhi bi jedihil mulk.”<sup>29</sup>**

**“Sureja Mulk është pengesë prej dënimit në varr, është shpëtimtar. Kush e lexon këtë sure çdo natë, shpëton prej denimit të varrit.”<sup>30</sup>**

**“Kush e lexon Kur’anin, e mëson ate përmendësh, hallallin e njeh hallall, haramin e pranon haram, Allahu atë do ta vendos në Xhenet. Atij i jepet leja për shefat [ndërmjetësim] për dhjetë gjynahqarë nga familja e tij të cilët e kanë merituar Xhehenemin.”<sup>31</sup>**

---

<sup>27</sup> Tirmidhi, Fedailu’l-Kur’an, 7; Darimi, Fedailu’l-Kur’an, 21.

<sup>28</sup> Hakim, Mustedek, I, 565; Ibnu Hibban, Sahih No: 2574; Darimi, Fedailu’l-Kur’an, 21; Tabarani, es-Sagir; No: 417.

<sup>29</sup> Hakim, Mustedrek, I, 565.

<sup>30</sup> Hakim, Mustedrek, II 498; Tirmidhi, Fedailu’l-Kur’an, 9; Tebarani, al-Kebir, No: 12801; Ebu Nuajm, Hilje, III, 81.

<sup>31</sup> Tirmidhi, Fedailu’l-Kur’an, 13; Ibnu Maxhe, Mukaddime, 16; Tebarani, el-Evsat, No: 5126; Ibnu Adije, el-Kamil, II, 788.

**“Allahu Teala nuk dëgjon asnjë gjë ashtu si e dëgjon robin e vet duke lexuar Kuran në namaz. Robit të vet duke qenë në namaz i shpërndahen të mirat prej kokës e teposhtë [nur dhe mirësi]. Robi nuk mundet t’i afrohet Atij me asnjë send si me Kur’anin që vjen prej Allahut.”<sup>32</sup>**

**T’i përkujtojmë temat:**

- 1-Cila është vepra e muminit me vlerat më të larta?
- 2-Çkafit i përngjan ai i cili nuk di fare Kur’an?
- 3-Cila është sureja e cila po të lexohet tre herë fiton sevabet sikur të kish bërë hatme Kur’anin?
- 4-Cila sure është zemra e Kur’ani Kerimit?
- 5-Cila është sureja e cila po të lexohet e shpëton njeriun prej dënimit të varrit?

---

<sup>32</sup> Tirmidhi, Fedailu’l-Kur’an, 17; Ahmed, Musned, V, 268; Tabarani, el-Kebir, No: 7657; Hatib, Tarih, VII, 88.

## BESIMI NË PEJGAMBERË

Ata të cilët Allahu Teala i ka zgjedhur nga mesi i njerëzve dhe i ka ngarkuar me detyrë që t'i njoftojë robët e Vet me urdhërat dhe ndalesat, si dhe i ka obliguar për t'i edukuar ata, quhen pejgamberë.

Fjala pejgamber është fjalë në gjuhën perse. Kjo fjalë përdoret në vend të fjalës Resul dhe Nebi, të cilat përdoren në Kur'an.

Resul ka kuptimin përfaqësues apo i dërguar, ndërsa Nebi do të thotë lajmëtar. Këto fjalë në kuptim janë të njejta vetëm se ndërmjet tyre ekziston një dallim.

Atyre të cilëve ju ipet një libër i ri dhe shariat/fe apo që shtojnë urdhëra të reja në shiëriatin e një pejgamberi të mëparshëm, ju thuhet **“Resul”**.

Atyre të cilëve nuk ju është dhënë libër i ri dhe të cilët njoftojnë dhe mësojnë për shiëriatin/fenë e një pejgamberi të mëparshëm ju thuhet **“Nebi”**.

Sipas kësaj, çdo Resul është Nebi, por çdo Nebi nuk është Resul.

Pejgamberllëku nuk fitohet me punë. Kjo është dhunti e Allahut Teala.

Pejgamberi i parë është Ademi a.s. ndërsa i fundit është Muhammedi s.a.v.s. Çdo pejgamber ka ardhur për një kohë të caktuar dhe për një popull të caktuar, ndërsa Pejgamberi ynë, Muhammedi s.a.v.s. është dërguar për të gjithë njerëzimin dhe është pejgamber për të gjithë deri në Ditën e Kijametit. Për këtë arsye Allahu Teala i ka dhënë atij sifatin **”Hatemu’n-Nebijjin”**, e që do të thotë **“Vula e Pejgamberëve”**, Pejgamberi i fundit dhe plotësues.

**“Muhammedi nuk ka qenë babai i asnjërit prej burrave tuaj por ai ishte i dërguari i Allahut dhe vulë e të gjithë pejgamberëve, e Allahu është i dijshëm për çdo send.”** [33-Ahzab: 40]

Në kohën e fundit [ahir zaman] Isa a.s. do të zbres prej qiellit dhe do t’i përshtatet sheriatit të Muhammedit s.a.v.s. dhe do t’i thërret njerëzit në Islam dhe në Kur’an. Ai do t’i luftojë ata të cilët nuk do të pranojnë të veprojnë sipas sheriatit si p.sh. të krishterët, jahuditë dhe të tjerët të cilët do t’a mohojnë. Isa a.s. do t’i thërret të gjithë të veprojnë vetëm sipas fesë Islame dhe të veprojnë ato vepra më të cilat është i kënaqur Allahu Teala.

Vetëm Allahu Teala e di numrin e peygamberëve. Në Kur'anin Fisnik përmenden emrat e disa peygamberëve ndërsa numri i tyre është 25. Ata janë:

Ademi a.s., Idrisi a.s., Nuhu a.s., Hudi a.s., Salihu a.s., Ibrahim i a.s., Luti a.s., Ismaili a.s., Is'haku a.s., Jakubi a.s., Jusufi a.s., Ejubi a.s., Shuajbi a.s., Musa a.s., Haruni a.s., Davudi a.s., Sulejmani a.s., Iljasi a.s., Eljesa a.s., Junusi a.s., Dhulkifli a.s., Zekerijja a.s., Jahja a.s., Isa a.s. dhe Muhammedi a.s.. Ne u besojmë të gjithë hakk peygamberëve dhe i përmendim ata për të mirë.

Peygamberët janë njerëz, mirëpo posedojnë cilësi të larta dhe janë të ruajtur prej të gjitha gjynaheve. Cilësitë themelore të tyre janë këto:

**1-Sidk:** I drejtë/ fjalëdrejtë. Peygamberët kurrsesi nuk flasin gënjeshtër. Atë që Allahu Teala i ka urdhëruar të flasin, atë ia përcjellin njerëzve në mënyrë të drejtë.

**2-Amanet:** Të besueshëm. Peygamberët në mënyrë më të bukur e ruajnë amanetin e Allahut Teala e që është shpallja [vahji] dhe urdhërat hyjnore. Nuk bëjnë tradhëti në pasurinë, jetën, nderin dhe në amanetin e fjalëve të njerëzve.

**3-Teblig:** Ju kumtojnë njerëzve urdhërat e Allahut Teala pa ndonjë mangësi apo ndryshim.

**4-Fetanet:** Janë mendjezgjuar dhe inteligjentë.

**5-Ismet:** Janë të ruajtur prej gjynaheve. Pejgamberët kanë personalitet të pastër, të bukur dhe moral të lartë. Ne jemi të urdhëruar që çdo punë të Pejgamberëve ta marrim për shembull. Ata nuk bëjnë asnjë punë me të cilën Allahu Teala nuk është i kënaqur. Allahu Teala i ruan dhe i përkrahë pejgamberët e Vet në mënyrë të veçantë.

**6-Janë meshkuj:** Nuk është dërguar ndonjë pejgamber nga mesi i grave.

Kusht i veçantë i pejgamberëve është paraqitja e mrekuillive [muxhize].

Muxhizeja është dukuri mbinatyrore që bëhet me lejen e Allahut Teala dhe që askush tjetër nuk mund ta bëjë. Muxhize janë veprat si ngjallja e të vdekurve, bisedimi me kafshë, nxjerrja e deves prej shkëmbit, rrjedhja e ujit prej gishtërinjëve dhe pranimi i urdhërave duke folur me Allahun Teala.

Pejgamberit tonë Muhammedit s.a.v.s. u janë dhënë shumë muxhize. Muxhizeja më e madhe e Muhammed'dit s.a.v.s. është pranimi i Kur'ani Kerimit prej Allahut Teala dhe përcjellja e saj tek ne. Pejgamberi jonë nuk mësoj shkrim-lexim prej askujt, ndërsa ai u bë dijetarë me dijen që e morri prej Allahut Teala nëpërmjet rrugës së vahjit. Ai ia prezantoi njerëzimit diturinë prej Ademit a.s e deri në Ditën e Kijametit, si dhe diturinë deri në Xhenet e Xhehenem.

Çdo mysliman që ka arritur moshën e pjekurisë është i obliguar t'i besojë të gjithë pejgamberët dhe t'i përshtatet pejgamberit të fundit Muhammedit s.a.v.s..

#### **T'i përkujtojmë temat:**

- 1-Kujt i thuhet pejgamber?
- 2-Çka do të thotë nebi dhe resul?
- 3-Kush është pejgamberi i parë dhe i fundit?
- 4-Cilat sifate të domosdoshme gjinden te pejgamberët?
- 5-Çka do të thotë muxhize?
- 6-Cila është muxhizeja më e madhe e Muhammedit s.a.v.s.?
- 7-Kush është Hatemu'n-Nebijjin?

## **GJITHÇKA PËR NDER TË TIJ S.A.V.S.**

*Allahu Teala na urdhëron:*

***“E Ne të dërguam ty [Muhammed] vetëm si rahmet [mëshirë] për të gjithë botët [krijesat].” [21-Enbija:107]***

*Tregon Pejgamberi ynë s.a.v.s.:*

***“Kur Allahu Teala e zbriti Ademin a.s. prej Xhenetit për shkak se hëngri prej pemës së ndaluar, Ademi a.s. e kuptojë gabimin, kërkoi falje duke qajtur dhe tha:***

***“Ja Rabbi! Falëm mua, për hatër të Dashurit Muhammed.”*** Allahu Teala i tha:

***“O Adem, prej nga e njeh të dashurin Tim Muhammedin?”*** Ademi iu përgjegj:

***“Ja Rabbi! Ti kur më vendose në Xhenet, në çdo vend të Xhenetit, mbi Arsh e pashë të shkruar “La ilahe illallah Muhammedu’r-resulullah”. E kuptova se emri i atij që përmendet dhe që është i qendisur në çdo vend bashkë me emrin Tënd, është emri i një personi shumë të çmueshëm dhe të dashur për Ty. Për hatër të këtij robi dhe të dashurit Tënd dëshiroj që t’më falësh.”*** Allahu Teala tha:

***“O Adem, fole drejt. Ai është më i dashuri prej të gjitha krijesave. Ai është njëri prej fëmijëve të tu. Pejgamberi i fundit. Po të mos e krijoja atë, as ty nuk të kisha krijuar. Ty të fali për hatrin e tij.”***<sup>33</sup>

<sup>33</sup> Hakim, Mustedrek, II, 615; Bejhaki, Delailu’n Nubuvve, V, 488, Tabarani, es-Sagr, II, 82-83



## BESIMI NË DITËN E AHIRETIT

Ahuret është emri i botës së pambarim që do të fillojë me krismën e kijametit. Ahireti është krijuar dhe është përgatitur me fuqinë e Allahut Teala ashtu siç është krijuar dhe përgatitur kjo botë me fuqinë e Tij, vetëm se për ahuret ka përgatitur një jetë tjetër.

Krisma e kijametit, fryrja e surit, ringjallja e të vdekurve, shpërndarja e librit të veprave, vendosja e mizanit/ peshores, tubimi i robërve përpara Allahut Teala për të dhënë llogari për veprimet në dynja, shefati, Sirati, Xheneti dhe Xhehenemi janë të vërteta dhe do të ndodhin në ditën e ahiretit.

Para ahiretit janë shenjat e kijametit, jeta në varr dhe marrja në pyetje.

E vërtetë është se të gjithë librat kanë folur për jetën e ahiretit. Të gjithë peygamberët i kanë treguar umeteve të veta për ahuret dhe janë munduar t'i largojnë prej tmerreve të asaj dite. Allahu Teala kështu ua tërheq vërejtjen të gjithë robërve të vet:

**“Kushdo që mohon Allahun, melaiket e Tij, Librat e Tij, të Dërguarit e Tij dhe Ditën e ahiretit, ai, me të vërtetë, ka humbur larg prej udhës së drejtë.”**

[4-Nisa':136.]

**“A menduat se Ne u krijuam kot dhe se nuk do të ktheheni ju te Ne”? [23-Mu'minun: 115.]**

Ahiretin e ka krijuar dhe e ka përgatitur Allahu Teala. Rabbi ynë i cili na dha jetë për të parën herë, do të na ngjall përsëri. Kjo punë mund të duket shumë e vështirë për ne, mirëpo ajo është shumë e lehtë për Allahun Teala.

Ahireti nuk është diçka që besohet duke u bazuar në mendje dhe në eksperiencë, mirëpo duke ju mbështetur shpalljeve. Burimi i shpalljeve është Kur'ani dhe ai që neve na njofton me Kur'anin, Resulallahu s.a.v.s..

Besimi në ahiret shërben për tu përgatitur për ahiret. Besimi në ahiret do të thotë të besosh në takimin me Allahun Teala. Kjo është lumturia më e madhe.

Për të mësuar në lidhje me ahiretin dhe për tu përgatitur për të, duhet të lexohet Kur'an-i Kerim dhe hadithet e Pejgamberit tonë Muhammedit s.a.v.s.. Kur'ani dhe sunneti na njoftojnë për ahiretin në këtë mënyrë:

Dita e ahiretit është dita e ringjalljes së të vdekurve.

Ajo është dita kur njerëzit do të ngriten prej varreve dhe do të dërgohen përpara Rabbit të të gjitha botëve.

Ajo ditë është dita kur vendoset peshorja që matë veprat dhe është dita kur ipet llogaria.

Atë ditë çdo kush do të shpërblehet në masë të njejtë për veprat në këtë botë, pa kurrfarë mangësie. Ajo ditë është dita e takimit me Allahun Teala.

Atë ditë, ndahen të mirët prej të këqinjëve. Ajo është dita kur të mirët dërgohen në Xhenet, ndërsa qafirët dhe munafikët dërgohen në Xhehenem.

Ajo ditë është dita kur zgjidhen të gjitha polemikat dhe mosmarrëveshjet.

Ajo ditë është dita kur të gjitha myzhdet e Allahut Teala do të shihen dhe të gjitha kërcënimet e Tij do të realizohen.

Ajo ditë është dita kur të gjithë peygamberët dhe të gjithë besimtarët që u janë nënshtruar atyre do të dalin të drejtë, do të gëzohen, do të arrijnë në rahmet dhe do të hyjnë në Xhenet.

Ajo ditë është dita kur qafirët, munafikët, zullumçarët dhe ata që janë zhytur në gjynahe dhe nuk janë penduar do të derdhen lot duke rënkuar.

Ajo ditë është dita kur fëmijët do të plaken prej tmerrit.

Ajo ditë është dita kur çdokush dertin e vetë do ta shikojë, babai ik prej të birit, burri ik prej gruas, shoku ik prej shokut.

Ajo ditë është dita kur e gjithë pasuria dhe pushteti i botës nuk do të kenë kurrfarë vlefte, e dobi do të ketë vetëm prej zemrës së pastër dhe veprave të mira.

Ahireti është dita kur do të fillojë jeta e vërtetë.

### **T'i përkujtojmë temat**

1-Kur fillon jeta e ahiretit?

2-Cilat janë burimet e diturisë për ahiret?

3-A është besimtar ai që Allahun e beson e ahiretin nuk e beson?

## NËSE KA!

*Një person erdhi tek Aliu r.a..Ky njeri mohonte ringjalljen, llogaritjen në ahiret si dhe Xhenetin dhe Xhehenemin. Ai e pyeti Aliun r.a.:*

*“O Ali, ju myslimanët besoni në vdekje dhe në jetë pas vdekjes, mirëpo ne nuk besojmë. Ju mundoheni shumë që të shpëtoni prej Xhehenemit dhe bëni shumë ibadet dhe harxhoni pasuri që të hyni në Xhenet. A s’është kjo mundim? E kush e di a do të ketë ringjallje pas vdekjes.” Aliu e dëgjoi në qetësi këtë njeri dhe pastaj iu përgjegj kështu:*

*“Po, ose është ashtu si thomë ne, se pas vdekjes ka ringjallje, llogaridhënie, hyrje në Xhenet apo Xhehenem, ose është ashtu si thua ti, se s’ka asgjë. Të themi fillimisht se ajo që thua ti është e vërtetë. Nëse pas vdekjes nuk ka jetë në ahiret, atëherë gjendja yte dhe e jona është e njejtë. Për ty nuk ka, e as për ne nuk ka. Në këtë rast neve nuk na bën ndonjë dëm namazi që falëm për rizanë e Allahut Teala, ibadetet që i bëmë, veprat e mira dhe mirësitë, morali i bukur, zeqatet që i dhamë dhe sadakatë. Por në rast se ka ahiret dhe ajo që themi ne del e vërtetë, si do të jetë halli yt?”*

*Njeriu u ndal pak, mendoi dhe pastaj tha:*

*“Vallahi, në të dy gjendjet ju jeni në dobi, mirëpo nëse del që ka ahiret, vaj halli për ne! Ma mëso rrugën tënde. Edhe unë dua të bëhem mysliman.”*

*Pas kësaj u bë mysliman.*

## SHENJAT E KIJAMETIT

Shenjat e kijametit janë ndodhitë të cilat tregojnë për afrimin e kijametit. Këto shenja nuk kanë ardhur si pasojë e mendimit, mirëpo janë shpallje të Kuranit dhe sunnetit.

Në librat e haditheve në pjesën “Fitnet” dhe në pjesën “Shenjat e Kijametit” janë transmetuar shumë hadithe në lidhje me këtë temë. Këto hadithe janë studjuar nga dijetarët e Islamit dhe si shenja të para i kanë konstatuar këto:

### **Shenjat e para:**

Shenja e parë dhe më e madhe e kijametit është largimi nga kjo botë e të dashurit të Allahut Teala, Muhammedit s.a.v.s.. Pas kësaj vijnë të tjerat si:

\*Pakësimi i diturisë dhe përhapja e injorancës.

\*Njerëz të ngratë të cilët një kohë ishin të varfër, pas një kohë garojnë në fitimin e të hollave dhe ndërtimin e ndërtesave të mëdha.

\*Përhapja e fitnes. Shumimi i ngjarjeve me vdekje. Zmadhimi i anarkisë, turbullirave dhe brengosjeve.

\*Bëhet haptazi zinaja, çdo lloj prostitucioni dhe punët më të shëmtuara. Shtimi i pijeve alkoolike. Dëshira e madhe për argëtim dhe çdo lloj kënaqësie. Nuk dihet familja e fëmijës së sapolindur.

\*Pakësimi i meshkujve dhe shumimi i femrave.

\*Përplasja e myslimanëve ndërmjet veti.

\*Ardhja në krye e një shoqërie të njerëzve të nivelit të ulët, me moral të keq, tradhëtarë dhe të pamëshirshëm.

\*Shumimi i termeteve dhe katastrofave.

\*Pakësimi i moralit të bukur në shoqëri. Nënçmimi i njerëzve të ndershëm dhe me dinjitet. Adhurimi i pasurive të kësaj bote. Një mysliman i cili vuan në këtë jetë të prishtë, kur arrin te varri i një myslimani, e lakmon të vdekurin në varr dhe e dëshiron vdekjen.

\*Paraqitja e mashtruesve, pejgamberëve të rrejshëm.

\*Mbetja e xhamive në gjendje të mjerë, varja e Kur'anit në mure, pakësimi i shumtë i leximit të Kur'anit dhe veprave.

\*Dalja në mëngjes e njeriut nga shtëpia si mumin dhe kthimi në mbrëmje si qafir. Në mbrëmje është mumin ndërsa kur del në mëngjes del si qafir. Humbja e imanit në mënyrë të pavetëdijshme për shkak të veprimeve dhe thashethemeve duke mos poseduar njohuri.<sup>34</sup>

Ai njeri, ajo shtëpi apo shoqëri e cila është në gjendjen e këtyre tregimeve, atyre ju është prishur rendi, iu është prishur qetësia shpirtërore dhe do të thotë se së shpejti do të krisë kijameti.

---

<sup>34</sup> Shiko përmbledhjen e haditheve në lidhje me shenjat e kijametit: Ali Nasëf, et-Taxh, V, 331-341; Hejsemi, Mexhmau'z-Zevaid, VII, 220-352.

## Shenjat e fundit

Në hadithet e vërteta [sahih] janë përmendur një varg shenjash të mëdha dhe të rëndësishme të kijametit. Në to është cekur se pa u paraqitur këto shenja, nuk do të ndodh kijameti. Këto shenja i mësojmë prej hadithit në vijim. Tregohet prej as'habëve Huzejfe b, Usejd el-Gifari r.a.:

“Ne ishim të ulur dhe bisedonim ndërmjet veti për tema të ndryshme. Në ndërkohë na u bashkangjit Resulallahu s.a.v.s. Ai na pyeti:

**“Rreth çkafit ishit duke biseduar?”** Ne ju përgjegjëm:

*“Ishim duke biseduar në lidhje me kijametin”.*

Pastaj ai na tha kështu:

**“Kijameti nuk do të ndodh pa u paraqitur këto 10 shenja:**

**1-Njerëzit do t’i mbështjellë një tym i dendur dhe i madh.**

**2-Dexhxhalli do t’i përmbys njerëzit në një fitne të madhe dhe në dyshim, si dhe do t’ju bëj muminëve zullum të madh.**

**3-Njerëzve do t’ju flas një kafshë e quajtur Dabbetu’l-Ard dhe do t’ju tregojë nëse janë mumin apo qafir.**

**4-Lindja e diellit kah perëndimi.**

**5-Zbritja e Isasë a.s., birit të Merjemes,**



**6-Dalja e grupit të Je'xhuxh dhe Me'xhuxhëve dhe përhapja e tyre.**

**7-Fundosja e tokës në një regjion kah ana e perëndimit.**

**8-Fundosja e tokës në një regjion kah ana e lindjes.**

**9-Fundosja e tokës në një regjion në gadishullin arabik.**

**10- Dalja e zjarrit në regjionin e Adenit e që do t'i dëbojë njerëzit në mahsher.”<sup>35</sup>**

Përveç këtyre është edhe ardhja e Mehdiut brenda Ummetit.

Mehdiu a.s., i cili është prej sojit të Resulallahut s.a.v.s., është një salih, alim, arif dhe një person i zgjuar. Emri i tij përputhet me emrin e Pejgamberit s.a.v.s.. Ai është prej Ehl-i Bejtit.<sup>36</sup>

Në kohët e fundit [ahir zaman] udhëheqë umetin në paqe dhe me drejtësi. Pushteti i tij zgjat shtatë vjet. Ai bëhet imami i Umetit. Do të takohet me Isanë a.s. Isa a.s. i jep Mehdiut detyrën e imamit në namaz dhe i përshtatet Mehdiut. Mehdiu në atë ditë do ta ndihmojë Isanë a.s. ta vras Dexhallin, fitnen më të madhe në sipërfaqen e tokës. Pas kësaj ai do të vdes.<sup>37</sup>

---

<sup>35</sup> Muslim, Fiten, 128; Ebu Davud, Melahim, 3; Tirmidhi, Fiten, 21.

<sup>36</sup> Ebu Davud, Mehdi, 4; Tirmidhi, Fiten, 52, Ibnu Hibban, Sahih, No: 5954; Tabarani, el-Kebir, No: 10216

<sup>37</sup> Ebu Davud, Mehdi, 1, 4, 6; Tirmidhi, Fiten, 52, 53, 79; Ibnu Maxhe, Fiten 34; Ahmed, Musned, III, 17; Hakim, Mustedrek, IV, 557.

Bota nuk do të shkatërrohet përderisa në sipërfaqen e tokës do të gjinden besimtarë të cilët thonë Allah, Allah.<sup>38</sup>

Pasi që vdesin Isa a.s. dhe Mehdiu, sipërfaqen e tokës përsëri do ta pushtojnë qafirët, gjynahqarët, kryengritësit, të pamëshirshmit dhe zullumqarët.

Allahu Teala do të dërgojë kah ana e Jemenit një erë të ëmbël dhe të këndshme dhe do t'i merr shpirtërat e të gjithë muminëve që janë në jetë.

Pastaj do të krisë kijameti me tërë tmerrin mbi këta qafirë dhe njerëz të sherrit.<sup>39</sup>

### **T'i përkujtojmë temat:**

- 1-Çka janë shenjat e kijametit?
- 2-Numroni pesë shenjat e para të kijametit?
- 3-Kush është Mehdiu? Çka është detyra e tij?
- 4-Mbi kë do të krisë kijameti?

---

<sup>38</sup> Muslim, Iman, 234; Tirmidhi, Fiten, 35; Ahmed, Musned, III, 107; Hakim, Mustedrek, IV, 494.

<sup>39</sup> Muslim, Iman, 185; Ahmed, Musned III, 499.

## ÇKA PËRGATITE PËR KIJAMET?

Tregon Enesi r.a.:

“Erdhi një njeri që jetonte në shkretëtirë, jashta Medinës dhe tha: “O i Dërguari i Allahut! Kur do të krisë kijameti?”

Resulallahu s.a.v.s. e pyeti:

**“Turp të kesh, çka përgatite ti për kijamet?”**

Njeriu i tha: “Nuk kam shumë ibadete mirëpo unë e dua Allahun dhe Resulin e Tij”. Atëherë Resulallahi s.a.v.s. ia ktheu:

**“Ti do të jesh bashkë me Ata që i don”.**

Ata të cilët ishin të pranishëm e pyetën Resulallahun s.a.v.s.:

“Edhe ne si ai jemi. A ka myzhde të njejtë edhe për ne.

“Resulallahu s.a.v.s. iu përgjegj:

**“Po”.** At ditë u gëzuar për këtë myzhde aq shumë sa s’ishim gëzuar asnjëherë më parë.”<sup>40</sup>

Ne përderisa kemi kohë, duhet të mundohemi të grumbullojmë atë pasuri e cila do të vlejë atë ditë. Allahu Teala po na drejtohet kështu:

**“në Ditën, kur askujt nuk do t’i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët.**

**përveç atij që vjen me zemër të pastër [kalb-i selim] tek Allahu.”** [26 – Shu’ra: 88-89.]

*Kalb-i selim është zemra që e ka njohur Rabbin e vet dhe me Të ka gjetur qetësi shpirtërore.*

*Prej Allahut Teala dëshirojmë kalb-i selim.*

<sup>40</sup> Buhari, Edeb, 96; Muslim, Birr, 161-166; Ebu Davud, Edeb, 113.

## EXHELI - VDEKJA

**“Secili njeri do ta shijojë vdekjen, e pastaj do të ktheheni te Ne.” [29 - Ankebut: 57.]**

Exheli është koha e përcaktuar për vdekje. Çdo njeri e ka jetën në këtë botë të caktuar, të kufizuar dhe me përfundim. Allahu Teala në diturinë e Tij ka caktuar për çdo gjallesë një gjatësi kohore të jetës. Kur vjen ajo kohë, jeta mbaron, shpirti del prej trupit. Kësaj i thonë vdekje.

Çdo njeri, çdo shoqëri, çdo gjallesë, çdo send dhe çdo gjë që jeton brenda kësaj bote si edhe vet kjo botë e ka një exhel. Kur vjen exheli, njeriu vdes, shoqëritë fshihen prej historisë, të gjallit i ndryshohet jeta, gjërat thehen, copëtohen, krisë kijameti, e jeta ndryshohet.

Allahu Teala në lidhje me këtë temë na drejtohet kështu:

**“Çdo popull ka afatin e vet. Kur t’i vijë koha e fundit, ata nuk mund ta shtyjnë, qoftë edhe për një çast dhe as nuk mund ta shpejtojnë.” [7-A’raf:34.]**

**“Por Allahu nuk ia shtyn afatin asnjë shpirti, që i vjen koha [e vdekjes]; Allahu e din mirë gjithçka që bëni ju.” [63 - Munafikunë :11.]**

Shkaqet e jashtme mund të jenë çkado, mirëpo shkak i vërtetë është urdhëri dhe gjykimi i vdekjes nga Allahu Teala. Ai ka caktuar për çdo njeri kohën e vdekjes, vendin, mënyrën dhe e ka informuar melaiken e ngarkuar me detyrën e vdekjes.

Azraili a.s. është i ngarkuar me detyrën e vdekjes. Pranë veti i ka edhe ndihmësat. Ata iu vijnë njerëzve në forma të ndryshme. Veprojnë sipas urdhërave të Allahut Teala. Kur Allahu Teala jep urdhër: **“Me këtë rob silluni me butësi, ai është miku Im. Mos e brengosni atë!”** atëherë melaiket ia marrin shpirtin pa e lënduar fare.

Shpirtërat e qafirëve, munafikëve dhe zullumqarëve i marrin me vuajtje dhe në frikë të madhe.

Shpirtërat e të mirëve i dërgojnë në nivelin *“Il’lij’jin”*, ndërsa shpirtërat e qafirëve i hudhin në terrin *“Sixhxhin”*.

Rabbi ynë i lartë po na e bënë të qartë se ashtu siç nuk e kanë pasur jetën e njejtë njerëzit e mirë prej të devijuarve dhe qafirëve, ashtu edhe vdekjen nuk do ta kenë të njejtë. Për vdekjen e çdo grupi na lajmëron në këtë mënyrë:

**“A menduan ata, të cilët vepruan në të këqija, se në jetën e tyre dhe në vdekjen e tyre do t’i bëjmë të barabartë me ata që besuan dhe bënë vepra të mira? Sa i shëmtuar është gjykimi i tyre?” [45-Xhathije: 21.]**

**“Kështu, nëse ai [në agoni] është nga ata që janë të afërt [me Allahun],**

**do të ketë prehje, kënaqësi dhe dhunti të Xhenetit Naim.**

**E, nëse është nga njerëzit e së djathtës, [ai do të përshëndetet] “Paqe për ty” nga njerëzit e së djathtës.**

**Por, nëse [ai në agoni] është nga përgënjeshtresit e humbur,**

**ai do të gostitet me ujë të valuar dhe do të përcëllohet në Zjarrin e flakëruar [të Xhehenemit].” [56 - Vakia 88 - 94.]**

Çastit të vdekjes i thuhet *“Gjendja Sekerat”*.

Nëse dikush gjindet në çastin e vdekjes atij duhet t’i përkujtohet fjala e teuhidit **“la ilahe illallah”**.<sup>41</sup>

Nëse dikush prej muminëve vuan në çastet e vdekjes, ajo i siguron pastrimin prej gjynaheve. Në këtë mënyrë shkon në ahiret i liruar prej ndonjë denimi.

---

<sup>41</sup> Muslim, Xhenaiz, 1; Ebu Davud, Xhenaiz, 15; Tirmidhi, Xhenaiz, 7; Nesai, Xhenaiz, 4

Ai që në çastin e fundit thotë: **“la ilahe illallah”** hyn në Xhenet.<sup>42</sup>

Ai i cili para vdekjes hyn në koma apo i kapet gjuha, çasti i fundit për te është çasti para komës. Për këtë person, ajo gjë të cilën e ka folur me gjuhë dhe me zemër sa ka qenë me vetëdije konsiderohet se e ka fol edhe gjatë kohës sa ka qenë në gjendje kome dhe në çastin e vdekjes.

Leximi i sures Ja Sin pranë dikujt në çastin e vdekjes është sunnet. Kjo i jep dobi atij që është duke vdekur dhe tërheq mëshirën hyjnore [ilahi rahmet].<sup>43</sup>

Alimët kanë thënë se leximi i sures Ja Sin në çastin e vdekjes dhe leximi i saj pranë varrit i sjell dobi të vdekurve.

Në çastin e vdekjes ne duhet të kemi mendim të mirë ndaj Allahut Teala.<sup>44</sup>

---

<sup>42</sup> Ebu Davud, Xhenaiz, 15; Ahmed, Musned, III, 233; Hakim, Mustedrek, I, 351

<sup>43</sup> Ebu Davud, Xhenaiz, 19; Ibnu Maxhe, Xhenaiz, 4; Nesai, Sunen-i Kubra, No: 10913.

<sup>44</sup> Muslim, Xhenet, 81-82; Ebu Davud, Xhenaiz, 17; Ibnu Maxhe, Zuhd, 14.

Kjo për shkak se robi ashtu si mendon në lidhje me Rabb'in e vet, ashtu edhe do të trajtohet. Për këtë, në çastin e vdekjes e që është fundi i botës dhe fillimi i ahiretit, duhet të mendohet se Allahu Teala është shumë falës, dhuron, i mbulon të metat, të dëshirohet Rahmeti i Tij i pafund dhe të shpresojmë që Allahu Teala do të vepron ndaj nesh me anë të këtyre attributeve [sifateve].

**T'i përkujtojmë temat:**

- 1-Çka është exheli?
- 2-Në cilën gradë vendosen shpirtërat e të mirëve?
- 3-Ku vendosen shpirtërat e munafikëve dhe qafirëve pas vdekjes?
- 4-Në çastin e vdekjes së ndokujt, çka duhet t'i përkujtohet?
- 5- Cila sure i lexohet të vdekurit?



## **O MELEKU I VDEKJES, SILLU BUTË**

*Një person nga ensarët gjindej në çastin e vdekjes, ndërsa pranë ensariut ishte edhe rahmeti i botëve Muhammedi s.a.v.s. i cili kujdesej për te. Resulallahu s.a.v.s. e pa duke ardhur melekun e vdekjes, Azrailin a.s. dhe na lajmëroi kështu për bisedën që bëri me të.*

*Resulallahu s.a.v.s. i tha melekut të vdekjes:*

***“O meleku i vdekjes, sillu butë me sahabiun tim. Nuk ka dyshim se ai është mumin.”.*** Ndërsa meleku i vdekjes Azraili a.s. i tha kështu:

*“Qofsh faqebardhë, ta dish se ndaj çdo mumini sillemi me butësi. O Muhammed, ta dish edhe këtë: kur i marr shpirtin një njeriu, nëse dikush prej familjes së tij bërtet, ndalem në pragë të derës duke e pasur shpirtin e tij në dorë dhe i them:*

*“Çka është kjo bërtimë? Vallahi ne nuk i bëmë zullum këtij njeriu, nuk i dolëm para exhelit, nuk erdhëm para kohës që ju ka caktuar dhe nuk hymë në xhynah që ja morëm shpirtin. Në qoftë se jeni të kënaqur me veprën e Allahut Teala atëherë ju do të fitoni sevape. Nëse pikëlloheni dhe hidhëroheni, hyni në xhynah. Ju nuk keni ndonjë arsye për të na akuzuar ne. Ne do t’ju vijmë edhe juve edhe shumë të tjerëve. Ruajuni prej gjendjes [halit] së keqe dhe prej vdekjes së keqe”.*

*“O Muhammed! Kushdo qoftë mbi sipërfaqen e tokës, qytetarë apo fshatarë, i mirë apo i keq, unë çdo ditë e bëjë vëzhgimin e tyre. Unë e njoh të madhin e të voglin ma mirë se ata. Vallahi o Muhammed, pa pasur lejën e Allahut Teala, unë as një mizës nuk kam fuqi t’ja marr shpirtin.”*

*Në hadithin në vijim që transmetohet nga Xhafer b. Muhammed r.a. thuhet se:*

*“Më erdhi mua ky lajm: Azraili a.s. i vëzhgon njerëzit në kohët e namazit. Në çastin e vdekjes i shikon për t’ju marr shpirtin. Në qoftë se ai është që i ka ruajtur namazet, qëndron meleku afër tij dhe e largon shejtanin prej tij. Në këtë çast meleku ia përmend atij fjalët*

*“La ilah illallah Muhammedu’r-Resulallah”. Kjo me të vërtetë është një gjendje e lartë.”<sup>45</sup>*

---

<sup>45</sup> Ebu Nuajm, Marifetu’s-Sahabe, II, 231 No: 2572. [Bejrut, 2002] Tabarani, el-Kebir, No: 4188; Ibnu Haxher, el-Isabe, I, 425; Sujuti, Sherhu’s Sudur, 77; el-Muttaki, Kenz, No: 42194; Hejsemi, ez-Zevaid, II, 326.

## JETA NË VARR/ALEMI BERZAH

Varri është stacioni i parë i ahiretit. Koha që fillon me vdekjen dhe që vazhdon deri në ditën e kijametit quhet *“jeta e varrit”*. Kjo periudhë ndryshe quhet edhe *“alemi berzah”*.

Berzah do të thotë: perde, vendkalim, ndërprerje. Jeta e varrit apo *“Alemi Berzah”* quhet vendkalimi dhe vendi i pritjes për në botën e përjetshme.

Jeta në varr është e vërtetë. Melaiket e pyetjeve në varr, të cilëve ju janë dhënë emrat *“Munkir-Nekir”* janë të vërtetë. Melaiket *“Munkir-Nekir”* e pyesin atë që është në varr: Kush është Rabbi yt, cila është feja jote, kush është Pejgamberi yt? Ata të cilët thonë: *“Rabbi im është Allahu, feja ime është Islami, Pejgamberi im është Muhammedi s.a.v.s.”*, ata marrin myzhdet që janë dhënë për muminët. Ata të cilët nuk përgjigjen dot në këto pyetje, ju zihen gjuhët apo thonë ndonjë përgjigje tjetër, ata do të përjetojnë vuajtje.

Pyetje ka edhe për ata të cilët trupi u ka humbur në ujë apo është djegur në zjarr dhe është bërë shkrumb e hi, ju mbledhen copët e tyre të shpërndara të trupit dhe melaiket i bëjnë pyetjet.

Resulallahu s.a.v.s. na thotë kështu:

**“Varri, ose është një kopsht prej kopshteve të Xhenetit ose është një gropë e vuajtjeve prej gropave të Xhehenemit.”<sup>46</sup>**

Vuajtja në varr bëhet me trup, me nefis dhe me shpirt.

Ata që gjinden në varr, i dëgjojnë zërat e botës, i dëgjojnë ata të cilët u japin selam dhe i pranojnë ato. Ata e kthejnë përgjigjen, mirëpo ai i cili është mbi varr nuk e dëgjon atë.

Besimtarëve në varr ju tregohet gjendja e të afërmëve të tyre në botë. Gëzohen për gjendjet e bukura të tyre, ndërsa kur shohin ndonjë gjendje të keqe bëjnë dua: *“Allahu im! Ashtu si na mbajte neve në udhëzim, edhe atyre mos iu merr shpirtërat pa i drejtuar në rrugë të drejtë!”<sup>47</sup>*

Ata që janë në varr kanë dobi prej duave, istigfareve, leximit të Kur’ani Kerimit dhe dhikreve që bëhen nga të gjallët si dhuratë për ta.

---

<sup>46</sup> Tirmidhi, Kijame, 26; Hejsemi, ez-Zevaid, III, 46.

<sup>47</sup> Ahmed, Musned, III, 165; Teberani, el-Kebir, No 3887; el-Evsat, No 148; Hejsemi, ez-Zevaid, II, 328 - 329.

Sunnët është të vizitohen varret, të mirret mësim prej varrezave, të bëhet dua dhe të kërkohet istigfar për të varrosurit. Veçanërisht rekomandohet që këto vizita të bëhen ditën e Xhuma.

Si meshkujt ashtu edhe femrat mund të vizitojnë varrezat duke ju përshtatur rregullave të sjelljes.

Kërkojmë strehim te Allahu Teala prej vuajtjeve të varrit dhe rrëzimit në fitne në çastin e provimit të varrit, sepse edhe Resuli i Allahut s.a.v.s. është strehuar te Allahu Teala prej fitnes së varrit.<sup>48</sup>

Me krismën e kijametit mbaron jeta në varr dhe pas kësaj fillon bota tjetër, e përjetshme dhe e pambarim.

#### **T'i përkujtojmë temat:**

- 1-Cilat janë pyetjet që pyetet njeriu në varr?
- 2-Si quhen melaiket që i bëjnë pyetjet?

---

<sup>48</sup> Buhari, Deavat, 38; Muslim, Dhikr, 50; Tirmidhi, Deavat, 76.

## KRISMA - NDODHIA E KIJAMETIT FRYRJA E SURIT

Kijamet është shfaqje e sifatit “*Xhelal*” të Allahut Teala. Kijamet do të thotë: ngritje në këmbë, vendosje, ngjallje apo gjallëri. Kijameti quhet ndryshe edhe “*ora e pritur*”. Kur vjen kjo orë, prishet rregulli i gjithësisë, ndryshojnë kushtet ekzistuese të jetës dhe bota ndryshohet në një botë tjetër. Pas vdekjes të gjitha krijesat ngrihen përsëri në këmbë dhe vrapojnë drejt mahsherit.

Kijameti është prishja e gjithësisë, ndryshimi dhe periudha e parë e jetës së ahiretit. Me kijamet fillon jeta e ahiretit. Ardhja e kijametit është definitive, mirëpo koha e saj është e fshehur për ne. Kjo për neve është një mëshirë [rahmet]. Gjithashtu edhe çasti i vdekjes është mbajtur i fshehtë për njerëzit. Mirëpo pamundësia për ta ditur kohën e saj nuk do të thotë se nuk do të ndodh fare. Kijameti fillon papritmas me fryerjen në Sur nga Israfili a.s..

Suri është një vegël e ngjajshme me briun.<sup>49</sup>

Ajetet e tregojnë këtë temë shumë hapur, qartë dhe në një mënyrë shumë të tmerrshme.

---

<sup>49</sup> Ebu Davud, Sunnet, 20; Tirmidhi, Tefsiru Sure [40], 8; Ibnu Hibban, Sahih, No: 7312; Ahmed, Musned, II, 162, 192; Hakim, Mustedrek, II, 436.

**“Dhe kur t’i fryhet një herë Surit,  
kur toka dhe malet të ngrihen lartë e të  
thërmohen me një goditje shkatërrimtare,  
atëherë do të ndodhë Ngjarja e pashmangshme  
[Kiameti].**

**Dhe do të çahet qielli, që atë ditë do të jetë i  
thyeshëm.**

**Melaiket do të rrinë skajeve të tij, kurse tetë prej  
tyre do të mbajnë Arshin e Rabb’it tënd.**

**Atë Ditë do të mbeteni zbuluar dhe asnjë  
fshehtësi e juaja nuk do të mbetet pa u shfaqur.”**

[69- Hakka: 13-18.]

**“Atyre u duket ai [kijameti] larg.**

**Kurse Neve ai na duket afër.**

**Dita kur qielli të bëhet si kallaji i shkrirë.**

**Kodrat të bëhen si leshi i lënurur.**

**Dhe asnjë mik nuk pyet për mikun.”**

[70-Mearixh: 6-10.]

**“O ju njerëz, ruajuni denimit nga Rabb’i juaj,  
sepse dridhja pranë katastrofës së kijametit është një  
llahtari e madhe.”**

**“Atë ditë, kur ta përjetoni atë, secila gjidhënëse  
braktis atë që ka në gji dhe secila shtatëzënë e hedh para  
kohe barrën e vet, ndërsa njerëzit duken të dehur, po ata  
nuk janë të dehur, por dënimi i Allahut është i ashpër.”**

[ 22-Haxh: 1-2.]

**Kur të dridhet toka me dridhjen e saj të fuqishme.**

**Dhe të nxjerrë toka atë që ka në brendinë e saj**  
[barrën nga brenda]

**Dhe njeriu të thotë: “Ç’ka kjo [që bën këtë dridhje]?”**

**Atë ditë, ajo i rrëfen tregimet e veta,**

**Ngase Rabbi yt e ka urdhëruar atë.**

**Atë ditë njerëzit shfaqen të ndarë në grupe që të shpërblehen për veprat e tyre.**

**E kush punoi ndonjë të mirë, që peshonë sa grimca, atë do ta gjejë.**

**Dhe kush punoi ndonjë të keqe, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë.” [99- Zelzele: 1-8.]**

**“Atë Ditë, Ne do të palosim qiellin, ashtu siç paloset letra e librit. Ashtu siç e filluam krijimin e parë, do ta përsërisim atë. Ky është premtimi Ynë. Ne do ta bëjmë këtë me të vërtet.” [21-Enbija: 104.]**

**“Ditën kur toka ndryshohet në tjetër tokë, e edhe qiejt [në tjerë qiej], e ata [njerëzit] të gjithë dalin sheshazi para Allahut, Një, Mbizotërues.”**

[14- Ibrahim: 48]



## HASHIR-MAHSHER

Hashir do të thotë: mbledhje apo tubim. Hashir i thuhet ringjalljes pas vdekjes dhe tubimit para Allahut Teala për llogaritje. Hapësira e gjërë në të cilën do të bëhet llogaritja quhet mahsher.

Hashir fillon me fryerjen për të dytën herë në sur prej Israfilit a.s.. Kësaj fryme i thuhet *“Nefha”*. Të gjitha krijesat do ta dëgjojnë zërin e Surit dhe me shpejtësi do të dalin prej varreve apo prej vendeve ku gjinden dhe mblidhen në vendin e llogaritjes, në hapësirën Arasat. Për këtë gjendje na lajmëron kështu Allahu Teala:

**“Pastaj do të fryhet për të dytën herë në Sur dhe ata përnjëherë do të ngjallen e do të presin.”**

[39 - Zumer: 68.]

Kështu do të duket çasti i formimit të mahsherit dhe nisja e llogaritjes së madhe. Mënyrën e ardhjes tonë në mahsher Allahu Teala na e lajmëron kështu:

**“Agonia e vdekjes i vjen me atë të vërtetën [i zbulohet çështja e ahiretit] ; kjo është ajo prej së cilës ke ikur. Dhe i fryhet Surit, e ajo është dita e premtuar.**

**E do të vijë secili njeri e bashkë me të edhe grahësi edhe dëshmitari!**

[i thuhet] **Ti ishe në një huti nga kjo [ditë] e Ne ta hoqëm perdën tënde dhe tash ti sheh shumë mprehtë.”**

[50-Kaf: 19-22.]

I pari që do të ngritet, që do të vjen në mahsher, të parit që do t'i ipet e drejta për të folur dhe kompetenca e ndërmjetësimit [shefatit], si dhe i pari që do të hyjë në Xhenet do të jetë zotëria ynë Resulallahu s.a.v.s..<sup>50</sup>

Në momentin e ngritjes prej varrit dhe gjatë ardhjes në mahsher, njerëzit do të jenë të zbathur, të zhveshur dhe të pabërë synet.<sup>51</sup>

Përveç njerëzve, në mahsher do të mblidhen edhe melaiket, kafshët, shejtanët dhe xhinët.

**“Nuk ka asnjë gjallesë në tokë dhe as shpendë që fluturojnë me dy krahë e që nuk janë të ndara në grupe [të ndryshme] sikurse edhe ju [Allahu i krijoj, i pajisi si juve]. Asgjë nuk kemi lënë pas dore nga evidenca. Më në fund te Rabbi i tyre do të tubohen.”** [6 - En'amë: 38.]

**“Dhe ata do të prezentohen para Rabbit tënd të rreshtuar [e u thuhet atyre]: “Na erdhët ashtu si ju krijuam juve herën e parë, por ju patët menduar se Ne nuk kemi caktuar për ju ringjallje!”** [18 -Kefh: 48.]

**“Pasha Rabb'in tënd. Ne do t'i tubojmë [pas rringjalljes] ata bashkë me djajtë dhe do t'i afrojmë ata rreth Xhehenemit të gjunjëzuar.”** [19 - Merjem: 68.]

---

<sup>50</sup> Buhari, No; 3532; Mualim, Imam, 230 - 233; Ahmed, Musned, III, 136, 140.

<sup>51</sup> Buhari, Rikak, 45; Muslim, Xhenet, 41; Tirmidh, Sifattu'l-Kijame, 3; Ibnu Hibban, Sahih, No: 7347; Bejhaki, Sunen-i Kubra, II, 138

**“Është dita që i fryhet Surit, e ju vini grupe grupe.”**

[78-Nebe’ë: 18.]

**“Atë ditë Xhibrili dhe melaiket qëndrojnë të rreshtuar, askush nuk flet pos atij që e lejon Mëshiruesi, dhe i cili e thotë të vërtetën.”** [78-Nebe’ë: 38.]

**“Në ditën e kijametit Ne i tubojmë ata duke i tërhequr rrëshqanas me fytyra për dhé, të verbër, shurdhë e memecë. Vendi i tyre është Xhehenemi, sa herë që të pushojë flaka Ne u shtojmë flakën e zjarrit.”**

[17-Isra: 97.]

**“Dhe ata që nuk besuan thanë: “Ne nuk i besojmë këtij Kur’ani, e as atij që ishte para tij [librave të tjerë]!” E sikur t’i shihje zullumqarët kur para Rabbit të tyre të ndalen, kthejnë fjalën [fyese] njëri-tjetrit, atyre që ishin pari u thonë: “Sikur të mos ishit ju, ne do të kishim qenë besimtarë?”**

**“E ata që ishin pari, atyre që kishin qenë të dobët u thonë: “A ne ju penguan prej udhëzimit të drejtë pasi që u pat ardhur juve? Jo, por ju vetë ishit kriminelë?”**

**“E ata që kishin qenë të shtypur, atyre që ishin krerë u thonin: “Jo, por dredhia juaj natë e ditë [na largoi prej besimit], kur ju na thërrisnit të mos e besojmë Allahun dhe t’i bëjmë Atij ortak. E kur e shohin dënimin, e fshehin dëshpërimin e vet dhe Ne u vëmë prangat në qafat e atyre që nuk besuan. Ata nuk dënohen për tjetër pos për atë që punuan.”** [34-Sebe’ë: 31-33.]

**“Atë ditë shokët e ngushtë do të jenë armiq të njëri-tjetrit, përveç atyre që ishin të singertë.”**

[43-Zuhruf: 67.]

**Dhe thonë: “Rabbi ynë, ne i dëgjuam udhëheqësit tanë dhe të parët tanë, por ata na shmangën nga rruga e drejtë.**

**Rabbi ynë, jepu atyre dënim të dyfishtë dhe mallkoji ata si është më së keqi.” [33-Ahzab: 67-68.]**

**“Ditën kur do t’i tubojmë të devotshmit te i Gjithëmëshirshmi si mysafirë të ftuar.” [19- Merjem 85.]**

Allahu Teala në ditën e mahsherit kështu do të urdhërojë:

**“Ku janë ata të cilët e deshtën njëri-tjetrin për kënaqësinë Time? Në këtë ditë në të cilën nuk gjendet asnjë hije, Unë do t’i strehojë nën hijen (rahmetin/mëshirën) Time.”<sup>52</sup>**

**T’i përkujtojmë temat:**

- 1-Çka është hasher?
- 2-Çka është mahsher?
- 3-Kush është i pari që do të ngritet nga varri?

---

<sup>52</sup> Muslim, Biir, 12 No. 37.

## DHËNIA E LIBRIT TË VEPRAVE

Libri i veprave është libri në të cilën melaiket kanë regjistruar punët e njeriut gjatë jetës në këtë botë. Allahu Teala duke i ditur shumë mirë të gjitha punët e fshehta dhe të hapta të robërve të Tij, ka ngarkuar melaiket të veçantë me detyrën e regjistrimit të veprave në mënyrë që të mos ketë asnjë ankesë nga njeriu për këto vërtetime të shkruara. Melaiket të cilat shënojnë veprat quhen Kiramen-Katibin.

**“Dhe libri [i veprave të tyre] do t’u vihet përpara, e do t’i shohësh gjynahqarët se si do të tmerrohen nga ato që gjenden në të dhe do të thonë: “Të mjerët ne! Çfarë është ky libër që nuk paska lënë asnjë vepër të madhe apo të vogël pa e shënuar atë.” Aty do të gjejnë të shënuar gjithçka që kanë punuar. Rabbi yt nuk i bën padrejtësi askujt.” [18-Kehf 49.]**

Muminëve i ipet libri nga e djathta. Kjo është shenjë që llogaria do të jetë e lehtë.

Qafirëve dhe munafikëve i ipet libri nga e majta dhe nga mbrapa.

E për këtë gjendje kështu na njofton Allahu Teala:

**“Kujt t’i jepet libri i vet nga e djathta e tij, ai do të thotë: “O ju, qe, lexoni librin tim!”**

**Unë kam qenë i bindur se do të jap llogarinë time.**

**Dhe ai atëherë është në një jetë të kënaqshme.**

**Në një Xhenet të lartë.**

**Pemët e tij i ka krejt afër.**

[E thuhet] **Hani e pini shijshëm, ngase në ditët e kaluara ju e përgatitët këtë.**

**Ndërkaq, kujt i jepet libri i vet nga e majta e tij, ai thotë: "O i mjeri unë, të mos më jepej fare libri im."**

**Dhe të mos dijsha fare se çka është llogaria ime."**

[69-Hakka: 19-26.]

Mahsher është çasti më i tmerrshëm, është çasti kur shpërndahen librat e veprave. Pas kësaj do të jetë lehtë ose vështirë, varësisht prej shpërndarjes.

Resulallahu s.a.v.s. e ka cekur se në ahiret çdonjeri do të jetë me derte të veta në këto tri vende:

**1. Kur pritet përfundimi i matjes së veprave në mizan.**

**2. Kur shpërndahen librat e veprave.**

**3. Kur kalohet prej Siratit.<sup>53</sup>**

**T'i përkujtojmë temat:**

1-Si quhen Melaiket të cilat regjistrojnë librin e veprave?

2-Kush janë ata të cilëve i ipet libri i veprave nga e majta dhe mbrapa?

---

<sup>53</sup> Ahmed, Musned, VI, 110; Ebu Davud, Sunnet, 25; Hejsemi, ez-Zevaid, X, 359.

## MIZAN [PESHORJA] – HESAPI [LLOGARIA]

Llogaria e atyre që janë të obliguar me matje hyjnore për veprat në botë dhe dhënia e shpërblimit apo e denimit është e vërtetë dhe do të ndodh pa tjetër.

Fjala Mizan do të thotë: *“peshore dhe mjet i matjes”*.

Mirëpo kjo peshore nuk duhet të krahasohet me formën dhe detyrën e peshoreve të kësaj bote. Çdo gjë në ahiret ka ngjashmëri vetëm në emër me krijesat e kësaj bote: forma, esenca, gjendja dhe detyra janë tërësisht të ndryshme. Kjo është mënyra se si duhet të njihen gjërat në botën e ahiretit.

Llogarinë e robërve në ahiret do ta bëj Allahu Teala, Rabbi i botërave që është Rrahman dhe Rrahim. Ai është duke urdhëruar kështu:

**“Vetëm te Ne kthimin e kanë.**

**Dhe vetëm detyrë Jona është llogaria e tyre.”**

[88-Gashije: 25-26.]

**“Atë ditë peshimi [masa] është i drejtë. Atij që i rëndohen peshojat, ata janë të shpëtuar.**

**Kujt i vjenë lehtë peshoja, ata e humbën vetveten, ngase i refuzuan argumentet Tona me të padrejtë.”**

[7-A'raf:8-9.]

**“Në ditën e gjykimit. Ne do të vëmë peshoja të drejta, e askujt nuk i bëhet e padrejtë asgjë, edhe nëse është [vepra] sa pesha e një kokrre të miellit Ne do ta sjellim atë. E mjafton që Ne jemi llogaritës.”**

[21-Enbija: 47.]

**“E kush punoi ndonjë të mirë, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë.**

**Dhe kush punoi ndonjë të keqe, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë.” [ 99-Zelzele: 7-8.]**

Allahu Teala nuk e lë pa kompenzim robin e vet i cili ka punuar vepra të mira. Për ato vepra për të cilat ka dhënë premtim se do t’i shpërblejë, atë shpërblim edhe do ta jep. Ndërsa për veprat e këqija të muminëve nuk do të ketë kompenzim të plotë. Allahu Teala ose do të bënë rahmet dhe do t’i falë ose do t’i jep Pejgamberëve dhe salihëve leje për shefat dhe për shkak të shefatit të tyre Allahu Teala do t’i falë apo për një pjesë do t’i falë e për një pjesë do t’i dënojë, duke bërë që llogaria të jetë në favor të muminë.

Pyetja e parë pas imanit për muminët do të jetë pyetja për namaz, e nëse këto të dyja janë në rregull atëherë llogaria e tij do të jetë e lehtë.



Po qafirët! Për shkak se nuk e kanë një punë të hajrit për t'ju dhënë shpërblim, as mizani nuk do të ngritet për t'i peshuar veprat e mira dhe ato të këqija si në rastin e muminëve. Peshorja atyre do t'ju tregon shkallën e kufrit. Qafirët për mohimin e tyre do të dërgohen drejt e në Xhehenem:

**“Këta janë ata, që nuk kanë besuar në shpalljet e Rabbit të tyre dhe në takimin me Të. Punët e tyre do të fshihen, andaj Ne nuk do të vëmë kurrfarë peshe për ta [për veprat e tyre], në Ditën e Kiametit.**

**Shpërblimi i tyre do të jetë Xhehenemi për shkak të mohimit të tyre dhe për shkak se talleshin me shenjat e Mia dhe të dërguarit e Mi.” [18 - Kehf: 105 - 106.]**

Njeriu do të mirret në llogari për këto katër sende:

- 1- Ku e harxhove jetën?**
- 2- Qysh dhe ku kaloi rinia?**
- 3- Qysh e fitove dhe ku e harxhove pasurinë?**
- 4- A veprove në bazë të diturisë?<sup>54</sup>**

Nuk ka llogari dhe denim apo vuajtje për fëmijët dhe për të çmendurit. Ata do të hyjnë drejt në Xhenet. Nuk ka llogari dhe denim as për fëmijët e qafirëve [pa

---

<sup>54</sup> Tirmidhi, Kijamet, 1.

hyrë në pubertet] sipas dijetarëve Islam. Edhe ata do të hyjnë në Xhenet dhe do t'i bëjnë shërbim muminëve në Xhenet.<sup>55</sup>

Nuk do të kryhet llogaria pa u shpague haku i robit. Nuk do të mbetet haku i askujt te askush. Dikush që është xhenetli dhe i ka hak dikujt që është në Xhehennem, nuk do të hyn në Xhenet pa e shpague hakun.<sup>56</sup>

Për këtë arsye askujt nuk duhet t'i hyjmë në hak pa marr parasysh a është mumin apo qafir, ndërsa ata të cilët i kanë hyrë dikujt në hak atëherë të mundohen në këtë botë t'ja kthejnë hakun.

### **T'i përkujtojmë temat**

- 1-Për cilat vepra do të jetë llogaria e parë e muminëve?
- 2-Përse nuk peshohen veprat e qafirëve?
- 3-Cilat janë pyetjet themelore në ahiret për të cilat do të pyetet njeriu?
- 4-A do të mirren në llogari fëmijët dhe të çmendurit?
- 5-Pse duhet të shpaguehet haku i robit?

---

<sup>55</sup> Nevevi, Sherhu Muslim, XVI, 424; Buhari, Tabir, 48; Ibnu Haxher, Fethu'l-Bari, III. 617; Ibnu Kajjim, Tariku'l-Hixhretejn, 688.

<sup>56</sup> Ahmed, Musned, III, 495, Hakim, Mustedrek, II, 437 -438; Hejsemi, Mexhmau'z-Zevad, X, 345 - 346.

## GJITHÇKA ME RAHMETIN E ALLAHUT

*Tregon Resuli i Allahut Teala, Muhammedi s.a.v.s.:*

*“Erdhi shoku im Xhibril-i Emin dhe më tha kështu:*

*“O Muhammed! Beto hem në Allahun që të dërgojë Ty si hakk [të vërtetë], se ne u bëmë dëshmitarë të një ngjarjeje të këtillë. Një rob prej ummeteve të mëparshëm i bëri ibadet Allahut Teala në një ishull për pesëqind vjet. Në atë ishull Allahu Teala nxjerri ujë të ëmbël dhe krijoi një pemë për te. Pema për çdo natë ipte nga një shegë ndërsa ai ushqej me këtë shegë dhe me ujë. Kështu vazhdonte në ibadet. Kur ju afrua exheli këtij robi, ai i bëri dua Allahut Teala t’ia merr shpirtin duke qenë në sexhde dhe Allahu Teala ja pranoi duanë. Ne kur zbritnim në sipërfaqe të tokës e vizitonim atë. Pasi që ju muar shpirti, e ngritëm në qiell gjendjen e këtij robi dhe në kijamet në diturinë hyjnore kështu e gjetëm:*

*U ndalua para pranisë së Allahut Teala. Allahu Teala melaikeve të Tij iu tha:*

*“Me rahmetin Tim futeni në Xhenet robin Tim!”.*

*Robi tha:*

*“Ja Rabb, futem në Xhenet sipas veprave që kam bërë!”*

*Allahu Teala përsëri melaikeve të Tij ju tha:*

*“Me rahmetin Tim futeni në Xhenet robin Tim!”.*

*Robi prapë tha:*

*“Ja Rabb, futem në Xhenet sipas veprave që kam bërë!”*

*Allahu Teala përsëri melaikeve të Tij ju tha:*

*“Me rahmetin Tim futeni në Xhenet robin Tim!”.*

*Robi prapë tha:*

*“Ja Rabb, futem në Xhenet sipas veprave që kam bërë!”*

*Në atë moment Allahu Teala i urdhëron melaiket:*

*“Krahasoni dhuntitë [nimetet] që i kam dhënë robit Tim me ibadetet e tij”. Pasi që i masin melaiket ibadetet e robit që i ka bërë për pesëqind vjet, si kompenzim i vjen vetëm nimeti i shikimit të syrit. Pa falënderim mbesin të gjitha pjesët e tjera të trupit. Në këtë Allahu Teala i urdhëron melaiket e Tij:*

*“Hudheni në zjarr robin për nimetet që i kam dhënë e ai nuk falënderon!” Duke e tërhequr melaiket zvarrë këtë rob, në atë moment ai lutet:*

*“Ja Rabb! Futem në Xhenet me rahmetin Tënd!”  
Allahu Teala i urdhëron melaiKET:*

*“Kthejeni prapa atë” duke e sjellur robin para  
pranisë hyjnore. Allahu Teala e pyet robin:*

*“O robi Im, kush të krijojë ty nga asgjëja? Robi i  
përgjigjet:*

*“Ti më krijove ja Rabb!” Allahu Teala e pyet:*

*“Kjo a erdhi prej teje, apo u bë me rahmetin Tim?”*

*Robi tha:*

*“Prej meje nuk është, u bë me rahmetin Tënd”  
Allahu Teala pastaj e pyet:*

*“Kush ta dha fuqinë që të bësh ibadet për pesëqind  
vjet?” Robi përgjigjet:*

*“Ti ma dhe ja Rabb”. Allahu Teala e pyet për të  
gjitha nimetet tjera se kush ia dha, e robi përgjigjet:*

*“Ti mi dhe ja Rabb”. Pastaj Allahu Teala thotë:*

*“Po, të gjitha këto me rahmetin Tim janë bërë. Këtë  
e kuptove në fund dhe Unë ty me rahmetin Tim po të  
vendosi në Xhenet. O melaiKET e Mia, vendoseni atë me  
rahmetin Tim në Xhenet. O robi Im, ti para kësaj ke qenë  
një robë i mirë” dhe ate e vendos në Xhenet. Pastaj  
Xhibrili alejhisselam tha:*

*“Ja Muhammed, siç e pave çdo gjë bëhet vetëm me  
rahmetin e Allahut.”<sup>57</sup>*

<sup>57</sup> Hakim, Mustedrek, IV, 250; Bejhaki, Shuabu' l -Iman, IV, 150;  
Heraiti, Fedaily'sh - Shykr, 59.

## SHEFATI

Shefat do të thotë të ndërmjetësosh për punët e dikujt tjetër, ta shpëtosh dikë që është në vështirësi duke përdorur respektin dhe kompetencat.

Shefati në ahiret është i vërtetë. Allahu Teala është pronari i të gjitha nimeve, nderimeve dhe kompetencave. Allahu Teala është posedues i gjykimeve dhe vendimeve. Nën urdhërin e Tij është Xheneti dhe Xhehenemi. Mirëpo Allahu Teala dikujt prej robëve të Tij ia shton nderin, respektin dhe gradën, dhe për të treguar afërsinë dhe miqësinë ndaj Tij i jep ndokujt kompetencë, e ngarkon me detyra dhe i dhuron nderime. Ja pra kështu është edhe shefati.

Një hadith i njohur tregon se në ditën e mahsherit, në emër të gjithë njerëzimit del para pranisë së Rabbit të Botëve, Resulallahu s.a.v.s. dhe bie në sexhde. Rabbi i Botëve i drejtohet atij me këto fjalë:

**“O Muhammed! Ngrite kokën, fol dhe fjala jote do të dëgjohet, bënë shefat dhe shefati yt do të pranohet, kërko dhe kërkesa yte do të plotësohet.”**<sup>58</sup>

Kjo është pra **“Makam-i Mahmud”**: kjo do të thotë **“Shefati Uzma”** apo kompetenca më e madhe për shefat.

---

<sup>58</sup> Buhari, no: 4476; 6565; Muslim, No: 193, Ahmed, Musned, III, 116, 244.

Resulallahu s.a.v.s. ka treguar se peygamberëve të tjerë nuk u janë dhënë pesë gjëra që u janë dhënë atij, njëra prej të cilave është kompetenca e shefatit të përgjithshëm.<sup>59</sup>

Çdo peygamber ka përdorur në këtë botë duanë e cila pranohet, ndërsa Resulallahu s.a.v.s. e ka ruajtur këtë të drejtë të duasë për në ahiret, për shefat ndaj muminëve dhe ka përgëzuar se çdo njeri i cili vdes pa shirk ndaj Allahut Teala do t'i arrij shefati.<sup>60</sup>

Me anë të kësaj kompetence bën shefat të përgjithshëm. Këtu përfshihen edhe njerëzit me gjynahe të mëdha dhe prej këtij nimeti përfiton çdonjëri që ka iman edhe sa grimca. Resulallahu s.a.v.s. kështu na ka lajmëruar:

**“Shefati im do të bëhet për ata që posedojnë gjynahe të mëdha prej umetit tim.”<sup>61</sup>**

Të tjerët që kanë leje për shefat nga Allahu Teala sipas renditjes janë: peygamberët, melaiket, dijetarët, salihët, shehidët dhe të tjerët që u është dhënë leje që të bëjnë shefat për muminët.<sup>62</sup>

---

<sup>59</sup> Buhari, Salat, 56. Muslim, No 521; Ahmed, Musned, II, 411; Ibnu Maxhe, No: 567; Ibnu Hibban, Sahih, No: 2313.

<sup>60</sup> Tirmidhi, No: 2441; Ahmed, Musned, VI, 23, 27; Hakim, Mustedrek, I, 67.

<sup>61</sup> Ebu Davud, No: 4739; Tirmidhi, No: 2435; Ahmed, III, 213; Hakim, Mustedrek, I, 69, 160; Ibnu Hibban, No: 2596.

<sup>62</sup> Shih: Buhari, Tevhid, 24; Muslim, Iman, 302; Ibnu Maxhe, Zuhd, 37.

Me kënaqësinë dhe me lejen e Allahut Teala do të realizohet shefati i pejgamberëve, melaikeve, salihëve dhe shehidëve.

**“Atë ditë nuk bën dobi as ndërmjetësimi [shefati], përveç atij të cilin e ka lejuar i Gjithmëshirshmi [Rrahmani] të ndërmjetësojë dhe për të cilin e pëlqeu ndërmjetësimin.” [20 - Ta Ha: 109.]**

**“Kush mund të ndërmjetësojë tek Ai, pos me lejen e Tij.” [2 - Bekare: 255.]**

**“Nuk ka të drejtë ndërmjetësimi askush, përveç atij që e ka lejuar i Gjithmëshirshmi [Rrahmani].”**

[19 - Merjem: 87.]

**“E sa melaike ka që janë në qiej, e që ndërmjetësimi i tyre nuk bën dobi asgjë, vetëm pasi që Allahu të japë leje për atë që dëshiron dhe që është i kënaqur për të.” [53-Nexhm: 26.]**

Shefat nuk do të ketë vetëm për qafirët dhe dhalimët të cilët përhapin kufrin. Nuk do të kenë dobi prej veprave në këtë botë dhe nuk do të kenë kurrfarë dobie prej shokëve të tyre.

**“Dhe ruajuni një dite kur askush askujt nuk do të mund t’i kryejë asgjë, kur nuk pranohet për te [jobesimtarin] ndonjë ndërmjetësim [shefaat] dhe nuk pranohet për te kompensim, e as që do të ndihmohen ata [fajtorët].” [2-Bekare: 48.]**



**“Ata nuk presin tjetër, por vetëm atë që do t’u vijë. E atë ditë kur t’u vijë [dënimi i premtuar] ajo që e pritnin, ata të cilët më parë e kishin harruar thonë: “Vërtet të dërguarit e Rabbit tonë erdhën me fakte të vërteta, a kemi ndonjë ndërmjetësues që të na shpëtojë, ose të kthehemi [në dynja] e të veprojmë ndryshe nga ajo që vepruam? ”Ata shkatërroan vetveten dhe u shkoi huq trillimi që e bënin.” [7 - A’raf: 53.]**

**“Ti tërhiq atyre vërejtjen për ditën e kijametit, kur zemrat, të mllfosura arrijnë në fyt. Për zullumqarët nuk ka as mik e as ndërmjetësues që i shkon fjala.”**

[40 - Gafir: 18.]

Ajetet që tregojnë këtë gjendje janë për qafirët, mushrikët dhe për dhalimët

#### **T’i përkujtojmë temat:**

- 1-Çka është shefati?
- 2-Kujt i ipet së pari kompetenca në ahiret?
- 3-Çka do të thotë Makam-i Mahmud?
- 4-Kush janë ata që nuk do të kenë dobi prej shefatit?
- 5-Kush do të bën shefaat në ahiret për muminët që kanë bërë xhynahe të mëdha?

## SIRATI

Në lidhje me ahiretin është edhe një çështje të cilës duhet t'i besojmë, e ajo është vendosja e Siratit. Sirati është ura e cila do të vendoset mbi Xhehenem.

Gjerësinë, gjatësinë dhe formën e urës së Siratit e di Allahu Teala. Ka lajme të sakta dhe të qarta në lidhje me urën e Siratit e që na njofton Resulallahu s.a.v.s.. Këto i mësojmë prej këtyre haditheve:

Nëpër te do të kalon çdokush, qoftë mumin apo qafir. Muminët kalojnë me shpejtësi të ndryshme varësisht prej veprave dhe devotshmërisë. Dikush kalon me shpejtësi rrufeje. Dikush kalon me shpejtësi si era. Dikush kalon duke vrapuar, dikush duke ecur e dikush duke u zvarritur. Munafikët dhe qafirët rrëzohen në Xhehenem që me hapin e parë. <sup>63</sup>

Nëpër Sirat kalojnë së pari Resulallahu s.a.v.s. dhe ummeti e tij. Mbi Sirat nuk mund të flas askush përveç pejgamberëve. E vetmja dua e pejgamberëve në atë moment është:

**“Allahu im! Shpëtoma ummetin, Allahu im shpëtoji ata, nxjerri në selamet/ shpëtim!”** <sup>64</sup>

---

<sup>63</sup> Buhari, Rikak, 52; Muslim, Iman, 329; Ibnu Maxhe, Zuhd, 33.

<sup>64</sup> Buhari, Rikak, 52; Muslim, Iman, 299; Ebu Davud, Sunnet, 25; Tirmidhi, Xhenet, 20.

Thëniet për Siratin si: *“është më e hollë se një qime dhe më e mprehtë se një shpatë”* apo *“është një përpjetëze njëmijë vjet e gjatë dhe njëmijë vjet e poshtë”* janë shprehje për të kuptuar se sa i vështirë është kalimi nëpër urën e Siratit. Çka duhet të kuptohet është se pa rahmetin e Allahut Teala është e pamundur të kalohet ky provim. Disa dijetarë kanë sqaruar se ajeti në vazhdim flet për Siratin:

**“Nuk ka asnjë prej jush që nuk do të arrijë te xhehenemi! Ky është vendimi përfundimtar nga Rabbi yt.**

**Pastaj, ata të devotshmit do t’i shpëtojmë, kurse jobesimtarët do t’i lëmë të gjunjëzuar në zjarr!**

[19 - Merjem : 71-72.]

### **T’i përkujtojmë temat**

- 1-Ku do të vendoset Sirati?
- 2-Kush kalon më i pari nëpër Sirat?
- 3-Cili është kuptimi i Siratit “më i hollë se qimja dhe më i mprehtë se shpata”

## BURIMI KEVTHER

Burim Kevther që është përgatitur për Resulallahun s.a.v.s. është i vërtetë. Allahu Teala ka përgëzuar:

**“Na, vërtet të dhamë ty Kevtherin.”**

[108 - Kevther: 1.]

Në komentimin e shumicës së dijetarëve Kevtheri është një lum i dobishëm dhe i begatshëm dhe një burim që gjindet mbi lumë.<sup>65</sup>

Allahu Teala e ka përgatitur këtë lumë dhe këtë burim për të Dashurin e Tij, Muhammedin s.a.v.s..<sup>66</sup>

Muhammedi s.a.v.s. e ka pa Kevtherin në Miraxh dhe e ka pyetur Xhebrailin:

**“Çka është ky lumë dhe ky burim?”** Xhebraili a.s., ju ka përgjegjur:

**“Ky është Kevtheri që e ka përgaditur Rabbi Yt për ty.”**<sup>67</sup>

---

<sup>65</sup> Alijju'l -Kari, Sheru Fikhi'l-Ekber, 164.

<sup>66</sup> Muslim, Salat, 53.

Resulallahu s.a.v.s. na thotë:

**“Çdo peygamber ka një burim. Të gjithë lavdërohen me numrin e madh prej ummeteve të tyre të cilët mblidhen në krye të burimeve të veta. Kam shpresë se në krye të burimit do të jem unë, peygamberi me ummetin më të madh.”** <sup>68</sup>

**“Burimi im është në Xhenet. Ai që pi prej tij, më kurrë nuk do të ketë etje.”** <sup>69</sup>

Burimi Kevther është dhuratë e dashurisë ndaj Muhammedit s.a.v.s.. Ata të cilët në këtë botë kanë besuar dhe ju janë përshtatur sunnetit të tij, varësisht prej gradave të edukimit të tyre dhe miqësisë së tyre, do të jenë të respektuar në ahiret prej Muhammedit s.a.v.s..

### **T'i përkujtojmë temat**

1-Cilit peygamber i është dhënë burimi Kevther?

2-Kush do të pijë prej burimit Kevther?

---

<sup>67</sup> Buhari, No: 4964, 6581; Ebu Davud, No: 4748; Tirmidhi, No: 3418; Ahmed, Musned, III, 103.

<sup>68</sup> Tirmidhi, No: 2445; Hejsemi, Mexhmau'z-Zevaid, X, 363.

<sup>69</sup> Buhari, No: 6578; Muslim, No: 2292; Ibnu Hibban, No: 6452

## XHENETI DHE XHEHENEMI

Besimi në ekzistencën e Xhenetit dhe Xhehenemit është prej esencave më të rëndësishme në lidhje me ahiretin. Kur’ani Fisnik dhe sunneti e kanë sqaruar me shprehje shumë të qarta Xhenetin dhe Xhehenemin dhe janë ndalur shumë tek kjo temë. Të dyshohet rreth tyre apo të supozohet ekzistenca e tyre si një lloj simbolike është kufër [mohim]. Dijetarët e Islamit të cilët i studiojnë ajetet dhe hadithet në lidhje me Xhenet dhe me Xhehenem kanë ardhur në këto përfundime:

“Xheneti dhe Xhehenemi në këtë çast është i krijuar dhe është prezent. Kjo është paraqitur në Kur’an dhe sunnet dhe është në pajtueshmëri të dijetarëve Islam. Se ku gjinden tani Xheneti dhe Xhehenemi është më e drejtë të lihet në diturinë hyjnore.”<sup>70</sup>

Resulallahu s.a.v.s. e kaparë Xhenetin dhe Xhehenemin në Miraxh.

Stacioni i fundit për muminët është Xheneti ndërsa për qafirët është Xhehenemi.

Allahu Teala ju ka premtuar Xhenetin muminëve dhe ju ka dhënë myzhde për te. Ata të cilët kanë iman në zemër edhe sa grimca dhe kanë dashuri ndaj Allahut Teala, si përfundim do të hyjnë në Xhenet. Xhehenemin e

---

<sup>70</sup> Aljju’l-Kari, Sherhu Fikhi’l-Ekber, 168; Edib Kejlani, Avnu’l-Murid Sherhu Xhevhereti’t- Tevhid, II, 1098.

ka përgatitur për qafirët dhe munafikët. Është e pamundur t'i iket Xhehenemit. Ky është një vendim hyjnor. Fjala definitive është dhënë. Çdo fjalë e Allahut Teala është e vërtetë dhe zbatimi i tij është i sigurtë.

Edhe shejtanët dhe xhinët qafirë të cilët ju nënshtruan shejtanit, do të jenë në përjetësi në Xhehenem.

Sipas besimit të Ehl-i Sunnetit, Xheneti dhe Xhehenemi janë të përhershëm dhe të vazhdueshëm, nuk kanë fund dhe në të dyjat nuk ka vdekje.

Sipas një hadithi, pasi që hyjnë ata të cilët janë për Xhenet në Xhenet e ata të cilët janë për Xhehenem në Xhehenem, me urdhërin e Allahut Teala do të sjellet vdekja në formën e një dashi dhe do të therret. Kështu edhe vdekja vdes. Prej këtij momenti shtohet gëzimi i Xhenetlinjëve dhe shtohet brengosja dhe pikëllimi i Xhehenemlinjëve, për shkak se më nuk do të ketë vdekje që të shpëtohet prej zjarrit.<sup>71</sup>

Xheneti është gradë - gradë. Ekzistojnë tetë dyer. Të gjithë ata që do të hyjnë aty do të kenë një pozitë sipas veprave që kanë bërë në dynja, si dhe do të kenë grada dhe kënaqësi shpirtërore sipas njohurisë që kanë pasë.<sup>72</sup>

---

<sup>71</sup> Buhari, No: 6548; Muslim, No: 2850; Tirmidhi, No: 2558

<sup>72</sup> Edib Kejlani, Avnu'l-Murid Sherhu Xhevhereti't-Tevhid, II, 1114

Në Xhenet grada më e lartë quhet “*Vesile*” dhe i takon të Dashurit të Allahut, Muhammedit s.a.v.s..

Në Xhenet nimeti më i madh do të jetë shikimi i bukurisë së Allahut Teala. Edhe një nimet tjetër i madh i Rabbit të të gjitha botëve ndaj atyre që kanë hyrë në Xhenet është se Ai do të jetë i kënaqur me ta dhe se Ai nuk do të jetë më i hidhëruar ndaj tyre. <sup>73</sup>.

Një prej nimeteve më të ëmbla të Xhenetit do të jetë edhe takimi dhe kojshillëku me të i të Dërguarit si rahmet për të gjitha botët, të Dashurit të Allahut Teala, Muhammedit s.a.v.s. Nimetet dhe kënaqësitë tjera do të jenë në pjesën poshtë këtyre.

Në Xhenet ekzistojnë melaiket që e kanë për detyrë t’i japin selam muminëve. Kryetari i tyre dhe rojtari i dyerëve të Xhenetit quhet “*Ridvan*”.

Shërbyesve në Xhenet ju thuhet “*Gilman*”. Bashkëshortet të cilat do t’ju dhurohen muminëve meshkuj quhen “*Huri*”.

Ata që kanë qenë burrë e grua në këtë botë edhe në Xhenet do të jenë bashkë, burrë e grua. Gratë që s’kanë pasur burra, martohen me ata që janë në Xhenet.

Çdokush hyn në xhenet në një pamje të bukur. Aty nuk ka plakje.

Nimetet në Xhenet, gjendja dhe hallet, nuk kanë ngjashmëri me nimetet dhe gjendjet në këtë botë.

---

<sup>73</sup> Buhari, Rikak, 51; Muslim, Xhenet, 9; Tirmidhi, Sifatul-Kijame, 18



Ndërmjet të dyjave ngjashmëria është vetëm në emër. Në atë botë çdo gjë është sipas kushteve të veta. Aty ka vetëm miqësi hyjnore, hamd, dhikër dhe falënderim. Njeriut do t'i ipet çkado që dëshiron. Aty nuk do të ketë as punë, as lodhje, as brengosje, as frikë, vuajtje apo mërzë. Xheneti nuk është vend i veprimit, ai është vendi i qejfit dhe rehatisë. Xheneti nuk është botë e shkaqeve, mirëpo është vendi i manifestimeve të hapta të fuqisë hyjnore.

Për ata që janë në Xhehenem vuajtja më e madhe e tyre është zemërimi i Allahut Teala ndaj tyre dhe mosshikimi prej Allahut Teala me shikimin e rahmetit. Të gjitha tmerret e tjera janë shumë të pakta në krahasim me këtë vuajtje.

Në Xhehenem nuk do të ketë djegie totale e shndërrim në hi, nuk do të ketë harxhim, zhdukje dhe asnjë mënyrë për të shpëtuar prej dënimit. Trupi që digjet rikrijohet përsëri, kthehet në gjendje të mëparshme dhe dënimi vazhdon nga e para. Kështu vazhdon në mënyrë të pandërprerë.

**“Është e vërtetë se ata që mohuan argumentet Tona, do t'i hudhim në zjarr. Sa herë që u digjen lëkurat e tyre, Ne ndërrojmë lëkura të tjera që të shijojnë dënimin. Allahu është i Plotëfuqishëm, i Drejtë.”**

[4-Nisaë: 56.]

Në Xhehenem ka melaïke me detyrë për të denuar. Maliki është kryetari i tyre. Melaiket e dënimit nuk ndikohen prej zjarrit të Xhehenemit. Zjarri ata nuk i dëmton. Këto melaïke nuk tregojnë mëshirë ndaj atyre që janë në Xhehenem dhe nuk ju vie keq për gjendjen e tyre. Ato detyra të cilat ju ka ngarkuar Allahu Teala i zbatojnë plotësisht.

Po e përmbylim këtë kapitull me një pjesë nga sureja Zumer që tregon gjendjen e fundit në ahiret. Me këto ajete na drejtohet Rabbi ynë, që është Rrahman dhe Rrahim:

**“Toka është ndriçuar me nurin e Rabbit të vet, libri është vënë pranë dhe sillen peygamberët e dëshmitarët, e kryhet mes tyre gjykimi me drejtësi, e atyre nuk u bëhet padrejtë.**

**Dhe, secili njeri shpërblehet për atë që ka vepruar, e Ai më së miri e di se ç’punuan.**

**E ata që nuk besuan sillen në grupe te xhehenemi, e kur arrijnë te ai, dyert e tij hapen e roja e tij u thotë atyre: ”A nuk u patën ardhur juve të dërguar nga mesi juaj t’ju lexojnë shpalljet e Rabbit tuaj, t’ju tërheqin vërejtjen për ballafaqimin tuaj në këtë ditë?” Po, [na kanë ardhur] ata thonë, por fjala [vendimi] e dënimit domosdo është bërë realitet kundër jobesimtarëve!**

**U thuhet: "Hyni nëpër dyer të xhehenemit, aty do të jeni përgjithmonë, sa vend i keq është për kryeneçët!**

**E ata që ishin të devotshëm ndaj Rabb-it të tyre, sillen në grupe te Xheneti, e kur arrijnë aty, dyert e tij i gjejnë të hapura dhe roja i tij u thotë atyre: "Selam alejkum- qofshi të shpëtuar, ishit të pastër, andaj hyni në të, aty jeni përgjithmonë."**

**E ata [të Xhenetit] thanë: "Falënderuar qoftë Allahut, i cili premtimin e Vet e bëri realitet ndaj nesh dhe na e la në disponim tokën e Xhenetit që të vendosemi aty ku të duam! Sa shpërblim i mirë është i atyre që vepruan drejtë."**

**E do t'i shohësh melaiket të rreshtuar përreth Arshit, e madhërojnë me falënderim Rabb-in e vet. E në mes tyre [njerëzve] kryhet gjykimi me drejtësi dhe thuhet: Falënderuar qoftë vetëm Allahu, Rabbi i botëve." [39-Zumer: 69-75.]**

Elhamdulillahil'lahi Rabbi'l-alemin.

#### **T'i përkujtojmë temat**

- 1-A ekziston në këtë moment Xheneti dhe Xhehenemi?
- 2-Cili është makami më i lartë në Xhenet? Cili makam është ky?
- 3-Kush është kryetari i melaikeve të denimit në Xhehenem?

## SI DO TË NGJALLEN ESHTRAT E KALBURA

*Kur Resulallahu s.a.v.s. ju dha lajmin mekasve në lidhje me vdekjen dhe ringjalljen, njëri prej qafirëve Ubej b. Halef, shkoi te varrezat e gjeti një asht të kalbur dhe duke e grimtuar ashtin me dorë erdhi para Resulallahut s.a.v.s., duke e harruar se si ishte krijuar ai vet herën e parë, me një sjellje ironike e pyeti Resulallahun s.a.v.s.:*

*“O Muhammed! A këtyre eshtrave të kalbura do t’i ipet shpirt? Ti beson se Allahu përsëri do t’i ngjall këto eshtra?”*

*Resulallahu s.a.v.s. u përgjeggj:*

***“Po, Allahu ty do të ngjall dhe do të fut në Xhehenem.”***<sup>74</sup>

*Në lidhje me këtë ngjarje Allahu Teala e vërtetoi Resulin e Tij, Muhammedin s.a.v.s., me anë të zbritjes së këtyre ajeteve:*

***“Thuaj: I ngjall Ai që i krijoi për herë të parë, e Ai është shumë i dijshtëm për çdo krijim.***

***Ai që prej drurit të gjelbër ju bëri zjarrin, e ju prej tij ndizni.***

***A nuk është i fuqishëm Ai, që krijoi qiejt e tokën, të krijojë njerëz sikundër që i krijoi ata? Po! Ai është Krijuesi i çdo gjëje dhe i Gjithëdijshmi.”***

[36 - Jasin: 79 - 81.]

<sup>74</sup> Ibnu Kesir, Tefsir, VI, 593. Rijad, 1997.

## BESIMI NË KADER DHE NË KADA

Prej parimeve themelore të imanit, i gjashti me radhë është besimi në kader dhe në kada. Kaderi dhe kadaja janë të lidhura me diturinë [ilm], dëshirën [irade] dhe fuqinë e Allahut Teala. Këto janë dy çështje të fshehura [sirr].

Allahu Teala na drejtohet kështu:

**“Ne çdo send kemi krijuar me masë [kader] të caktuar.”** [54 - Kamer: 49.]

**KADER:** i thuhet caktimit të Allahut Teala për çdo gjë që ka ndodhur, është duke ndodhur dhe do të ndodhë.

Resulallahu s.a.v.s. duke zbuluar pak nga fshehtësia e kaderit kështu na lajmëron:

**“Allahu Teala, pesëdhjetëmijë vite përpara se të krijojë qiellin dhe tokën, e shkroi kaderin e krijesave në Lehi Mahfuz. Në atë kohë Arshi i Tij ishte mbi ujë.”**<sup>75</sup>

Sahabiu Ubade b. Samiti i ka thënë të birit të vet:

*“O bir! Ti nuk do ta shijosh shijen e imanit të vërtetë, përderisa nuk e di se gjërat që janë përcaktuar për ty patjetër do të vijnë, ndërsa ato të cilat nuk janë caktuar për ty kurrsesi nuk do të të vijnë në kokë. Unë e dëgjova Resulin e Allahut s.a.v.s. duke thënë kështu:*

---

<sup>75</sup> Muslim, Kader, No: 2653, Tirmidhi, Kader, 18.

*“Gjëja e parë që krijoi Allahu Teala është lapsi. Allahu e urdhërojë lapsin: “Shkruaj”. Lapsi pyeti: “O Rabbi im, çka ta shkruaj?”. Allahu Teala tha:*

*“Shkruaj kaderin e të gjitha gjërave që do të ndodhin e do të vijnë deri në ditën e kijametit.” Pastaj Resulallahu s.a.v.s. vazhdoi dhe tha:*

*“Kushdo që vdes jashta këtij kuptimi dhe këtij besimi ai nuk është prej meje.”<sup>76</sup>*

**KADA:** i thuhet realizimit të caktimeve në kohën dhe në vendin që është caktuar nga Allahu Teala.

Në gjithësi nuk ekziston asgjë jashta diturisë, dëshirës dhe krijimit të Allahut Teala. Çdo gjë ndodh me dëshirën e Tij dhe Ai është që çdo gjë e drejton.

Robi nuk është i krijuar ta dijë kaderin e vet. Ai është përgjegjës të besojë se Allahu Teala e ka ditur që më herët për çdo gjë që i ka ndodhur apo që do t’i ndodh.

Njeriu nuk është i krijuar që të zgjidhë fshehtësinë e kaderit, mirëpo është urdhëruar që t’i dijë obligimet hyjnore dhe me aq sa ka fuqi t’i sjell ato në vend.

Shpëtimi prej vesveseve në lidhje me kaderin nuk vie nëpërmjet mendimit apo filozofisë, mirëpo është i mundshëm vetëm me anë të besimit dhe dorëzimit ndaj Rabb-it të gjithësisë.

---

<sup>76</sup> Ebu Davud, 17; Tirmidhi, Kader, 17; Ahmed, Musned, V, 317; Ibnu Asim, Sunnet, I, 51-52.

Allahu Teala i ka dhënë njeriut mend, dëshirë, vullnet, dituri dhe aftësi për të menduar, në veçanti ka dërguar peygamberë që i kanë mësuar njerëzit se çka është vepër e mirë e çka vepër e keqe, çka është mirësi e çka ligësi, e drejtë apo jo e drejtë, çka është e vërtetë e çka është e kotë. Për këtë arsye njeriu ka detyrim dhe përgjegjësi. Pra, njeriu që punon vepra të mira fiton sevape, ndërsa ai që ka punuar vepra të këqija dhe nuk është penduar do të shpërblehet me vuajtje.

Prandaj askush nuk mund të zhytet në kryengritje dhe të shpëtojë prej përgjegjësisë duke thënë: *“Çka të bëj unë, ky qenka kaderi im, çfarë mund të bëj?”*

Njeriu posedon mendje që të ndajë të mirën prej të keqes dhe ka një peygamber që i mësoi atij se çka është vepër e mirë e çka vepër e keqe. Një njeri i cili është zhytur në vepra të këqija ka aftësi dhe mundësi që të punojë vepra të mira. Për këtë arsye robi punon atë të cilën seriozisht e don, asaj i drejtohet dhe atë e vendos, Allahu Teala ate e krijon. Ndodh edhe mos ta krijojë.

Çdo dëshirë e robit nuk realizohet.

Çdo dëshirë e robit gjen ekzistencë me krijimin dhe dëshirën e Allahut Teala.

Çdo vepër i ka dy drejtime. Njëra është krijim që i takon Allahut Teala, ndërsa e dyta është përgjegjësia, e përgjegjësia i takon robit.

Nuk është e drejtë të thuhet se Allahu Teala i krijon të mirat ndërsa të këqijat nuk i krijon, apo se Ai nuk përzihet në krijimin e të keqes. Krijuesi është Një. Ai i krijon edhe të mirat edhe të këqijat.

Ato punë të robit të cilat bëhen me vullnetin e tij, shndërrohen në vepra të tij. Për çdo vepër për të cilën është urdhëruar t'a bëjë apo mos t'a bëjë ekziston reciprociteti. Punët e mira bëhen shkas [sebeb] për sevap ndërsa punët e këqija shkas për vuajtje. Robi nëse bën teube për fajet e punuara, falet, bile me teube të sinqertë [teube-i nasu] xhynahet e tij shndërrohen në sevab. Ky është një rahmet i Allahut Teala, ndërsa për muminët të cilët bëjnë teube është një përgëzim i bukur.

Robit i përshtatet robëria, ndërsa gjykimi i takon Allahut Teala.

Bile edhe po të mos ekzistonte Xheneti dhe Xhehenemi, neve do të na takonte që me edukatë t'i robërohemi Krijuesit tonë Madhështor. Atij i qoftë hamd pa fund.



## **GJITHÇKA ËSHTE NJË KADER**

*Omeri r.a. në vitin 18 të hixhrit, morri rrugë për në Sham me një grup sahabësh, me qëllim kontrollimi. Rrugës, në afërsi të Shamit arritën në një fshat të quajtur “Sherag”. Omerin r.a këtu e priti guvernatori dhe komandanti i ushtrisë Siriane Ebu Ubejde b. Xherrah r.a., me disa ushtarë e eprorë dhe ja dha lajmin se në Sham është përhapur murtaja. Omeri r.a. i thirri për këshillim sipas rendit të epërsisë as’habët fisnikë që ishin prezent nëpërmjet Abdullah b. Abbasit r.a. i njohur si “Imami i Mufessirëve”. Së pari i thirri myslimanët e Mekës që kishin bërë hixhret. Pastaj i thirri Ensarët e Medinës, dhe së fundi i thirri kurejshitet që kishin bërë hixhret në Medine pas pushtimit të Mekës. Atyre ju dha lajmin se në Sham është përhapur sëmundja e murtajës dhe mori mendimin e tyre se a duhej të shkonin apo të ktheheshin. Disa thanë: “Allahut tevekkul” [i dorëzohemi Allahut] dhe të shkohet në Sham. Disa të tjerë ishin të mendimit që të mos ballafaqohen me këtë rrezik dhe të kthehen. Omeri r.a. i largoi ata, mendoj pak dhe e mori vendimin që të kthehen në Medine. Më pastaj i njoftoi të tjerët. Guvernatori i Shamit Ebu Ubejde b. Xherrah r.a. që e priste me ngrohtësi arritjen e Halifës në Sham e humbi disponimin kur e dëgjoi vendimin dhe i tha Omerit r.a.:*

*“A po ikën prej kaderit të Allahut?”. Omeri r.a. ju përgjegj:*

*“O Ebu Ubejde, të ishte dikush tjetër t’i thotë këto fjalë e jo ti. Po, ne prej kaderit të Allahut përsëri në kader të Allahut po ikim.” Për t’i treguar se ky vendim ishte i drejtë e pyeti Ebu Ubejdin:*

*“Tregom, nëse do të kishe një grumbull devesh, dhe në njëerën anë do të kishe një hapësirë me bari ndërsa ana tjetër do të ishte e thatë dhe me një përrua në mes, në cilën anë do t’i kullosje ato? Në qofte se ti i kullot devetë nga ana e barit dhe ato ngopen, me kaderin e Allahut i ke kullotur. Në të njejtën mënyrë edhe nëse do t’i kishe kullotur në anën e thatë dhe do të mbetnin të uritura prapë me caktimin e Allahut do t’i kishe kullotur. Që të dyja janë kader mirëpo përfundimi nuk është i njejtë.”*

*Ebu Ubejde r.a. heshti para kësaj përgjigjeje me urtësi. Posa mbaroi fjalët Omeri r.a. erdhi Abdurrahman b. Avf r.a. i cili ishte larguar nga ai vend për punët e veta dhe ju afrua atyre. Kur mori vesh për çështjen tha: Në lidhje me këtë çështje e di një hadith. Unë e dëgjova Resulin e Allahut s.a.v.s. duke urdhëruar kështu:*

***“Nëse dëgjoni se në një vend ka rënë sëmundja e murtajës, mos shkoni aty. Ndërsa nëse ndodheni në vendin ku ka rënë sëmundja e murtajës mos ikni prej atij vendi në një vend tjetër.”***

*Omeri r.a. kur e dëgjoi këtë hadith, qau për zgjedhjen që bëri, për vendimin e tij që përputhej me urdhërin e Resulallahut s.a.v.s. dhe e falënderoi dhe e lavdëroi Allahun Teala. Për shkak të hadithit dhe për shkak të vendimit që kishte marrë u kthye në Medine-i Munevere. 77*

---

<sup>77</sup> Buhari, Tëbb, 30; Muslim, Selam, 98.

## VENDIMI IPET SIPAS FUNDIT

Përfundimi mirret parasysh. Çdo mumin duhet t'a kërkojë mundësinë që të përfundojë jetën me iman. Deri në vdekje duhet të ruaj vlerën shumë të çmuar të imanit dhe duhet t'i ruaj veprat e mira. Nuk duhet t'i mbështetet mendjes apo veprave të veta, mirëpo duhet t'i mbështetet rahmetit të Allahut Teala që është i pafund. Me përgjërim dhe me singëritet, duhet të lutet nga zemra për një përfundim të mirë të imanit.

Sipas shënimeve në hadithet e lavdishme, disa njerëz e kalojnë një kohë të gjatë të jetës së vet në punë të hajrit. Njerëzit i shikojnë ata si xhenetli dhe e lakmojnë gjendjen e tyre. Mirëpo disa njerëzve ju vjen një provim i madh dhe vendimi i kaderit del në pah. Ai njeri i cili më herët e kishte imanin dhe punët e hajrit në dorë, tash i humbi ato. Duke qenë shumë afër Xhenetit, hyn në Xhehenem. Në të njejtën mënyrë, një njeri që pjesën më të madhe të jetës e ka kaluar në mohim, kryengritje dhe pavëmendshmëri, me ndihmën e Allahut Teala bën teube, e zbukuron gjendjen, vija e tij e kaderit mbaron në hajër dhe del i nënshtuar para Allahut Teala. Duke qenë shumë afër Xhehenemit, hyn në Xhenet. <sup>78</sup>

---

<sup>78</sup> Shiko hadithet në këtë temë: Buhari, Kader, 1; Xhihad, 76; Muslim, Iman, 179; Kader, 1; Tirmidhi, Kader, 4; Ahmed, Musned, III, 120; Ebu Ja'la, Musned, No: 3840

Askush nuk mund të jetë i sigurtë për përfundimin. Asnjë mumin nuk mund të thotë se veprat e tij të mira gjinden në duart e tij, se ato i ka punuar me mendjen e vet dhe sa ai do t'i ruan ato vet. Si do të jetë fundi i jetës e di vetëm Allahu Teala.

Për këtë arsye askush nuk duhet t'i shikojë veprat e veta dhe të mendojë se ka shpëtuar ndërsa të tjerët janë shkatërruar.

Dikush që tani është në gjendje të keqe, nuk duhet ta këpus shpresën se do të punojë vepra të mira. Me ndihmën e Allahut Teala, qafiri i kthehet imanit, gjynahqari zbaton urdhërat e shariatit dhe duke qenë armik i Allahut Teala, mund ta vendos edhe hapin drejtë miqësisë.

Resulallahu s.a.v.s. na drejtohet kështu:

**“Kur Allahu Teala i dëshiron një robit mirësi, e përdor atë në këtë rrugë.”** Një sahabë që gjindej në atë mbledhi e pyeti:

*“Si bëhet kjo punë ja Resulallah?”* Resulallahu s.a.v.s. ju përgjegy:

**“Para vdekjes i mundëson atij të punojë me sukses vepra të mira.”**<sup>79</sup>

---

<sup>79</sup> Tirmidhi, Kader, 8; Ahmed, Musned, III, 112.

Tregon Enesi r.a:  
*Shpesh, shpesh e bënte Resulallahu s.a.v.s. këtë dua:*

**“O Allahu im, që i kthen zemrat kah të don. Ma mbaj zemrën të qëndrueshme në Din.”** Unë e pyeta:

*O Resuli i Allahut! Ne të besuam ty dhe atë që t’i na e sjelle. Pas kësaj a po frikësoheni për ne?” Ai u përgjegj:*

**“Po. Hiç pa dyshim zemrat janë midis dy gishtave të Allaut Teala, ato si të don i kthen.”** <sup>80</sup>

Në një transmetim tjetër hadithi vazhdon kështu:

**“Atë që Allahu dëshiron ta mbajë në drejtësi, ia mban zemrën të drejtë, ndërsa atë që don ta shtrembërojë e shtrembëron. Mizani është në duar të Allahut i cili është Rrahman. Deri në kijamet e ngrit cilin popull të dëshirojë dhe e poshtëron cilin të dëshirojë.”**<sup>81</sup>

### **T’i përkujtojmë temat**

- 1-Cili moment është i rëndësishëm për njeriun?
- 2-A mundet t’i urdhërojë njeriu zemrës atë që dëshiron?

---

Hakim, Mustedrek, I, 340; Ibnu Hibban, el-Ihsan, No: 341

<sup>80</sup> Tirmidhi, Kader, 7

<sup>81</sup> Ahmed, Musned, IV, 182; Nesai, Sunen-i Kubra, No: 7738; Ibnu Maxhe, Mukaddime, 13; Hakim, Mustedrek, I, 525.

## VESVESET DHE MENDIMET QË VIJNË NË ZEMËR

Vesveset të cilat shejtani i hedh në zemër janë mendime të zbrazëta, të thjeshta dhe bestypte.

Shejtani nuk ka ndonjë aftësi tjetër përpos që t'i jep zemrës vesvese.

Vesveset ju vijnë muminëve që kanë hyrë në rrugën e të vërtetës dhe i janë drejtuar Allahut Teala.

Në qoftë se qafirët dhe munafikët thonë se tek ata nuk ka vesvese ajo është e vërtetë. Kjo është e vërtetë për shkak se ata nuk kanë mendime apo shqetësime për iman, për Islam, për Allahun, ahiretin, për teuben, për dhikër apo për vepra të mira. Shejtani nuk ka ndonjë mundim të veçantë për t'i tërhequr kah ana e tij.

Në realitet ata janë miqët dhe ushtarët e shejtanit.

Ata të cilët i janë drejtuar miqësisë së Allahut Teala, adhurimit, përkujtimit dhe të cilët kanë për qëllim punimin e veprave të mira, ata shejtani i shqetëson dhe nuk i lë rehat. Në qoftë se nuk frikësohen prej vesveseve dhe nuk i ndjekin ato, atëherë ata nuk do të kenë kurrfarë dëmi. Në hadithe është cekur se besimtari që nuk shkon

pas vesveseve dhe i largon mendimet e këqija për hir të Allahut, të paktën do ta fitojë një sevap. <sup>82</sup>.

Në veçanti duhet të ceket një hadith i Resulallahut s.a.v.s. i cili na përgëzon se mendimet e këqija të cilat burojnë prej nefsit apo prej shejtanit mirëpo nuk fliten apo nuk veprohen, do të falen. <sup>83</sup>

Disa prej sahabeve erdhën tek Resulallahu s.a.v.s. dhe e pyetën:

*“Ja Resulallah! Në zemrat tona po vijnë asolloj mendimesh për Allahun, imanin dhe rreth Islamit sa që më mirë për neve është të rrëzohemi prej qiellit e të coptohemi se sa t’i flasim ato. Çka është shkaktari i kësaj?”* Resulullahu s.a.v.s. ju përgjegj:

**“Kjo është tërësisht iman, është shenjë e imanit e cila gjendet tek ju.”** <sup>84</sup>

### **T’i përkujtojmë temat**

1-Çka është vesveseja?

2-Kur bënë dëm vesveseja?

3-Pse vesveset nuk u vijnë qafirëve?

---

<sup>82</sup> Shiko: Buhari, Tevhid, 35; Muslim, Iman, 203-208; Tirmidhi, Tefsiru Sure-i Enam, 10 [No: 3084]; Ibnu Hibban, Sahih, No: 380

<sup>83</sup> Buhari, Talak, 11; Muslim, Iman, 201.

<sup>84</sup> Muslim, Iman, 209-211; Nesai, Ameli’l-Jevmi, 201; Ebu Ja’la, Musned, No: 4128; Hejsemi, Mexhmau’z-Zevaid, I, 33.

## RRUGA E SHPËTIMIT PREJ VESVESES

Ilaqi më i bukur kundër vesveses është dituria, dhikri dhe strehimi tek Allahu Teala. Allahu Teala na njofton neve kështu:

**“Ata që i frikësohen Allahut, kur u vjen ndonjë mendim i ligë nga shejtani, i kujtojnë [urdhrat e Tij], e atëherë e shohin rrugën e drejtë.” [7-A’raf: 201.]**

Vesveseja është një fjalë boshe. Besimtari nuk duhet të veprojë çdo gjë të cilën e ndjenë apo që i shkon ndër mend. Drejtësinë e këtyre mendimeve e peshon dhe e vlerëson me dituri dhe me ndërgjegje. Përfundimisht nëse nuk përputhet me rregullat dhe edukimin e fesë, e hedh anash.

Mendimet që vijnë në zemër vlerësohen nëse janë hallall apo haram duke i krahasuar me urdhërat fetare. Nëse ato mendime janë hallall atëherë ato janë të vërteta dhe pranohen. Në qoftë se janë haram, atëherë janë prej shejtanit dhe largohen. Për këtë arsye, në mënyrë që të njihen pëshpëritjet, mendimet dhe ftesat që vijnë prej shejtanëve njerëz apo xhin, çdokush ka nevojë t’i dijë



farzet të cilat janë themele të diturisë. Njeriu injorant bëhet zbavitës i shejtanit. Ai e përzien hallallin me haram dhe përqafton bestytnitë thuase janë fe. Ai bie në çdo lloj rryme ndërsa shejtanët e përdorin atë si të dojnë.

Strehohemi tek Allahu Teala prej kësaj gjendjeje.

Resulallahu s.a.v.s. në këtë mënyrë na ka mësuar se si duhet të sillemi ndaj vesveseve të cilat vijnë prej shejtanit:

**“I vie shejtani njërit prej juve dhe e pyet:**

**“Kush e krijoi tokën, kush e krijoi qiellin, kush e krijoi këtë e kush e krijoi atë?”. Njeriu në të gjitha këto përgjigjet: “Allahu i krijoi”. Në fund shejtani e vendos në zemër një pyetje të tillë:**

**“Shumë mirë, po kush e krijoi Allahun?” Ai që brenda vetit e gjen një pyetje të tillë le ta dijë se është prej shejtanit, menjëherë t’i jep fund pyetjes, le të kërkojë strehim tek Allahu Teala duke thënë Eudhu bil’lahi mine’sh-shejtani’raxhim, bismi’l’lahi’r-rahmani’r-rahim dhe le të thotë: “Unë i besova Allahut dhe Pejgamberit të Tij”<sup>85</sup>**

Në qoftë se dikush prej njerëzve shejtan bën pyetje të ngjashme, atëherë edhe me ta duhet të sillemi në të njejtën mënyrë dhe të përgjigjemi sipas kuptimit të sures **“Ihlas”** [Kul hu vallahu]:

---

<sup>85</sup> Në lidhje me këtë temë të shikohet hadithi Buhari, Bedu’l-Halk, 11; Muslim, Iman, 209-217; Ebu Davud, Sunnet, 18.

**”Allahu është Një/ Tek. Allahu është i përsosur, Samed [Të gjitha krijesat kanë nevojë për Te, ndërsa Ai nuk ka nevojë për askend ]. Nuk ka lindur kënd, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë [i krahasueshëm] me Të”** <sup>86</sup>

Të shumta janë mënyrat dhe rrugët e vesveseve të shejtanit. Nëse nuk mundet ta ndryshojë zemrën e muminit, zgjedh në mesin e njerëzve tipa të shejtanit dhe me ta mundohet të përziej zemrat dhe të korrë sukses. Për këtë gjë ai është betuar dhe për ta realizuar këtë betim Allahu Teala i ka dhënë afat.

Shejtani është një armik i tërbuar i muminëve. Kur ai na sulmon neve, ne duhet të strehohemi te Rabbi jonë i Madhëruar, duke e përkujtuar Atë dhe duke iu lutur Atij. Këtë gjë neve na mësojnë suret **“Felek”** dhe **“Nas”**. Allahu Teala në suren **“Nas”**, shejtanin e ka përshkuar me cilësinë *“hannas”*.

Hannas do të thotë: dikush që gjen një zemër boshe dhe e sulmon, si dhe do të thotë se kur zemra kalon në dhikër, ai është që rrudhet dhe ikë. Kështu e përshkruan Resulallahu s.a.v.s. këtë gjendje të shejtanit:

---

<sup>86</sup> Në lidhje me këtë të shikohet hadithi. Ebu Davud, Sunnen, 18, [No: 4722].

**“Shejtani e zgjat zorrën e tij në mënyrë që t’i jep vesvese zemrës së njeriut. Nëse njeriu e përmend Allahun ai menjëherë rrudhet dhe ikë. Nëse harron ta përmend Allahun, ai ia mbështjell mirë zemrën atij dhe e përbinë si një kafshatë. Ja pra, vetëm pas kësaj fillon të jep vesvese.”**<sup>87</sup>

Ne duhet vazhdimisht të kërkojmë ndihmën e Allahut Teala prej këtij armiku tinzar i cili nuk na hiqet qafesh deri në vdekje. Shejtani nuk mund ta dëbojmë me mendje, mirëpo vetëm me përkrahje hyjnore, dashuri dhe me përkujtim. Ky njoftim i Resulallahut s.a.v.s. na tregon këtë gjë:

**“Secili prej juve e ka një shejtan.”** Në këtë sahabet bujarë e pyetën:

“A edhe ju e keni një shejtan o Resulallah?” Resuli i Allahut s.a.v.s. u përgjegy:

**“Po, edhe unë e kam një shejtan. Vetëm se, Allahu më ndihmojë kundër tij dhe u dorëzua e hyri nën urdhërin tim.”**<sup>88</sup>

Do të thotë se shejtani nuk qenka një armik që mund të mposhtet vetë nga dikush.

Strehohem tek Allahu që është Rrahman dhe Rrahim, prej sherrit të shejtanit dhe ndihmësve të tij.

---

<sup>87</sup> Ebu Ja’la, Musned, VII, No: 4301; Ibnu Kesir, VIII, tefsiri i sures Nas. Ngjajshëm shiko Hakim, Mustedrek, II, 541.

<sup>88</sup> Ahmed, Musned, I, 375.

## LLOJET E SHIRKUT

### Çka është shirku?

Shirk është kur robi e konsideron një ekzistencë tjetër si të barabartë apo të ngjashme me Allahun Teala, atë ekzistencë e sheh si të barabartë me Allahun Teala, mendon se në të gjenden kompetenca dhe veçori hyjnore apo e pranon atë ekzistencë si ndihmës të Allahut Teala, dhe asaj ekzistence i bënë ibadet dhe i dorëzohet në vend të Allahut Teala.

Shkurt shirku është kthimi i respektit në adhurim, përngjasimi i Allahut Teala me njeriun, të duhen sendet e thjeshta sikur që duhet Allahu Teala dhe mosbërja e dallimit ndërmjet robit edhe Rabbit.

Allahu Teala na njofton se shirku është padrejtësia më e madhe që punohet në gjithësi.

**“[Përkujtoju popullit tënd] Kur Llukmani duke e këshilluar, birit të vet i tha: “O djali im, mos i përshkruaj Allahut ortak, sepse shirku është padrejtësia më e madhe.” [31-LLukman: 13.]**

Në qoftë se shirku nuk braktiset, është i vetmi gjynah që nuk do të falet. Ai që hyn në shirk, ka hyrë në një mbrapshti të madhe.

**“Është e vërtetë se Allahu nuk falë [gjynahet] t’i bëhet Atij ortak, e pos këtij [gjynahu], të tjerat i falë atij që dëshiron. Ai që i përshkruan ortak Allahut, ai ka humbur dhe bërë një largim të madh [prej së vërtetës].”**  
[4-Nisaë 116.]

Shirku asgjëson veprat e hajrit:

**“E sikur t’i përshkruajnë ortak Allahut kishte për t’iu shkuar huq ajo që kanë vepruar.”** [6-En’am: 88.]

T’i japim vëmendje Pejgamberit tonë të Rahmetit s.a.v.s.:

**“Ai që nuk i përshkruan Allahut ndonjë send për ortak dhe vdes, hyn në Xhenet. Ndërsa ai që i përshkruan Allahut ndonjë send për ortak dhe vdes, hyn në zjarr.”**<sup>89</sup>.

**“T’ju lajmëroj juve për gjynahet më të mëdha: t’i përshkruhet Allahut ortak, të shkelen të drejtat e nënës dhe babasë, të bëhet be rrejshëm.”**<sup>90</sup>

---

<sup>89</sup> Muslim, Imam, 151; Ahmed, Musned, I, 382

<sup>90</sup> Buhari, Shehadat, 10; Muslim, Iman, 143; Tirmidhi, Birr, 6; Ahmed, Musned, III, 131.

**“Gjynahi më i madh është t’i përshkruash ortak ndonjë krijesë Rabbit tënd i cili të ka krijuar ty.”<sup>91</sup>**

**“Allahu Teala, në ditën e kijametit, personin i cili i ka përshkruar Allahut ortak e le me të përshkruarin kokë më kokë dhe i thotë atij: “Shko! Për kë ke vepruar kërkoje shpërblimin prej tij.”<sup>92</sup>**

**“Allahu Teala udhëron: O robi Im! Deri sa të më bësh Mua ibadet dhe deri sa e pret rahmetin Tim, si do që të jetë gjendja yte, do të fali. O robi Im! Nëse më vjen Mua me gjynahe sa toka e mbushur plot, mirëpo Mua asgjë ortak nuk më ke përshkruar, Unë të pres sa toka mbushur me falje.”<sup>93</sup>**

Krijesat që përdoren për shirk janë: njeriu, xhinët, kafshët, gurët, pemët, zjarri, dielli, hëna, ylli ose ndonjë krijesë tjetër.

Në historinë e botës të gjitha këto janë bërë. Edhe në ditët e sodit në jetën e përditshme, në mënyra të ndryshme njerëzit bijnë në shirk dhe në kufër. Disa njerëz e adhurojnë vetën dhe ndjenjat e këqija, aq sa disa njerëz vdesin pa thënë asnjëherë Allah dhe pa e vendosur asnjëherë kokën në sexhde. Sot teknologjia nuk po shërben për të qenë mirënjohës dhe për të falënderuar, mirëpo është duke u shndërruar në instrument të shirkut.

---

<sup>91</sup> Buhari, Tevhid, 40; Muslim, Iman, 141; Tirmidhi, Tefsir [26], 1-2.

<sup>92</sup> Tirmidhi, Tefsir, 19; [No: 3154]; në lidhje me temën shiko hadithin: Muslim, Zuhd, 46.

<sup>93</sup> Ahmed, Musned, V 154; Munziri, et-Tergib, II, 467.

Allahu Teala duke iu dhënë disa krijesave veçori të mbinatyrshme, i ka tërhequr robët dhe duke dalur në shesh paraqitja hyjnore [ilahi texheli], një pjesë injorante i kanë supozuar ata për “ilah” [ai që adhurohet].

Kur’ani Kerim e përshkruan shejtanin i cili nuk e mohon Allahun Teala ndërsa robëve ia zbukuron të gjitha rrugët e shirkut dhe të mohimit, i fut në rrezik dhe pastaj tërhiqet në një anë:

**“Unë tërhiqem prej teje; unë i frikohem Allahut, Rabbit të gjithësisë!” [59-Hashr: 16.]**

Këtë e thotë duke ikur prej mushrikëve dhe munafikëve.

### **Pikat e rënies në shirk**

Ata që bien në shirk, zhyten në shirk nëpërmjet shumë rrugëve.

Disa që i përshkruajnë Allahut ndonjë krijesë si të barabartë, atë krijesë e dojnë sikur ta dojnë Allahun. Prej tij frikësohet sikur të frikësohet prej Allahut. E madhëron atë sikur që madhërohet Allahu dhe respektin e kthen në adhurim. Kompetencat që i takojnë Allahut i a jep atij, hallallin e bënë haram, ndërsa haramin hallall, e përkul qafën dhe i tregon dorëzim.

Disa, krijesën të cilën e përshkruajnë si ortak të Allahut, e shohin atë si ndihmës të Allahut, mendojnë se

Allahu ka nevojë për ndihmësa dhe se me ndihmën e tyre drejtohet gjithësia.

Disa të cilët e përshkruajnë ndonjë krijesë si ortak të Allahut, besojnë se ai është kompetent dhe ndikues në gjithësi.

Disa, krijesën që e përshkruajnë si ortak të Allahut, e pranojnë se ai është djali, vajza apo një pjesë e Allahut, ai është i integruar në madhësinë hyjnore dhe mendojnë që ka marr cilësi hyjnore. Gjendjet e shirkut mund të paraqiten edhe në mënyra të tjera.

Këto pjesë të shirkut janë shirk i hapur dhe personi definitivisht është mushrik.

Mushrikët thonë se qiellin dhe tokën i ka krijuar Allahu, vetëm se, siç është cekur më lartë e prishin besimin ndaj Allahut, e ndryshojnë dhe hyjnë në një lloj kufri.

Rreziku tek muminët është që një ibadet që bëhet vetëm për kënaqësinë e Allahut Teala, të bëhet si demonstrim para njerëzve, të duhen nga njerëzit apo për ndonjë interes. Kësaj i thuhet shirk i fshehur.

Shirk i fshehur është kur një urdhër i Allahut Teala nuk pëlqehet dhe shpiket një urdhër nga mendja e njeriut dhe punohet sipas tij.

Allahu Teala është larg prej të gjitha llojeve të shirkut, prej të gjitha të metave dhe mangësive.



## **PËRMBLEDHJA E BESIMIT TË EHL-I SUNNET-IT**

Besimi i Ehl-i Sunnetit është kushti themelor për robëri dhe miqësi ndaj Allahut Teala. Besimi i Ehl-i Sunnetit është shpëtim. Ky iman është çelësi i Xhenetit. Prej fillimit të librit u munduam të shpjegojmë botëkuptimin e themeleve të besimit dhe cilësitë e përgjithshme të cilat mund t'i përmbledhim në këtë mënyrë:

Burimi fesë është shpallja [vahji]. Burimi i shpalljes është Rabbi i botërave, Allahu Teala. Detyrë e mendjes nuk është nxjerrja në shesh e një feje të re, mirëpo është kuptimi sa më i drejtë i shpalljes që vjen prej Allahut Teala dhe asaj çka na njofton Pejgamberi s.a.v.s..

Ehl-i Sunneti nuk e pranon asnjë besim dhe asnjë ibadet që nuk mbështetet në Kur'an dhe në sunnet. Të gjitha besimet, mendimet dhe filozofitë të cilat nuk e marrin vërtetimin prej Kur'anit dhe sunnetit janë të kota.

Kur'ani Fisnik është fjala e Allahut Teala dhe është nën mbrojtje hyjnore. Gjithashtu edhe sunneti i cili e shpjegon dhe e zbaton atë është nën këtë mbrojtje. Në

punët e fesë është obligative nënshtrimi ndaj Muhammedit s.a.v.s..

Të thuhet se mua më mjafton Kur'ani dhe mendja ime, detyra e peygamberit ka qenë vetëm njoftimi i ajeteve të Allahut, me vdekjen e tij ka përfunduar detyra e tij dhe se pas kësaj neve nuk na takon apo nuk e kemi obligim t'i nënshtrohemi sunnetit të tij, kjo është kufër. Kjo është në kundërshtim me kuptimin e ajeteve të Kur'anit.

Mendja natyrisht që duhet të përdoret për t'a kuptuar Kur'anin dhe Sunnetin. Nganjëherë ka nevojë për komentimin e ajeteve dhe të haditheve. Kësaj i thuhet "tevil". Sipas metodave të njohura dhe edukatës, ai dijetar që është kompetent të bëjë tevil, nuk është gjynah të bëjë ndonjë interpretim të ri, bile në raste të nevojshme është e domosdoshme. Të gjitha medh'hebet kanë dalë në shesh për shkak të interpretimeve të ndryshme.

Në punët e fesë, sahabët e nderuar për neve janë një burim dhe një dëshmi. Fjalët dhe zbatimi i tyre në lidhje me fe për neve janë obligim. Mirëpo, mund të bëhet zgjedhje ndërmjet pikëpamjeve të ndryshme të sahabëve në lidhje me ndonjë temë të caktuar.

Në temat e fesë të gjithë sahabet janë larg rrenës, me fjalë të drejta, janë të drejtë, të virtytshëm dhe të ndershëm. Ne i duam të gjithë sahabet, i përmendim me

respekt dhe i nderojmë. Ne e pranojmë që ndërmjet tyre ka grada të ndryshme dhe vlera të larta.

As'habi më i lartë është Ebu Bekri r.a. Pas tij me radhë janë Omeri r.a., Osmani r.a. dhe Aliu r.a. Halifet e vërtetë janë gjithashtu në këtë rradhitje. Asnjëri nuk i ka bërë tjetrit ndonjë të padrejtë në mënyrë që të bëhet halife.

Të duhet Ehl-i Bejti, që do të thotë familja e Resulallahut s.a.v.s., familja e tij e pastër dhe soji i tij i lavdishëm është nevojë e imanit dhe shenjë e dashurisë ndaj Pejgamberit s.a.v.s. Ehl-i Bejti, përbëhet prej familjes dhe fëmijëve të Resulallahut s.a.v.s. Ky soj i lavdishëm ka vazhduar me fëmijët e Fatimës r.anha, me Hasanin dhe Husejinin r.a. Kështu do të vazhdon deri në ditën e kijametit. Ky soj i lavdishëm për neve është amaneti i Resulit të Allahut, Muhammed Mustafasë s.a.v.s. Në ditën e kijametit do të pyetemi se si u sollëm ndaj tyre.

Të gjithë ata muminë të cilët kanë kaluar para neve i konsiderojmë për vëllezër dhe të gjithë i përkujtojmë me të mira. Për ta bëjmë dua dhe istigfar.

Asnjë mumin nuk e gjykojmë me kufër për shkak se dha një mendim ndryshe, për shkak se gaboi apo për shkak se bëri gjynah të madh. Një personi që thotë “*unë jam mysliman*”, pa qenë dëshmitar për ndonjë vepër të

keqe apo për ndonjë fjalë që e nxjerr prej fesë haptazi, ne nuk i themi *“ti dole prej fesë”*.

Në qoftë se tek një person shohim një shenjë që tregon se është mumin, edhe poqëse shohim tek ai ndonjë shenjë të kufrit ose fasikut, ne prapëseprapë dëshmojmë për imanin e atij personi. Në këtë çështje vetëm një shenjë e imanit preferohet në krahasim të shumë shenjave të kufrit. Ai që më së miri e di gjendjen e çdokujt dhe që do t’i jep çdokujt llogarinë e përsosur është Allahu Teala.

Personi që punon gjynah të madh, në qoftë se pranon se veprën që ka punuar është haram, ai nuk del prej feje por vetëm bëhet gjynahqar. Për gjynahin që ka bërë është farz të bëhet teube.

Një farz që urdhërohet të punohet mirëpo personi nuk e vepron atë, në qoftë se pranon se është farz, atëherë ai nuk ka dalur prej fesë. Ai bëhet gjynahqar, e ka farz të bëjë teube dhe ta bie në vend urdhërin hyjnor.

Në mes të myslimanëve ka dallim sa i përket ihsanit, ibadetit dhe takvasë. Tek Allahu Teala robi më i vlefshëm dhe me vlerat më të larta është ai rob që më së shumti frikësohet prej Allahut Teala dhe që e ruan në mënyrën më të mirë drejtësinë e Allahut Teala.

Kushtet e imanit të cilat duhet të besohen, as nuk shtohen e as nuk pakësohen. Çdonjeri është i obliguar t’i

besojë të njejtat gjëra. Në çështje të besimit nuk ka kurrfarë dallimi në mes të dijetarit dhe të paditurit, pejgamberit dhe një mumini, mashkullit dhe femrës. Mirëpo varësisht prej gjendjes, edukatës dhe nijetit të robit, në zemra mund të shtohet apo të pakësohet nuri i imanit, dashuria ndaj Allahut Teala, vetëdija e robërisë apo kënaqësia në ibadet. Kjo do të thotë që imani mund të forcohet apo të dobësohet. Në qoftë se gjynahet punohen vazhdimisht ato e mbysin zemrën, e dobësojnë imanin dhe e shkatërrojnë gëzimin e ibadetit.

Gjithë muminët janë miq të Allahut Teala. Ata që janë muttaki dhe që janë në kulmin e devotshmërisë, në dallim prej muminëve të tjerë, kanë fituar miqësi të veçantë ndaj Allahut Teala. Këta mumin salih në Kur'an janë të njohur me emra dhe veti si: *"muhsin"*, *"mukarrabun"*, *"ebrar"*, *"muttaki"*, *"rixhalullah"*, *"evlijauallah"*.

Njerëz që posedojnë këto cilësi, do të gjenden në këtë ummet në çdo periudhë deri në kijamet; i udhëzojnë njerëzit në rrugën e Allahut, në kohërat kur feja është në shuarje ata e rringjallin kuptimin e saj, ibadetin dhe jetën e robërimit e gjallërojnë. Këtyre njerëzve u thuhet muxheddid dhe murshid.

Kerametet që shihen tek miqtë e Allahut janë të vërteta, mirëpo ky nuk është kusht për veliun dhe ai nuk

ka nevojë për te. Kerameti më i bukur është të ecet ditë e natë me dashurinë e Allahut Teala në rrugën e drejtë.

Ehl-i Sunneti këdo që e do dhe çkado që do, e do vetëm për Allahun. Kur zemërohet ndaj dikujt, zemërohet për shkak se Allahu Teala është zemëruar. Njeriu i drejtë nuk i bëhet askujt armik për qejfin apo për nefsin e vet. Ai nuk bie në anën e një xhemati, nuk bënë medh'hebillëk, nuk frikësohet prej kritikave dhe mundohet të përfitojë prej mendimeve të ndryshme. Matja e tij është Kur'ani dhe Sunneti.

Muslimani nuk i bën zullum askujt dhe askund. Në çdo temë sillet me drejtësi. Themeli i ahlakut të muslimanit është falja e gabimeve, thirrja e njerëzve për në vepra të mira me këshilla të bukura, duke e treguar të drejtën dhe duke e jetuar atë si dhe duke qenë i dobishëm për të gjithë.

Mospajtimi në mes të medh'hebeve të vërteta nuk është fitne, mirëpo është rahmet për ummetin. Si në medh'hebet e fikhut ashtu edhe në fushën e akaidit dhe të ahlakut ekzistojnë medh'hebe dhe mënyra të ndryshme të kuptimit. Të gjitha janë brenda kornizave të fesë dhe janë në shërbim të fesë. Medh'hebet dhe mënyrat e kuptimit nuk janë kundërshtarë të njëri tjetrit, por janë vëllezër ndërmjet veti. Të gjithë janë pjesë e një tërësie sikurse gishtat e një dorë apo degët e një peme.

Feja në mënyrën më të bukur jetohet me xhemat. Ai që ngel vetëm është në rrezik. Për këtë arsye çdokujt i nevojitet edukimi dhe disiplina e xhematit. Qëllimi i xhematit duhet të jetë kënaqësia e Allahut Teala dhe devotshmëria. Kështu pra, një xhemat që ka në krye një imam e ka kusht që t'i bindet atij. Ky nënshtrim ndaj imamet bëhet vetëm në urdhëra të drejta. Në kundërshtim ndaj urdhërave të fesë askujt nuk i nënshtrohet.

Shefaati i pejgamberëve dhe i salihëve të cilëve Allah Teala ju ka dhënë leje është i vërtetë.

Allahu Teala do ta shfaq xhemalin për muminët në ahiret

Xheneti dhe Xhehenemi janë të përjetshëm.

Në prezencën hyjnore ata që kanë iman dhe dashuri në zemër edhe sa grimca, edhe nëse hyjnë në Xhehenem për shkak të gjynaheve të cilat i kanë bërë, nuk do të mbesin aty përjetësisht.

O Rabbi ynë Bujar! Neve pasi që na arriti udhëzimi Yt, mos na i rrëshqit zemrat prej rrugës Tënde. Mbështetna neve me rahmetin që është i pa fund. Ruana neve imanin dhe edukatën, falna gjynahet Ja Rabbi.

Hamd i qoftë poseduesit të botëve, Allahut Madhështorë.

Elhamdulillahil'lahi rabbil'alemin

